



PROGRAMET
BACHELOR
DHE PROFESIONAL

4 FAKULTETE
50+ PROGRAME STUDIMI
2 KAMPUSE



PROGRAMET E STUDIMIT

FAKULTETI I INFORMATIKËS

PROGRAM STUDIMI BACHELOR NË INFORMATIKË ME PROFIL:

Faqe 8

INFORMATIKË BIZNESI

Faqe 10

INXHINIERI INFORMATIKE

Faqe 12

TEKNOLOGJI INFORMACIONI

DIPLOMË PROFESIONALE NË TEKNOLOGJI INFORMACIONI DHE APLIKIME INFORMATIKE ME PROFIL:

Faqe 14

SPECIALIST RRJETESH KOMPJUTERIKE

Faqe 16

TEKNIK PËR PAJISJE ELEKTRONIKE

Faqe 18

TEKNIK PËR SOFTWARE DHE DIGJITALIZIM

FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE

PROGRAM STUDIMI BACHELOR NË SHKENCA EKONOMIKE ME PROFIL:

Faqe 22

FINANCË BANKË DHE KONTABILITET

Faqe 24

ADMINISTRIM BIZNESI

Faqe 26

BIZNES DHE LIGJ

Faqe 28

DIPLOMË PROFESIONALE NË **MENAXHIM DHE MARKETING I TURIZMIT**

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

PROGRAM STUDIMI BACHELOR NË MJEKËSI PËR:

Faqe 32

INFERMIERI E PËRGJITHSHME

Faqe 34

FIZIOTERAPI

Faqe 37

TEKNIK LABORATORI

FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE

PROGRAM I INTEGRUAR I STUDIMEVE TË CYKLIT TË DYTË **MASTER I SHKENCAVE NË DREJTËSI**

Faqe 42

PROGRAM STUDIMI BACHELOR NË **MARRËDHËNIE DHE INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE**

Faqe 44

PROGRAM STUDIMI BACHELOR NË KOMUNIKIM DHE **MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN**

Faqe 46

PROGRAM STUDIMI BACHELOR NË MËSUJESI PËR:

Faqe 48

ARSIMIN FILLOR

Faqe 50

ARSIMIN PARASHKOLLOR

PROGRAM STUDIMI BACHELOR NË SHKENCA POLITIKE DHE ADMINISTRATIVE ME PROFIL:

Faqe 52

POLITIKAT E INTEGRIMIT DHE QEVERISJES

Faqe 54

ADMINISTRATË PUBLIKE

Faqe 56

PROGRAM STUDIMI BACHELOR NË **PSIKOLOGJI TË PËRGJITHSHME**

Faqe 58

PROGRAMI I STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN **PSIKO-PEDAGOGJI**



PRESIDENTI I UMSH-së

Anastas Angjeli Akademik, Prof.Dr.

Të dashur studentë,
kolegë, prindër e bashkëpunëtorë ndër vite,

Teksa shkruaj këto radhë, nuk mund të fsheh as krenarinë, as entuziazmin dhe as emocionet në këtë ditëlindje të 15-të të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Ndonëse vitet kanë ikur symbylltazi, teksa kthej kokën pas, dëshiroj të jem objektiv në progresin që ky Universitet ka bërë gjatë një dekadë e gjysmë, që prej ditës kur materializuam me besim e përkushtim vizionin tonë për të udhëhequr të rinjtë në rrugëtimin e dijes. Sot në këtë përvjetor, unë dua të pohoj me bindje të plotë se : Ne ja kemi dalë! Ka qenë një rrugëtim jo i lehtë, i mbushur me sfida, por gjithnjë e më i bukur dhe përbushës, ditë pas dite e vit pas viti! Një rrugëtim frymëzues që na bën të mos ndalemi dhe të vijojmë të shohim nga e ardhmja! Kjo falë besimit që mijëra të rinj dhe prindër na kanë dhënë duke na lënë në duar përgjegjësinë e edukimit të tyre. Ky besim, ka qenë shtysa më e madhe që Universiteti Mesdhetar të jetë sot pas 15 vitesh një lokomotivë e pandalshme e dijes, me mbi 13 mijë të diplomuar, duke pasur si synim parësor, përmirësimin brenda vetes, në mënyrë që t'i ofrojë të rinjve, jo vetëm garancinë se ardhmja e tyre është në duar të sigurta, por një ofertë akademike që i bën ata të denjë e të përgatitur për tregun e punës.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, ka ditur të përshtatet me atë çka kërkon sot ky treg, duke i ofruar studentëve të tij ato kurrikula dhe programe që i japin vlerë diplomave të tyre, duke i kthyer në “pasaportat” e karrierave të suksesshme. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, sot ofron gamën e plotë të programeve të studimit, me 4 fakultete duke mbuluar të gjithë spektrin e studimeve në fushën e :Ekonomisë, Teknologjisë, Drejtësisë, Shkencave Humane dhe Mjekësisë. Ky spektër i plotë programesh, jo vetëm që ka rritur përvojën tonë akademike, por gjithashtu ka kontribuar në progresin social dhe ekonomik të vendit si edhe në ndërlidhjen e shoqërisë shqiptare me atë rajonale dhe globale. E gjithë bota po shkon drejt një koncepti të ri universitetesh që kanë të bëjnë me revolucionin 4.0, revolucionin dixhital, inteligjencën artificiale, të cilat kanë efekte madhore për ekonominë, punësimin, sigurinë e gjithë shoqërinë. Universiteti i së ardhmes vendos qasje të reja mësimore inovative. Ai trajnon qytetarët, përmes ndërkombëtarizimit të dijes dhe mobilitetit të studentëve e pedagogëve.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është Universiteti i së ardhmes! Ai synon përvetësimin nga studentët të aftësive universale për të rimenduar, vepruar, parashikuar dhe marrë parasysh zgjidhje alternative për skenarët kompleksë të së ardhmes. Filozofa e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është e ndërlidhur pikërisht me trinomin e rëndësishëm që bashkon cilësinë në mësimdhënie, duke transmetuar sa më shumë dije të reja studentët, kërkimin shkencor bazik dhe atë aplikativ si dhe punën me projektet e bashkëveprimin me komunitetin e biznesit . Në këtë mënyrë ne kalojmë duke u përshtatur me kohën nga një mënyre pedagogjike me në qendër mësuesin, drejt të mësuarit me në qendër studentin. Dhe ne besojmë se vetëm duke pasur në qendër studentin do të mundemi t'i ofrojmë atyre përqafimin e këtij vizioni të së ardhmes. Kemi gjithashtu detyrimin të mos harrojmë se të ardhmen e Shqipërisë e kanë pikërisht të rinjtë, studentët tanë në dorë dhe ajo nuk ndërtohet as me dëshirën për t'u larguar dhe as me dëshirën për të parë se diku gjetkë është më mirë, por me dëshirën dhe vullnetin e përbashkët që më të mirën ta bëjmë këtu, të gjithë bashkë për të ardhmen europiane të Shqipërisë!

Suksese!



Rektori i UMSH-së

Adrian Civici

Akademik i Asociuar, Prof. Dr.

Të dashur studentë,

Eksperienca e vyer 15 vjeçare e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë në arsimin e lartë dhe mjediset akademike është gjithmonë një mundësi e vlefshme për të konsoliduar e përmirësuar projektin tonë arsimor të së ardhmes dhe për të përvijuar perspektiva të reja në misionin tonë për një edukim sa më cilësor, në funksion të zhvillimeve të reja të dijes, shkencës e shoqërisë.

Si mund ta vëmë shkencën dhe kërkimin shkencor, kulturën dhe demokracinë, njohuritë, dijet, informacionin, inteligjencën artificiale dhe sfidat më të cilat përballemi, në shërbim të vendit dhe shoqërisë? Cilësia e universiteteve dhe e kërkimit shkencor në raport me zhvillimin ekonomik e social të një vendi konsiderohen të barabarta me efektet dhe produktivitetin që japin teknologjitë moderne, inovacionet dhe format e avancuara të drejtimit e menaxhimit. Shoqëria e të ardhmes po ndërton universitetet e të ardhmes.

Në UMSH jemi të bindur se edukimi duhet të vlerësohet dhe universitetet duhet të funksionojnë si instrumente që promovojnë zhvillimin ekonomik të çdo vendi, si një faktor i rëndësishëm që nxit produktivitetin ekonomik, zhvillon demokracinë dhe rrit standartet e jetësës. Vlen të theksohet se inovacioni nuk është thjesht një opsion. Është një detyrim në kuadrin e revolucionit dixhital, inteligjencës artificiale përfshirë këtu dhe perspektivat e zhvillimit të “edukimit 4.0”, si modele mjaft cilësore të univesiteteve të së ardhmes.

Ballafaqimi ndërmjet universiteteve, studentëve të diplomuar, dhe kërkesave të bizneseve apo tregut të punës në tërësi, po na evidenton dy elemente : evolucionin e shpejtë të një pjese të madhe të bizneseve e aktorëve të tregut drejt teknologjive të reja moderne në prodhim, menaxhim e drejtim, drejt thellimit të procesit të dixhitalizimit kompleks, në vendosjen e strategjive dixhitale në zemër të strategjive të tyre të zhvillimit ... dhe, sfidat e reja të universiteteve për të mos u mjaftuar vetëm me “emrin e mirë” apo akreditimet institucionale pozitive, por, për të bërë një “qilizëm” të thellë në programet mësimore, sillabuset, tekstet dhe literaturën e specializuar, praktikat mësimore, kërkimin shkencor dhe botimet akademike, cilësinë e mësimdhënies dhe pedagogëve të angazhuar, procesin e ndërkombëtarizimit, etj.

Kjo është tashmë sfida jonë kryesore!

Le ta realizojmë së bashku!

Pse Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë?

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, i akredituar në të gjitha programet e tij është një nga institucionet më elitare të arsimit të lartë në Shqipëri. Prej më shumë se një dekade, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka diplomuar qindra të rinj në fushën e: **Ekonomisë, Informatikës, Drejtësisë dhe Shkencave Humane, Mjekësisë.**

FAKULTETI I INFORMATIKËS

Fakulteti më i ri i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, me programet tija të studimit është krijuar pikërisht për t'u përgjigjur kërkesës në rritje për profesionistë të rinj në fushën e IT-së. Me hapjen e këtij fakulteti, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë synon t'i japë mundësi studentëve të jenë të përgatitur për zhvillimet e vullshme të dixhitalizimit në të gjithë botën. Tregu i punësimit për të gjithë studentët që do ndjekin një nga degët e këtij fakulteti, është një treg jo vetëm kombëtar, por ndërkombëtar, me hapësira gjithnjë e më të mëdha punësimi në sektorin privat e publik. Nëpërmjet kurrikulave të studiuara mirë, çdo i ri që do të përzgjedhë këtë fakultet do të fitojë të njëjtat njohuri si studentët e fushës së informatikës në vendet e tjera të zhvilluara. Fakulteti i dedikuar për informatikën në Universitetin Mesdhetar, të Shqipërisë finalizon një investim strategjik të këtij Universiteti të nisur prej vitesh. Ne besojmë se në fusha të tilla si Informatika duhen ofruar një numër i gjerë programesh studimi për të aftësuar profesionistët e rinj dhe krijuar fleksibilitet për ta.

FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE

Fakulteti i Shkencave Ekonomike mban në konsideratë kërkesat e zhvillimit ekonomik të vendit për të ndërtuar programe, metodika, studime dhe forma përvetësimi me qëllim të krijësve specialistë të aftë për plotësimin e nevojave të tregut si në sektorin publik edhe në atë privat. Mundësia që iu ofrohet studenteve për të ndjekur studime në cikle dhe profile të ndryshme në Fakultetin e Shkencave Ekonomike vjen e orientuar nga niveli i zhvillimit ekonomik të vendit, kërkesat e tregut të punës dhe aftësisë sipërmarrëse të çdo studenti. Rezultatet e kësaj përpjekjeje janë: shkurtimi i vazhdueshëm i kohës që iu duhet studentëve që mbarojnë studimet nga momenti i përfundimit të shkollës deri në momentin e fillimit të punës së parë në profesion, rritja e vazhdueshme e pagës për studentët e masterit dhe plotësimi i të gjithë kushteve të konkurrencës për rritjen në detyrë, si në bizneset private edhe në administratën publike.

FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE

Ky fakultet ofron zhvillimet më bashkëkohore për një gamë të gjerë programesh studimi të cilat aftësojnë studentët për tu bërë profesionistët e rinj në fusha që lidhen ngushtësisht me bizneset private, administratën publike, pushtetit vendor dhe medias. Përveç specializimit në shkencat Juridike, Politike dhe Marrëdhëniet ndërkombëtare, ky fakultet ofron programet më të avancuara në fushën e psikologjisë dhe të komunikimit. Gjithashtu degët e reja për mësuesi, do të specializojnë brezin e ri të arsimtarëve sipas standardeve që kërkon sot tregu. Ajo çka ofron ky fakultet është në përputhje me objektivin për t'i bërë studentët tanë të aftë për t'u punësuar menjëherë pas përfundimit të studimeve. Falë marrëveshjeve të bashkëpunimit me dhjetëra institucione private dhe publike, praktikant profesionalë që kryejnë studentët tanë, kanë përfunduar me rekrutimin e shpejtë të tyre për punësim në këto institucione.

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

Misioni i Fakultetit të Shkencave Mjekësore është të aftësojë studentët në njohuritë teoriko-praktike gjatë ushtrimit të profesionit në dhënien e kujdesit shëndetësor me kompetencë profesionale, në zgjidhjen e problemeve shëndetësore në shërbim të individit dhe komunitetit. Fakulteti i Shkencave Mjekësore do të diplomojë profesionistë të formuar në degë të ndryshme dhe të edukojë brezin e ri të infermierëve, fizioterapistëve, imazheristëve, teknikëve të laboratorit, duke siguruar mësimdhënie me cilësi të lartë, që adresojnë sfida në ditët e sotme në Sistemin Shëndetësor dhe në praktikën mjekësore, në dhënien e kujdesit shëndetësor sa me cilësor dhe me kosto/efikasitet. Pikërisht, për këtë arsye, duke u azhurnuar me problematikat, që hasen në Sistemin tonë Shëndetësor dhe në Institucionet Shëndetësore, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është angazhuar maksimalisht për të dhënë kontributin e tij në përgatitjen e profesionistëve të kujdesit shëndetësor. Ky Fakultet do bëjë të mundur që studentët të bëjnë praktikant profesionalë duke u paguar, në vendet me të zhvilluara të BE-së, duke mësuar gjuhën e atij vendi dhe marrjen e licencës profesionale. Falë partneritetit me qendra spitalore brenda dhe jashtë vendit, ky Fakultet do të mundësojë praktikant profesionalë të paguara në vendet më të zhvilluara të BE-së.





FAKULTETI I


INFORMATIKËS

IT

3 BACHELOR 3 MASTER



FAKULTETI I INFORMATIKËS



Prof. Dr. *Dhimitri Tole*

Programi i studimit Bachelor në Informatikë, me profil: “Informatikë Biznesi”

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit **Bachelor në Informatikë, me profil "Informatikë Biznesi"** në UMSH, synon plotësimin e nevojave në rritje për specialistë të fushës së informatikës që kanë njohuri nga fusha e biznesit. Gjatë dekadave të fundit, përdorimi i teknologjive të reja dhe dixhitalizimi ka ndikuar në gjithë shoqërinë, duke ndryshuar mënyrën se si njerëzit jetojnë, punojnë dhe bashkëbejnë me njëri tjetrin. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), ka qenë shkaku i ndryshimeve të rëndësishme të metodave të prodhimit dhe modeleve të punësimit në BE. Në botën e biznesit sot ka shumë pak procese apo detyra operacionale, që nuk janë të mbështetura nga teknologjia kompjuterike. Nisur nga ky fakt është e pritshme që rëndësia e teknologjisë të vazhdojë të rritet edhe më tepër në të ardhmen. Është detyrë e institucioneve akademike që në mos t'i paraprijë proceseve, të ecë në një hap me kërkesat e tregut të punës. Ndarja e programit me profile, parashikon rritjen e aftësive teorike dhe praktike në lëndët e përgjithshme si dhe avancimin e njohurive në lëndët e përfshira në profilet përkatëse deri në përfundim të ciklit të studimeve.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Synimi kryesor i programit Bachelor në Informatikë, me profil Informatikë Biznesi, është që studenti në përfundim të ciklit të studimeve të ketë njohuri të gjera rreth:

Menaxhimit të sistemeve kompjuterike dhe të jetë në gjendje të ndërtojë sisteme informatike të sigurta;

Zhvillimit të projekteve të ndryshme në fushën e informatikës;

Shqyrtimit të sistemeve ekzistuese IT të klientëve si dhe modeleve të biznesit;

Planifikimit të ndryshimeve të sistemeve ekzistuese për të përmirësuar rrjedhën e punës; Aftësi për të menaxhuar punët dhe instalimet e sistemit kompjuterik në përputhje me rregulloret në fuqi dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit; Aftësi për menaxhim të përgjithshëm, menaxhim teknik dhe kërkim, zhvillim dhe menaxhim inovacioni në biznese dhe qendra teknologjike në fushën e informatikës;

Të analizojnë përputhshmërinë e sistemeve kompjuterike brenda për brenda një organizate, në mënyrë që të kenë pajtueshmëri me njëri-tjetrin; Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar përgjegjësinë etike, legjislacionin dhe kodin profesional të sjelljes në lidhje me praktikën profesionale të informatikës;

Aftësi për të zbatuar parimet e ekonomisë, burimet njerëzore dhe menaxhimin e projekteve, si dhe ligjin, rregulloret dhe standardet kompjuterike;

Aftësi për të ngritur, udhëhequr dhe menaxhuar proceset e prodhimit të pajisjeve kompjuterike, duke garantuar sigurinë e njerëzve dhe pronës, cilësinë dhe miratimin e produktit përfundimtar. Zbatimin me përpikmëri të standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë gjatë zhvillimit të procesit të mësimin. Rritjen e kulturës së punës institucionale.

NJOHURITË KRYESORE

Programi i studimit Bachelor në Informatikë i jep njohuri studentëve në drejtimet më të kërkuara sot në tregun e punës, sepse nga studimet dhe analizat e bëra ka një rritje të kërkesës për specialistë të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Në vitin e parë, studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë, me profil Informatikë Biznesi, do zhvillojnë lëndët si: Bazat e Informatikës, Matematikë, Algoritmikë, Arkitekturë dhe Vlerësim kompjuterash, Strukturë të dhënash etj, të cilat janë të rëndësishme për të vendosur bazat në formimin e tyre në fushën e informatikës.

Në vitin e dytë, studentët do zhvillojnë lëndët si: Programim, Sisteme Operimi, Sisteme Multimediale, Programim në Web, E-business, Statistikë etj, të cilat do t'i ndihmojnë ata të marrin njohuri në fusha shumë të rëndësishme për formimin e tyre. Ndërsa në vitin e tretë, studentët do zhvillojnë lëndët të veçanta sipas profilit Informatikë Biznesi që ata kanë zgjedhur. Konkretisht, studentët do zhvillojnë lëndët: Parimet e Kontabilitetit, Kontabilitet Financiar, Drejtim Financiar, Ekonometri, Menaxhim, Marketing, Web Services etj.

Lëndët e profilit, të cilat janë zgjedhur me shumë kujdes në përputhje me situatën aktuale dhe kërkesat e tregut, i ndihmojnë studentët që të thellohen në disa nënfusha të rëndësishme.



REZULTATET E DIPLOMIT

Emërtimi i diplomës: Bachelor në Informatikë, me profil "Informatikë Biznesi"

Synimi kryesor i programit Bachelor në Informatikë, me profil "Informatikë Biznesi" është që studentët në përfundim të ciklit të studimeve të kenë njohuritë e nevojshme dhe të: Identifikojnë procedurat dhe praktikën e punës së biznesit; Analizojnë procedurat dhe praktikën e punës; Ndërtojnë dhe manxhojnë sistemet ERP (enterprise resource planning), CRM (customer relationship management) etj Identifikojnë alternativat për zgjidhjet potenciale; Vlerësojnë alternativat nëse janë të përshtatshme si për pjesën teknike, ashtu edhe për atë të biznesit; Përlogaritin kostot dhe kohën e duhur të projektit; Shqyrtojnë sistemet ekzistuese IT të klientëve si dhe modelet e biznesit; Planifikojnë, dizajnojnë dhe implementojmë sistemet dhe strategjitë e IT. Planifikojnë ndryshimet e sistemeve ekzistuese për të përmirësuar rrjedhën e

punës; Analizojnë përputhshmërinë e sistemeve kompjuterike brenda për brenda një organizate, në mënyrë që të kenë pajtueshmëri me njëri-tjetrin; Përdorin kompjuterin dhe sistemet që kanë lidhje me dizajnimin e projekteve të reja IT. Bëjnë dokumentimin e gjendjes së sistemeve; Specifikojnë parametrat e sistemeve; Hartojnë rastet e testeve në përputhje me kërkesat dhe zgjidhjet teknike të parashikuara.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Studenti i diplomuar në programin "Bachelor në Informatikë", me profil Informatikë Biznesi mund të punojë si: Hartues të multimedias dhe rrjetit të saj; Analist biznesi; Konsulent sistemi; Koordinator IT; Zhvillues dhe analistë të aplikacioneve dhe të softwareve; Administratorë të sistemeve; Arkitektë të sistemeve; Specialistë

Plani mësimor i Programit të studimit Bachelor në Informatikë, me profil "INFORMATIKË BIZNESI"

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SHKRIM AKADEMIK	6
2	BAZAT E INFORMATIKËS MATEMATIKË	6
3	MATEMATIKË 1	6
4	MATEMATIKË 2	6
5	ALGORITMIKË	6
6	ARKITEKTURË DHE VLERËSIM KOMPJUTERASH LËNDË ME ZGJEDHJE:	6
7	FIZIKË SOCIOLOGJI HYRJE NË EKONOMI	6
8	GJUHË E HUAJ	6
9	SISTEME LOGJIKE	6
10	STRUKTURË TË DHËNASH	6

VITI I DYTË

11	PROGRAMIM	6
12	PROGRAMIM 1	6
13	PROGRAMIM 2	6
14	SISTEME OPERIMI	6
15	SISTEME MULTIMEDIALE	6
16	STATISTIKË	6
17	STATISTIKË 1	6
18	STATISTIKË 2	6
19	E-BUSINESS	4
20	ETIKË DHE KOMUNIKIM NË BIZNES	4
21	PROGRAMIM WEB	6
22	MATEMATIKË 3	6
23	ÇËSHTJE LIGJORE TË INFORMATIKËS	4

VITI I TRETË

24	TEORI E BAZAVE TË TË DHËNAVE	6
25	PARIMET E KONTABILITETIT	6
26	KOMUNIKIM TË DHËNASH DHE RRJETAT KOMPJUTERIKE	6
27	EKONOMETRI	6
28	LËNDË ME ZGJEDHJE:	6
29	MENAXHIM MARKETING	6
30	DREJTIM FINANCIAR	6
31	KONTABILITET FINANCIAR	6
32	WEB SERVICES	4
33	PRAKTIKË PROFESIONALE	6
34	DIPLOMA (PROVIMI FORMUES)	8

Totali i planit mësimor: 180

të rrjetit të kompjuterit; Zhvillues të softuerit; Menaxher Projektësh; Analist të sistemeve të Bazave të të Dhënave; Teknikë website.

PRAKTIKA MËSIMORE


Studentët e zhvillojnë praktikën mësimore në auditor duke u ofruar javë pas javë takime me përfaqësues nga tregu i punës kombëtar dhe ndërkombëtar.

LEKSIONET E HAPURA

Si pjesë të strategjisë së universitetit, në UMSH, synohet të

ofrohen si bashkëpunëtorë të jashtëm profesionistë nga tregu i punës, duke mundësuar që në auditor të gërshetohet shumë mirë teoria me praktikën. Përveç kësaj, Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, duke shfrytëzuar lidhjet personale të pedagogëve të saj, ka organizuar një sërë aktivitetesh me specialistë/ profesionistë të fushës së teknologjisë së informacionit si dhe me antarë të bordit të tregut të punës me të cilët departamenti mban kontakte të ngushta. Këto aktivitete janë në formën e webinarëve, leksioneve të hapura, tavolinave të rrumbullakta etj.

FAKULTETI I INFORMATIKËS



Programi i studimit Bachelor në Informatikë, me profil “Inxhinieri Informatike”

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor në Informatikë, me profil “Inxhinieri Informatike” në UMSH, synon plotësimin e nevojave në rritje për specialistë të fushës së inxhinierisë informatike. Gjatë dekadave të fundit, përdorimi i teknologjive të reja dhe dixhitalizimi, ka ndikuar në gjithë shoqërinë, duke ndryshuar mënyrën se si njerëzit jetojnë, punojnë dhe bashkëveprojnë me njëri tjetrin. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), ka qenë shkaku i ndryshimeve të rëndësishme të metodave të prodhimit dhe modeleve të punësimit në BE. Në botën e biznesit sot ka shumë pak procese apo detyra operacionale, që nuk janë të mbështetura nga teknologjia kompjuterike. Nisur nga ky fakt është e pritshme që rëndësia e teknologjisë të vazhdojë të rritet edhe më tepër në të ardhmen. Është detyrë e institucioneve akademike që në mos t'i paraprijë proceseve, të ecë në një hap me kërkesat e tregut të punës. Ndarja e programit me profile, parashikon rritjen e aftësive teorike dhe praktike në lëndët e përgjithshme si dhe avancimin e njohurive në lëndët e përfshira në profilet përkatëse deri në përfundim të ciklit të studimeve.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Synimi kryesor i programit Bachelor në Informatikë, me profil “Inxhinieri Informatike” është që studenti në përfundim të ciklit të studimeve të ketë njohuri të gjera rreth:

Menaxhimit të sistemeve kompjuterike dhe të jetë në gjendje të ndërtojë sisteme informatike të sigurta; Zhvillimit të projekteve të ndryshme në fushën e informatikës;

Shqyrtimit të sistemeve ekzistuese IT të klientëve si dhe modeleve të biznesit; Planifikimit të ndryshimeve të sistemeve ekzistuese për të përmirësuar rrjedhën e punës; Aftësi për të menaxhuar punët dhe instalimet e sistemit kompjuterik në përputhje me rregulloret në fuqi dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit; Aftësi për menaxhim të përgjithshëm, menaxhim teknik dhe kërkim, zhvillim dhe menaxhim inovacioni në biznese dhe qendra teknologjike në fushën e informatikës; Të analizojnë përputhshmërinë e sistemeve kompjuterike brenda për brenda një organizate, në mënyrë që të kenë pajtueshmëri me njëri-tjetrin;

Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar përgjegjësinë etike, legjislativonin dhe kodin profesional të sjelljes në lidhje me praktikën profesionale të informatikës; Aftësi për të zbatuar parimet e ekonomisë,

burimet njerëzore dhe menaxhimin e projekteve, si dhe ligjin, rregulloret dhe standardet kompjuterike;

Aftësi për të ngritur, udhëhequr dhe menaxhuar proceset e prodhimit të pajisjeve kompjuterike, duke garantuar sigurinë e njerëzve dhe pronës, cilësinë dhe miratimin e produktit përfundimtar.

Zbatimin me përpikmëri të standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë gjatë zhvillimit të procesit të mësimin.

NJOHURITË KRYESORE

Programi i studimit bachelor në Informatikë i jep njohuri studentëve në drejtimet më të kërkuara sot në tregun e punës sepse nga studimet dhe analizat e bëra ka një rritje të kërkesës për specialistë të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Në vitin e parë, studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë, me profil Inxhinieri Informatike do zhvillojnë lëndët si: Bazat e Informatikës, Matematikë, Algoritmikë, Arkitekturë dhe Vlerësim Kompjuterash, Strukturët dhënësh etj, të cilat janë të rëndësishme për të vendosur bazat në formimin e tyre në fushën e informatikës. Në vitin e dytë, studentët do zhvillojnë

lëndët si: Programim, Sisteme Operimi, Sisteme Multimediale, Programim në Web, E-business, Statistikë etj, të cilat do t'i ndihmojnë ata të marrin njohuri në fusha shumë të rëndësishme për formimin e tyre. Ndërsa në vitin e tretë, studentët do zhvillojnë lëndë të veçanta sipas profilit Inxhinieri Informatike që ata kanë zgjedhur. Konkretisht, studentët do zhvillojnë lëndët: Teoria Sinjaleve, Administrim Sistemesh, UML, Hyrje në Inxhinierinë Softwerike, Bazat e Elektroteknikës, GIS, Komunikim të Dhënash dhe Rrjetat Kompjuterike etj.

Lëndët e profilit, të cilat janë zgjedhur me shumë kujdes në përputhje me situatën aktuale dhe kërkesat e tregut, i ndihmojnë studentët që të thellohen në disa nënfusha të rëndësishme.

REZULTATET E DIPLOMIT

Emërtimi i diplomës: Bachelor në Informatikë, me profil “Inxhinieri Informatike”

Synimi kryesor i programit Bachelor në Informatikë, me profil “Inxhinieri Informatike” është që studenti në përfundim të ciklit të studimeve të ketë njohuri rreth: menaxhimit të sistemeve kompjuterike dhe të jetë në gjendje të ndërtojë sisteme informatike të sigurta; Zhvillimit të projekteve të ndryshme në fushën e



informatikës; Shqyrtimit të sistemeve ekzistuese IT të klientëve si dhe modeleve të biznesit; Planifikimit të ndryshimeve të sistemeve ekzistuese për të përmirësuar rrjedhën e punës; Aftësi për të menaxhuar punët dhe instalimet e sistemit kompjuterik në përputhje me rregulloret në fuqi dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit; Aftësi për menaxhim të përgjithshëm, menaxhim teknik dhe kërkim, zhvillim dhe menaxhim inovacioni në biznese dhe qendra teknologjike në fushën e informatikës; Të analizojnë përputhshmërinë e sistemeve kompjuterike brenda për brenda një organizate në mënyrë që të kenë pajtueshmëri me njëri-tjetrin; Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar përgjegjësinë etike, legjislacionin dhe kodin profesional të sjelljes në lidhje me praktikën profesionale të informatikës; Aftësi për të zbatuar parimet e ekonomisë, burimet njerëzore dhe menaxhimin e projekteve, si dhe ligjin, rregulloret dhe standardet kompjuterike; Aftësi për të ngritur, udhëhequr dhe menaxhuar proceset e prodhimit të pajisjeve kompjuterike, duke garantuar sigurinë e njerëzve dhe pronës, cilësinë dhe

miratimin e produktit përfundimtar.

Studenti i diplomuar në programin Bachelor në Informatikë, me profil Inxhinieri Informatike mund të punojë si:

Analist i sistemeve kompjuterike; Zhvillues i software; Hartues i multimedias; Programues i aplikacioneve;

Zhvillues Full-Stack;

Inxhinier aplikimesh informatike; Inxhinier instalim-programim i sistemeve teknologjike; Menaxher i sistemeve të informacionit; Arkitekt i rrjetave kompjuterike; Specialist IT;

Konsulent sistemi TI;

Projektues sistemi TI;

PRAKTIKA MËSIMORE

Studentët e zhvillojnë praktikën mësimore në auditor duke u ofruar javë pas javë takime me përfaqësues nga tregu i punës kombëtar dhe ndërkombëtar.

LEKSIONET E HAPURA

Si pjesë të strategjisë së universitetit, në UMSH, synohet të ofrohen si bashkëpunëtorë të jashtëm profesionistë nga tregu i punës, duke mundësuar që në auditor të gërshetohet shumë mirë teoria me praktikën. Përveç kësaj,

Plani mësimor i Programit të studimit Bachelor në Informatikë, me profil "INXHINIERI INFORMATIKE"

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SHKRIM AKADEMIK	6
2	BAZAT E INFORMATIKËS	6
	MATEMATIKË	
3	MATEMATIKË 1	6
4	MATEMATIKË 2	6
5	ALGORITMIKË	6
6	ARKITEKTURË DHE VLERËSIM KOMPJUTERASH	6
	LËNDË ME ZGJEDHJE:	
7	FIZIKË SOCIOLOGJI HYRJE NË EKONOMI	6
8	GJUHË E HUAJ	6
9	SISTEME LOGJIKE	6
10	STRUKTURË TË DHËNASH	6

VITI I DYTË

PROGRAMIM		
11	PROGRAMIM 1	6
12	PROGRAMIM 2	6
13	SISTEME OPERIMI	6
14	SISTEME MULTIMEDIALE	6
	STATISTIKË	
15	STATISTIKË 1	6
16	STATISTIKË 2	6
17	E-BUSINESS	4
18	ETIKË DHE KOMUNIKIM NË BIZNES	4
19	PROGRAMIM WEB	6
20	MATEMATIKË 3	6
21	ÇËSHTJE LIGJORE TË INFORMATIKËS	4

VITI I TRETË

22	TEORI E BAZAVE TË TË DHËNAVE	6
23	KOMUNIKIM TË DHËNASH DHE RRJETAT KOMPJUTERIKE	6
24	TEORIA E SINJALEVE	6
25	UML	6
26	ADMINISTRIM SISTEMESH	6
27	HYRJE NË INXHINIERI SOFTWERIKE	6
28	BAZAT E ELEKTROTEKNIKËS	6
29	GIS	4
30	PRAKTIKA	6
31	DIPLOMA (PROVIMI FORMUES)	8


Totali i planit mësimor: 180

Departamenti

i Informatikës dhe Formimit Shkencor, duke shfrytëzuar lidhjet personale të pedagogëve të saj, ka organizuar një sërë aktivitete me specialistë/profesionistë të fushës së teknologjisë së informacionit si

dhe me antarë të bordit të tregut të punës me të cilët departamenti mban kontakte të ngushta. Këto aktivitete janë në formën e webinarëve, leksioneve të hapura, tavolinave të rrumbullakta etj.

FAKULTETI I INFORMATIKËS



Programi i studimit Bachelor në Informatikë, me profil "Teknologji Informacioni"

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor në Informatikë, me profil "Teknologji Informacioni" në UMSH, synon plotësimin e nevojave në rritje për specialistë të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Gjatë dekadave të fundit, përdorimi i teknologjive të reja dhe dixhitalizimi, ka ndikuar në gjithë shoqërinë, duke ndryshuar mënyrën se si njerëzit jetojnë, punojnë dhe bashkëprojetojnë me njëri tjetrin. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), ka qenë shkaku i ndryshimeve të rëndësishme të metodave të prodhimit dhe modeleve të punësimit në BE. Në botën e biznesit sot ka shumë pak procese apo detyra operacionale, që nuk janë të mbështetura nga teknologjia kompjuterike. Nisur nga ky fakt është e pritshme që rëndësia e teknologjisë të vazhdojë të rritet edhe më tepër në të ardhmen. Është detyrë e institucioneve akademike që në mos t'i paraprijë proceseve, të ecë në një hap me kërkesat e tregut të punës. Ndarja e programit me profile parashikon rritjen e aftësive teorike dhe praktike në lëndët e përgjithshme si dhe avancimin e njohurive në lëndët e përfshira në profilet përkatëse deri në përfundim të ciklit të studimeve.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Synimi kryesor i programit Bachelor në Informatikë, me profil "Teknologji Informacioni", është që studentit në përfundim të ciklit të studimeve të ketë njohuri të gjera rreth: Menaxhimit të sistemeve kompjuterike dhe të jetë në gjendje të ndërtojë sisteme informatike të sigurta;

Zhvillimit të projekteve të ndryshme në fushën e informatikës; Shqyrtimit të sistemeve ekzistuese IT të klientëve si dhe modeleve të biznesit; Planifikimit të ndryshimeve të sistemeve ekzistuese për të përmirësuar rrjedhën e punës; Aftësi për të menaxhuar punët dhe instalimet e sistemit kompjuterik në përputhje me rregulloret në fuqi dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit; Aftësi për menaxhim të përgjithshëm, menaxhim teknik dhe kërkim, zhvillim dhe menaxhim inovacioni në biznese dhe qendra teknologjike në fushën e informatikës; Të analizojnë përputhshmërinë e sistemeve kompjuterike brenda për brenda një organizate, në mënyrë që të kenë pajtueshmëri me njëri-tjetrin; Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar përgjegjësinë etike, legjislaicionin dhe kodin profesional të sjelljes në lidhje me praktikën profesionale të informatikës; Aftësi për të zbatuar parimet e ekonomisë, burimet njerëzore dhe menaxhimin e

projekteve, si dhe ligjin, rregulloret dhe standardet kompjuterike; Aftësi për të ngritur, udhëhequr dhe menaxhuar proceset e prodhimit të pajisjeve kompjuterike, duke garantuar sigurinë e njerëzve dhe pronës, cilësinë dhe miratimin e produktit përfundimtar.

Zbatimin me përpikmëri të standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë gjatë zhvillimit të procesit të mësimin.

Rritjen e kulturës së punës institucionale.

NJOHURITË KRYESORE

Programi i studimit Bachelor në Informatikë, i jep njohuri studentëve në drejtimet më të kërkuara sot në tregun e punës sepse nga studimet dhe analizat e bëra ka një rritje të kërkesës për specialistë të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Në vitin e parë, studentët e programit të studimit Bachelor në Informatikë, me profil Teknologji Informacioni, do zhvillojnë lëndët si: Bazat e Informatikës, Matematikë, Algoritmikë, Arkitekturë dhe Vlerësim Kompjuterash, Strukturë të dhënash etj, të cilat janë të rëndësishme për të vendosur bazat në formimin e tyre në fushën e informatikës. Në vitin e dytë, studentët do

zhvillojnë lëndët si: Programim, Sisteme Operimi, Sisteme Multimediale, Programim në Web, E-business, Statistikë etj, të cilat do t'i ndihmojnë ata të marrin njohuri në fusha shumë të rëndësishme për formimin e tyre. Ndërsa në vitin e tretë, studentët do zhvillojnë lëndë të veçanta sipas profilit Teknologji Informacioni që ata kanë zgjedhur.

Konkretisht, studentët do zhvillojnë lëndët: Administrim Sistemesh, Komunikim të Dhënash dhe Rrjetat Kompjuterike, Siguria e Sistemeve të Informacionit, Web Services, GIS, UML etj. Lëndët e profilit, të cilat janë zgjedhur me shumë kujdes në përputhje me situatën aktuale dhe kërkesat e tregut, i ndihmojnë studentët që të thellohen në disa nënfusha të rëndësishme.

REZULTATET E DIPLOMIT

Emërtimi i diplomës: Bachelor në Informatikë, me profil "Teknologji Informacioni"

Synimi kryesor i programit Bachelor në Informatikë me profil "Teknologji Informacioni", është që studentit në përfundim të ciklit të studimeve të ketë njohuritë e nevojshme dhe të:

Analizojnë sisteme informatike të teknologjisë së informacionit; Zhvillojnë softuerë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; Testojnë dhe analizojnë programe



Plani mësimor i Programit të studimit Bachelor në Informatikë, me profil **“TEKNOLOGJI INFORMACIONI”**

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SHKRIM AKADEMIK	6
2	BAZAT E INFORMATIKËS	6
	MATEMATIKË	
3	MATEMATIKË 1	6
4	MATEMATIKË 2	6
5	ALGORITMIKË	6
6	ARKITEKTURË DHE VLERËSIM KOMPJUTERASH	6
	LËNDË ME ZGJEDHJE:	
	FIZIKË	
7	SOCIOLOGJI	6
	HYRJE NË EKONOMI	
8	GJUHË E HUAJ	6
9	SISTEME LOGJIKE	6
10	STRUKTURË TË DHËNASH	6

dhe sisteme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; Identifikojnë fushat për përmirësim dhe studiojnë aspektet teorike dhe metodat operacionale për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; Vlerësojnë, planifikojnë e projekttojnë harduerë ose softuerë për aplikacione specifike përfshirë internet, intranet dhe sistemet multimediale; Konfigurojnë harduerë ose softuerë për aplikacione specifike përfshirë internet, intranet dhe sistemet multimediale; Hartojnë dhe zhvillojnë arkitekturën e sistemet e bazës së të dhënave, manaxhimin e zhvillimin e të dhënave. Analizojnë dhe zhvillojnë sisteme projektimi komplekse dhe specifitime të arkitekturës së të dhënave, modele dhe diagrame zhvillimi, integrimi e konfigurimi të sistemeve kompjuterike; Interpretojnë dhe vlerësojnë sisteme projektimi komplekse dhe specifitime të arkitekturës së

të dhënave, modele dhe diagrame zhvillimi, integrimi e konfigurimi të sistemeve kompjuterike.

Analizojnë sisteme informatike të biznesit, rrjete të komunikimit, baza të dhënash. Aktualizojnë licencat e kompjuterëve dhe të sistemit të operimit të rrjeteve, të sistemeve të transmetimit në TIK, etj.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Studenti i diplomuar në programin Bachelor në Informatikë, me profil Teknologji Informatiçi mund të punojë si: Specialist të shërbimeve të telekomunikacionit; Analistë dhe zhvillues të software dhe aplikacioneve; Specialistë të bazës së të dhënave dhe administratorë të sistemeve; Specialist të shërbimeve të TIK; Specialist të shërbimeve hardware-it; Specialist të shërbimeve software.

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
	PROGRAMIM	
11	PROGRAMIM 1	6
12	PROGRAMIM 2	6
13	SISTEME OPERIMI	6
14	SISTEME MULTIMEDIALE	6
	STATISTIKË	
15	STATISTIKË 1	6
16	STATISTIKË 2	6
17	E-BUSINESS	4
18	ETIKË DHE KOMUNIKIM NË BIZNES	4
19	PROGRAMIM WEB	6
20	MATEMATIKË 3	6
21	ÇËSHTJE LIGJORE TË INFORMATIKËS	4

VITI I TRETË

22	TEORI E BAZAVE TË TË DHËNAVE	6
23	ADMINISTRIM SISTEMESH	6
24	KOMUNIKIM TË DHËNASH DHE RRJETAT KOMPJUTERIKE	6
25	UML	6
26	WEB SERVICES	6
	LËNDË ME ZGJEDHJE:	
27	MENAXHIM MARKETING	6
28	GIS	6
29	SIGURIA E SISTEMEVE TË INFORMACIONIT	4
30	PRAKTIKA	6
31	DIPLOMA (PROVIMI FORMUES)	8

Totali i planit mësimor: 180

PRAKTIKA MËSIMORE


Studentët e zhvillojnë praktikën mësimore në auditor duke u ofruar javë pas javë takime me përfaqësues nga tregu i punës kombëtar dhe ndërkombëtar.

LEKSIONET E HAPURA

Si pjesë të strategjisë së universitetit, në UMSH, synohet të ofrohen si bashkëpunëtorë të jashtëm profesionistë nga tregu i punës, duke mundësuar që në auditor të gërshetohet shumë

mirë teoria me praktikën. Përveç kësaj, Departamenti i Informatikës dhe Formimit Shkencor, duke shfrytëzuar lidhjet personale të pedagogëve të saj, ka organizuar një sërë aktivitetesh me specialiste/profesionistë të fushës së teknologjisë së informacionit si dhe me antarë të bordit të tregut të punës me të cilët departamenti mban kontakte të ngushta. Këto aktivitete janë në formën e webinarëve, leksioneve të hapura, tavolinave të rumbullakta etj.

FAKULTETI I INFORMATIKËS



Diplomë Profesionale në Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profil: "Specialist Rrjetesh Kompjuterike"

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Diploma Profesionale në Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profil "Specialist Rrjetesh Kompjuterike" është strukturuar në mënyrë që t'u ofrojë studentëve përvetësimin e dijeve dhe kulturës së nevojshme në këtë fushë. Ata pajisjen me instrumentet themelore të domosdoshëm për të përballuar kërkesat e tregut të punës për një sërë profesionesh që lidhen me shumë elementë të funksionimit të bizneseve private, nevojave të veçanta të administratës publike dhe pushtetit vendor. Ky program përmban të gjithë elementet e tjerë të nevojshëm që garantojnë kalimin në mjaft sisteme të mësimi të vazhdueshëm profesional të përshtatshëm për metamorfozat e tregut të punës.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Njohuritë bazë në fushën e informatikës duke vënë theksin më shumë në formimin e tyre praktik krahas atij teorik. Aftësi për të identifikuar problemin, aftësi të të menduarit aftësi për

zgjidhjen e problemeve teknike që kanë të bëjnë me softweret, hardweret, rrjetat, platformat cloud. Aftësi që të sigurojnë mirëfunksionimin e infrastruktureve të rrjetit të Teknologjisë së Informacionit. Aftësi që të sigurojnë që rrjeti të jetë i sigurt sipas standarteve të fundit të sigurisë dhe funksional në zbatimin e tij.

Aftësi që të mirëmbajnë rrjetin kompjuterik duke instaluar programet e duhura, kryer lidhjen me kompjuterin dhe testimet paraprake për funksionim e tyre. Aftësi që të ofrojnë mbështetje për rrjetin kompjuterik dhe pajisjet në rastet e nevojshme. Aftësi që të sigurojnë administrimin e rrjetit kompjuterik, duke siguruar funksionim të pajisjeve të rrjetit dhe suport ndaj userave. Aftësi që të sigurojnë zhvillime të programeve të ndryshme në gjuhë të ndryshme programimi

NJOHURITË KRYESORE

Studentët e diplomës profesionale, fitojnë aftësinë për të zgjidhur vetë dhe bazuar në metodat profesionale, problemet që lindin në fushën e Informatikës, Elektronikës, Elektroteknikës. Programi

i studimit i kualifikon studentët në fushat kryesore të rrjetave dhe zhvillimit të sistemeve, biznesin elektronik, menaxhimin e informacionit dhe elektroshtëpiakeve

PRAKTIKA PROFESIONALE

Studentët e zhvillojnë praktikën në auditor duke u ofruar javë pas javë takime me përfaqësues nga tregu i punës kombëtar dhe ndërkombëtar. Përveç takimeve me tregun e punës atyre ju ofrohet edhe trajnim mbi soft skills.

REZULTATET E DIPLOMIMIT

Emërtimi i Diplomës: Diplomë Profesionale Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profile: Specialist Rrjetesh Kompjuterike Pas këtij programi, studentët pajisjen me instrumentet themelore të domosdoshëm për të përballuar kërkesat e tregut të punës për një sërë profesionesh që lidhen me shumë elementë të funksionimit të bizneseve private, nevojave të veçanta të administratës publike dhe pushtetit vendor. Ky program përmban të gjithë elementet e tjerë të nevojshëm që garantojnë kalimin në mjaft sisteme të mësimi të vazhdueshëm profesional të përshtatshëm për metamorfozat e tregut të punës.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Në epokën digjitale dhe transformuese në të cilën po jetojmë, profesionet që kanë të bëjnë me teknologjinë dhe informacionin janë një trend në rritje. Evente të tilla si krijimi i rrjeteve globale, përdorimi i paisjeve teknologjike dhe të mësuarit në distancë bëjnë që cdo qytet të jetë 'smart' dhe të përdorë teknologjinë. Këto zhvillime bëjnë që të rritet së tepërmi kërkesa për specialist rrjetesh kompjuterike që të ketë siguri në rrjet dhe funksionalitet të plotë.

LEKSIONET E HAPURA

Gjatë zhvillimit të programit Diplomë Profesionale Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profil: "Specialist Rrjetesh Kompjuterike" studentët do jenë pjesë e orëve të leksioneve nga profesionistët më të mirë në treg, drejtues të institucioneve dhe kompanive më në zë në fushën e Teknologjisë së Informacionit, Rrjetave kompjuterike, Pajisjeve Elektronike. Këto leksione të hapura u krijojnë mundësi studentëve të përfitojnë nga përvojat unike dhe njohuritë praktike të çdo lektori.



PLANI MËSIMOR PROFILI **SPECIALIST RRJETESH KOMPJUTERIKE**

VITI I PARË


Nr.	Lëndët	ECTS
1	KOMPJUTERI, NDËRTIMI, FUNKSIONET, ZHVILLIMET	6
2	MATEMATIKË	6
3	BAZAT E INFORMATIKËS	6
4	BAZAT E STATISTIKËS	6
5	GJUHË E HUAJ	4
1	APLIKIME KOMPJUTERIKE	6
2.	RRJETAT KOMPJUTERIKE	6
3	PROGRAMIM	8
4.	SIGURIA E SISTEMEVE TË INFORMACIONIT	6
5	ORGANIZIMI I SISTEMEVE KOMPJUTERIKE	6

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	WEB DESIGN	6
2	ARKITEKTURË KOMPJUTERI	6
3	PRODHOME DIXHITALE DHE SOFTWARE	6
4	LËNDË ME ZGJEDHJE ETIKË PROFESIONALE DHE KOMUNIKIM HARTIM DHE MENAXHIM PROJEKTESH	6
5	QARQE DHE PAJISJE ELEKTRONIKE PROFILI: SPECIALIST I RRJETAVE KOMPJUTERIKE	6
6	SISTEME SHFRYTËZIMI	6
7	TEKNOLOGJI DHE TOPOLOGJI RRJETASH	6
8	PROTOKOLLET E KOMUNIKIMIT	6
9	PRAKTIKË PROFESIONALE	6
10	PROJEKT PROFESIONAL/ PROVIM	6

Totali i planit mësimor: 120

FAKULTETI I INFORMATIKËS



Diplomë Profesionale në Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profil: "Teknik për Pajisje Elektronike"

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Diplomë Profesionale në Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profil "Teknik për Pajisje Elektronike" është zhvillimi dhe përgatitja e studenteve për t'u punësuar si teknik për pajisje elektronike në veprimtaritë profesionale që lidhen me drejtimin elektronik. Duke ofruar mbështetje për t'u njohur me teknologjitë dhe proceset teknologjike bashkëkohore që ndikojnë në kualifikimin profesional përkatës si dhe për të vijuar më tej mundësitë për të gjithë kompetencat profesionale, njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt formimit profesional dhe në nivele më të larta.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Njohuritë bazë në fushën e informatikës duke vënë theksin më shumë në formimin e tyre praktik krahas atij teorik. Aftësi për të identifikuar problemin, aftësi të të menduarit kritik, aftësi komunikuese si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve teknike që kanë të bëjnë

me softweret, hardweret, rrjetat, platformat cloud. Aftësi që të sigurojnë mirëfunksionimin e infrastruktures së rrjetit të Teknologjisë së Informacionit.

Aftësi që të sigurojnë që rrjeti të jetë i sigurt sipas standardeve të fundit të sigurisë dhe funksional në zbatimin e tij.

Aftësi që të mirëmbajnë rrjetin kompjuterik duke instaluar programet e duhura, kryer lidhjen me kompjuterin dhe testimet paraprake për funksionim e tyre. Aftësi që të ofrojnë mbështetje për rrjetin kompjuterik dhe pajisjet në rastet e nevojshme. Aftësi që të sigurojnë administrimin e rrjetit kompjuterik, duke siguruar funksionim të pajisjeve të rrjetit dhe suport ndaj userave. Aftësi që të sigurojnë zhvillime të programeve të ndryshme në gjuhë të ndryshme programimi.

NJOHURITË KRYESORE

Studentët e diplomës profesionale fitojnë aftësinë për të zgjidhur vetë dhe bazuar në metodat profesionale problemet që lindin në fushën e Informatikës, Elektronikës, Elektroteknikës. Programi i studimit i kualifikon studentët në fushat kryesore të rrjetave dhe zhvillimit të sistemeve, biznesin elektronik, menaxhimin e informacionit dhe

elektroshtëpiakeve.

PRAKTIKA PROFESIONALE

Studentët e zhvillojnë praktikën në auditor duke u ofruar javë pas javë takime me përfaqësues nga tregu i punës kombëtar dhe ndërkombëtar. Përveç takimeve me tregun e punës atyre ju ofrohet edhe trajnim mbi soft skills.

REZULTATET E DIPLOMIT

Emërtimi i Diplomës: Diplomë Profesionale Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profile: "Teknik Për Pajisje Elektronike" Pas këtij programi, studentët pajisjen me instrumentet themelore të domosdoshëm për të përballuar kërkesat e tregut të punës për një sërë profesionesh që lidhen me shumë elementë të funksionimit të bizneseve private, nevojave të veçanta të administratës publike dhe pushtetit vendor. Ky program përmban të gjithë elementet e tjerë të nevojshëm që garantojnë kalimin në mjaft sisteme të mësimin të vazhdueshëm profesional të përshtatshëm për metamorfozat e tregut të punës.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Përfundimi me sukses i studimit profesional në profilin "Teknik për pajisje elektronike", i pajis

studentet me Diplomën Profesionale. Ky kualifikim ju jep mundësinë që t'i drejtohet tregut të punës për punësim si teknik elektronik në biznesin e komunikimeve elektronike, në pika servisi të riparimeve të pajisjeve elektronike si dhe në veprimtari të tjera që veprojnë në drejtimin e elektronikës. Gjithashtu, mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e elektronikës. Me përfundimin e këtij cikli, secili student ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin e studimeve të mëtejshme universitare (Bachelor + Master).

LEKSIONET E HAPURA

Gjatë zhvillimit të programit Diplomë Profesionale Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profil: "Teknik Për Pajisje Elektronike" studentët do jenë pjesë e orëve të leksioneve nga profesionistët më të mire në treg, drejtues të institucioneve dhe kompanive më në zë në fushën e Teknologjisë së Informacionit, Rrjetave kompjuterike, Pajisjeve Elektronike. Këto leksione të hapura u krijojnë mundësi studentëve të përfitojnë nga përvojat unike dhe njohuritë praktike të çdo lektori.



PLANI MËSIMOR PROFILI TEKNIK PËR PAJISJE ELEKTRONIKE

VITI I PARË


Nr.	Lëndët	ECTS
1	KOMPJUTERI, NDËRTIMI, FUNKSIONET, ZHVILLIMET	6
2	MATEMATIKË	6
3	BAZAT E INFORMATIKËS	6
4	BAZAT E STATISTIKËS	6
5	GJUHË E HUAJ	4
6	APLIKIME KOMPJUTERIKE	6
7	RRJETAT KOMPJUTERIKE	6
8	PROGRAMIM	8
9	SIGURIA E SISTEMEVE TË INFORMACIONIT	6
10	ORGANIZIMI I SISTEMEVE KOMPJUTERIKE	6

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	WEB DESIGN	6
2	ARKITEKTURË KOMPJUTERI	6
3	PRODHIME DIXHITALE DHE SOFTWARE	6
4	LËNDË ME ZGJEDHJE ETIKË PROFESIONALE DHE KOMUNIKIM HARTIM DHE MENAXHIM PROJEKTESH	6
5	QARQE DHE PAJISJE ELEKTRONIKE PROFILI: TEKNIK PËR PAJISJE ELEKTRONIKE	6
6	BAZAT E ELEKTROTEKNIKËS	6
7	ELEKTRONIKË DIXHITALE	6
8	ELEKTRONIKA E PJESËVE TË FABRIKIMIT	6
9	PRAKTIKË PROFESIONALE	6
10	PROJEKT PROFESIONAL/ PROVIM	6

Totali i planit mësimor: 120

FAKULTETI I INFORMATIKËS



Diplomë Profesionale në Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profil: “Teknik për Software dhe Dixhitalizim”

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Diplomë Profesionale në Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profil “Teknik për Software dhe Dixhitalizim”, është të përgatisë specialistë me një bagazh të konsiderueshëm teknik dhe teorik që do ta bënte të aftë studentin të ambienteve menjëherë me kërkesat e tregut të punës si në strukturat shtetërore ashtu edhe në kompani të ndryshme private. Ai është strukturuar në mënyrë që t’u ofrojë studentëve përvetësimin e dijeve dhe kulturës së nevojshme në fushën e teknologjisë së informacionit. Pas këtij programi, studentët pajisjen me instrumentet themelore të domosdoshëm për të përballuar kërkesat e tregut të punës për një sërë profesioneve që lidhen me shumë elementë të funksionimit të bizneseve private, nevojave të veçanta të administratës publike dhe pushtetit vendor.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Njohuritë bazë në fushën e informatikës duke vënë theksin

më shumë në formimin e tyre praktik krahas atij teorik, aftësi për të identifikuar problemin, aftësi të të menduarit kritik, aftësi komunikuese si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve teknike që kanë të bëjnë me softweret, hardweret, rrjetat, platformat cloud. Aftësi që të sigurojnë mirëfunksionimin e infrastruktures së rrjetit të Teknologjisë së Informacionit. Aftësi që të sigurojnë që rrjeti të jetë i sigurt sipas standarteve të fundit të sigurisë dhe funksional në zbatimin e tij. Aftësi që të mirëmbajnë rrjetin kompjuterik duke instaluar programet e duhura, kryer lidhjen me kompjuterin dhe testimet paraprake për funksionin e tyre. Aftësi që të ofrojnë mbështetje për rrjetin kompjuterik dhe pajisjet në rastet e nevojshme. Aftësi që të sigurojnë administrimin e rrjetit kompjuterik, duke siguruar funksionin të pajisjeve të rrjetit dhe suport ndaj userave. Aftësi që të sigurojnë zhvillime të programeve të ndryshme në gjuhë të ndryshme programimi.

NJOHURITË KRYESORE

Studentët e diplomës profesionale, fitojnë aftësinë për të zgjidhur vetë dhe bazuar në

metodat profesionale, problemet që lindin në fushën e Informatikës, Elektronikës, Elektroteknikës. Programi i studimit i kualifikon studentët në fushat kryesore të rrjetave dhe zhvillimit të sistemeve, biznesin elektronik, menaxhimin e informacionit dhe elektroshtëpiakeve.

PRAKTIKA PROFESIONALE

Studentët e zhvillojnë praktikën në auditor duke u ofruar javë pas javë takime me përfaqësues nga tregu i punës kombëtar dhe ndërkombëtar. Përveç takimeve me tregun e punës atyre ju ofrohet edhe trajnim mbi soft skills.

REZULTATET E DIPLOMIMIT

Emërtimi i Diplomës: Diplomë Profesionale Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profile: Teknik për Software dhe Dixhitalizim
Pas këtij programi, studentët pajisjen me instrumentet themelore të domosdoshëm për të përballuar kërkesat e tregut të punës për një sërë profesioneve që lidhen me shumë elementë të funksionimit të bizneseve private, nevojave të veçanta të administratës publike dhe pushtetit vendor. Ky program përmban të gjithë elementet e tjerë të nevojshëm

që garantojnë kalimin në mjaft sisteme të mësimin të vazhdueshëm profesional të përshtatshëm për metamorfozat e tregut të punës.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Në epokën digjitale dhe sfidat që kalojmë në këtë kohë digjitalizimi, transformimi digjital, teknologjia janë kryefjalë e momentit. Gjithë ky boom kërkon edhe profesionistë të fushës. Teknikët software janë e tashmja edhe e ardhmja e tregut të punës. Me përfundimin e këtij cikli, secili student ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin e studimeve të mëtejshme universitare (Bachelor + Master)

LEKSIONET E HAPURA

Gjatë zhvillimit të programit Diplomë Profesionale Teknologji Informacioni dhe Aplikime Informatike, me profil: “Teknik për Software dhe Dixhitalizim” studentët do jenë pjesë e orëve të leksioneve nga profesionistët më të mirë në treg, drejtues të institucioneve dhe kompanive më në zë në fushën e Teknologjisë së Informacionit, Rrjetave kompjuterike, Pajisjeve Elektronike. Këto leksione të hapura u krijojnë mundësi studentëve të përfitojnë nga përvojat unike dhe njohuritë praktike të çdo lektori.



PLANI MËSIMOR PROFILI TEKNIK PËR SOFTWARE DHE DIXITALIZIM

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	KOMPJUTERI, NDËRTIMI, FUNKSIONET, ZHVILLIMET	6
2	MATEMATIKË	6
3	BAZAT E INFORMATIKËS	6
4	BAZAT E STATISTIKËS	6
5	GJUHË E HUAJ	4
6	APLIKIME KOMPJUTERIKE	6
7	RRJETAT KOMPJUTERIKE	6
8	PROGRAMIM	8
9	SIGURIA E SISTEMEVE TË INFORMACIONIT	6
10	ORGANIZIMI I SISTEMEVE KOMPJUTERIKE	6

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	WEB DESIGN	6
2	ARKITEKTURË KOMPJUTERI	6
3	PRODHIME DIXHITALE DHE SOFTWARE	6
4	LËNDË ME ZGJEDHJE ETIKË PROFESIONALE DHE KOMUNIKIM HARTIM DHE MENAXHIM PROJEKTESH	6
5	QARQE DHE PAJISJE ELEKTRONIKE PROFILI: TEKNIK PËR SOFTWARE DHE DIXITALIZIM	6
6	MULTIMEDIA DIXHITALE	6
7	QARQET DIXHITALE	6
8	SISTEMET MULTIMEDIALE/AUDIO/VIDEO	6
9	PRAKTIKË PROFESIONALE	6
10	PROJEKT PROFESIONAL/ PROVIM	6

Totali i planit mësimor: 120





FAKULTETI I


SHKENCAVE EKONOMIKE

ECON

3 BACHELOR 8 MASTER 3 DOKTORATURE



FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE



Prof. Dr. *Lindita Milo*

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil "Financë, Bankë dhe Kontabilitet"

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil "Financë, Bankë dhe Kontabilitet" është pjesë përbërëse e studimeve të ciklit të parë në strukturën akademike të fakultetit të shkencave ekonomike në UMSH. Qëllimi i këtij programi është përgatitja e specialistëve për sektorin publik, privat, jofitimprurës në fushën ekonomike, si dhe gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe perspektive të zhvillimit të vendit dhe rajonit. Programi e realizon këtë objektiv duke ju dhënë studentëve në UMSH një edukim cilësor, të qëndrueshëm dhe praktik me anë të mësimdhënies aktive, kërkimit shkencor, si dhe partneriteteve me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky program mbështetet njëkohësisht në një bashkëpunim të gjerë me biznesin jo vetëm për të evidentuar sinjalet e tregut të punës por edhe për të ndërtuar një platformë dijesh të përdorshme. Në këtë mënyrë studentët mund të integrohen më shpejt në tregun e punës.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme në fushën e financës dhe kontabilitetit ofrimi nga ky program i kompetencave teorike dhe praktike në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri, por edhe më gjerë, duke u përshtatur ndryshimeve që sjell zhvillimi i teknologjisë së informacionit. Programi mundëson studimin teorik dhe aplikativ në fushën e shkencave ekonomike për të përgatitur specialistë me njohuri dhe aftësi që të punojnë në profilet përkatëse dhe me njohuritë themelore në fushën e financës, bankave, kontabilitetit, menaxhimit dhe legjislacionit të biznesit; Pajisja e studenteve me njohuri të nevojshme për vazhdimin e studimeve të niveleve më të larta apo specializimeve të mëtejshme në profile me të ngushta;

NJOHURITË KRYESORE

Ky program studimi ka si mision t'i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e biznesit, atë të operacioneve financiare dhe të kontabilitetit. Programi mundëson studimin teorik dhe aplikativ në fushën e menaxhimit dhe të marketingut, financës dhe kontabilitetit, por edhe të legjislacionit të së drejtës civile, të së

drejtës së punës, ndërtimit të kontratave të ndryshme etj. Njohuritë e zgjeruara që ofron programi i pajisin studentet me aftësi të të shkruarit, komunikimit dhe punës në grup. Ata përgatiten për të filluar dhe zhvilluar karrierën e tyre në organizata të sektorit privat, të sektorit publik dhe të atij jofitimprurës. Njëkohësisht njohuritë e ofruara nga ky program dhe aftësitë që përfitojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre avancimin drejt një karriere akademike ose kërkimore, nëpërmjet vazhdimin të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur mundësitë për sukses profesional në tregun e punës.

PRAKTIKA MËSIMORE

Studentëve që do të ndjekin programin e studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil Financë, Bankë dhe Kontabilitet u ofrohet mundësia ta zhvillojnë praktikën profesionale në institucione bashkëpunuese me UMSH ose ta zhvillojnë me orë intensive në auditor. Kështu do të mësojnë të përdorin programet kompjuterike të kontabilitetit të aplikuar, duke u praktikuar në veprimet e një njësie ekonomike, drejtimin dhe rolin e raporteve të kontabilitetit në vendimmarrje, rolin e kontabilistit në ndërtimin e një sistemi të kontabilitetit të

aplikuar si dhe do pajisen me një certifikatë të posaçme për njohuritë e marra në kontabilitetin e aplikuar. Gjithashtu do të thellohen në përdorimin e teknologjisë ndihmëse në kërkimin e tregut të punës, do të mësojnë se si të përgatiten në prezantimet e para me tregun e punës nëpërmjet intervistave të simuluar, bërjes së një letre motivimi dhe një CV të formatit bashkëkohor, për t'u lehtësuar hyrjen në tregun e punës pas diplomimit.

REZULTATET E DIPLOMIT

Emërtimi i Diplomës: Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil "Financë, Bankë dhe Kontabilitet", Përgatitja e studentëve me aftësi vendimmarrëse është synimi kryesor të cilët pedagogët zhvillojnë tek studentët duke aplikuar metoda të avancuara në zgjidhjen e problematikave. Programi është ndërthurur me njohuritë teorike me aplikimin praktik të lidhura direkt me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Në përfundim programit të studimit studentët përfitojnë aftësi, shkathtësi dhe kompetenca të përcaktuara për çdo lëndë nisur nga përvoja më e mirë e shkollave ekonomike, nga praktika e punës në kompani.



Të diplomuarit në Bachelor Shkencë Ekonomike me profil Financë, Bankë dhe Kontabilitet, me mbarimin e studimeve mund të punojnë në çdo biznes të madh apo të vogël në fushën e kontabilitetit, financës, auditimit, sektorit të prokurimeve dhe blerjeve. Ata në bazë të edukimit të përfutur në këtë program mund të angazohen: Në sistemin bankar dhe kryesisht në sektorët e informacionit financiar primar, në investimet dhe diversifikimin e fondeve, në sistemin e pagesave dhe garancisë, në sigurimet e të gjitha tipeve, etj. Në çdo subjekt me aktivitet në fushën financiare ose të përdorimit të fondeve të investimit, të pensioneve, të spekulimeve të monedhës, etj. Në sektorin publik, në nivel qendror dhe lokal, në drejtoritë e financës,

të prokurimeve publike, dhe në drejtori të ndryshme që lidhen me menaxhimin e fondeve. Në të gjitha subjektet private për regjistrimet kontabël dhe hartimin e pasqyrave financiare. Ata mund të punojnë dhe në të gjitha subjektet në pozicionet që direkt dhe indirekt lidhen me procedura financiare, në sektorin e auditimit financiar, etj.

LEKSIONET E HAPURA

UMSH zhvillon aktivitete dhe leksione të hapura që synojnë nxitjen e punësimit të studentëve me institucione shtetërore dhe kompani private, duke krijuar marrëveshje bashkëpunimi në funksion të studentëve për integrimin e shpejtë të tyre në tregun e punës. Këto leksione u krijojnë mundësi studentëve të përfitojnë njohuri praktike të profesionit të tyre.

PLANI MËSIMOR PROFIL FINANCË, BANKË DHE KONTABILITET

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SOCIOLOGJI	6
	EKONOMIKS	8
2	2.1 Ekonomiks I	4
	2.2 Ekonomiks II	4
3	SHKRIM AKADEMIK	6
4	INFORMATIKË	6
	GJUHË E HUAJ	8
5	5.1 Gjuhë e Huaj I	4
	5.2 Gjuhë e Huaj II	4
	MATEMATIKË	12
6	6.1 Matematikë	6
	6.2 Matematikë	6
7	NJOHURI MBI TRASHËGIMINË KULTURORE DHE NATYRORE TË SHQIPËRISË DHE MESHJERËT	6
8	FINANCË	8


VITI I DYTË:

Nr.	Lëndët	ECTS
1	KONTABILITET	10
	1.1 Kontabilitet I	6
	1.2 Kontabilitet II	4
2	EKONOMI DHE POLITIKA MONETARE	10
	2.1 Politika Monetare	4
	2.2 Ekonomi Monetare	6
3	MENAXHIM	7
4	E DREJTË BIZNESI	8
5	MARKETING	7
6	STATISTIKË	8
7	E- BUSINESS	6
8	Lëndë me Zgjedhje (Zgjidhet 1 lëndë nga studenti) HISTORIA E MENDIMIT EKONOMIK ETIKA DHE KOMUNIKIMI NË BIZNES	4

VITI I TRETË:

Nr.	Lëndët	ECTS
1	KONTABILITET FINANCIAR	8
2	FINANCAT PUBLIKE DHE POLITIKAT FISKALE	12
	2.1 Financa Publike	6
	2.2 Politika Fiskale/Taksim	6
3	MENAXHIM I BURIMEVE NJERËZORE	6
4	KONTABILITETI I KOSTOS DHE I DREJTIMIT	6
5	DREJTIM FINANCIAR	8
	5.1 Drejtim Financiar I	4
	5.2 Drejtim Financiar II	4
6	Lëndë me Zgjedhje (Zgjidhet 1 lëndë nga studenti) TREGJET DHE INSTITUCIONET FINANCIARE E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE EKONOMIKSI I KONKURENCËS	6
7	PRAKTIKË	6
8	PROVIM FORMIMI/ DIPLOMA	8

FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE



Programi i studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil "Administrim Biznesi"

PERSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike (SHE) me profil "Administrim biznesi", është pjesë përbërëse e studimeve të ciklit të parë në strukturën akademike të Fakultetit të Shkencave Ekonomike në UMSH. Qëllimi i këtij programi është përgatitja e specialistëve të fushës së administrimit të biznesit, të pajisur me dije teorike dhe aplikime praktike, të gatshëm për t'u integruar suksesshëm në tregun e punës në sektorin publik, privat dhe jofitimprurës. Programi e realizon këtë objektiv duke ju dhënë studentëve në UMSH një edukim cilësor, të qëndrueshëm dhe praktik me anë të mësimdhënies aktive, kërkimit shkencor, si dhe partneriteteve me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky program mbështetet njëkohësisht në një bashkëpunim të gjerë me biznesin për të evidentuar dinamikat e tregut të punës dhe për të ndërtuar një platformë dijesh të përdorshme, në mënyrë që të diplomuarit të integrohen më shpejt në tregun e punës.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme në fushën e shkencave ekonomike, biznesit dhe elementëve ligjorë që i prekin ato. Mundësimi i studimit teorik dhe aplikativ në fushën e shkencave ekonomike për të përgatitur specialistë me dije dhe aftësi që të punojnë në administrim dhe menaxhim, por që marrin edhe njohuritë themelore në fushën e financës, bankave, kontabilitetit, legjislacionit të biznesit dhe fusha të tjera të ndërlidhura; Ofrimi nga ky program i kompetencave teorike dhe praktike në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri, por edhe më gjerë, duke ju përshtatur ndryshimeve që sjell zhvillimi i teknologjisë së informacionit. Pajisja e studentëve me njohuri të nevojshme për vazhdimin e studimeve të niveleve më të larta apo specializimeve të mëtejshme në profile më të ngushta.

NJOHURITË KRYESORE

Ky program studimi ka si mision t'i pasijesë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e administrimit dhe menaxhimit të biznesit. Programi mundëson studimin teorik dhe aplikime praktike në fushën e menaxhimit dhe të marketingut, financës dhe kontabilitetit, të ekonomiksit dhe të së drejtës së

biznesit, teknologjisë së informacionit, etj. Njohuritë e zgjeruara që ofron programi i pajisin studentet me aftësi të shkruarit, komunikimit dhe punës në grup. Përgatitja e studentëve me dije dhe aftësi vendimmarrëse është synimi kryesor që pedagogët e realizojnë gjatë ciklit të studimeve duke prezantuar dhe aplikuar metoda të avancuara në zgjidhjen e problematikave. Ata përgatiten për të filluar dhe zhvilluar karrierën e tyre në organizata të sektorit privat, të sektorit publik dhe të atij jofitimprurës. Njëkohësisht njohuritë e ofruara nga ky program dhe aftësitë që përfitojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre avancimin drejt një karriere akademike ose kërkimore, nëpërmjet vazhimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur mundësitë për sukses profesional në tregun e punës.

PRAKTIKA MËSIMORE

Studentëve që do të ndjekin programin e studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil "Administrim Biznesi" ju ofrohet mundësia ta zhvillojnë praktikën profesionale në institucione bashkepunuese me UMSH ose ta zhvillojnë me orë intensive në auditor. Kështu do të praktikojnë teknikat e menaxhimit, analizës dhe vendimmarrjes në situata konkrete biznesi ose aktivitete të tjera. Njëkohësisht mësojnë të

përdorin programet kompjuterike në fushën e menaxhimit dhe të kontabilitetit të aplikuar, duke u praktikuar në veprimet e shumëllojshme që realizimi i aktivitetit të një njësie ekonomike kërkon. Studentët pajisen me një çertifikatë të posaçme për njohuritë e marra në kontabilitetin e aplikuar. Gjatë praktikës aftësohen në përdorimin e teknologjisë ndihmëse në kërkimin e tregut të punës, mësojnë se si të përgatiten për prezantimet e para me tregun e punës nëpërmjet intervistave të simuluar, bërjes së një letre motivimi dhe një CV të formatit bashkëkohor, për t'ju lehtësuar hyrjen në tregun e punës pas diplomimit.

REZULTATET E DIPLOMIT

Programi ndërthur njohuritë teorike me aplikimin praktik, të lidhura direkt me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës. Në përfundim të programit studentët përfitojnë aftësi, shkathtësi dhe kompetenca të përcaktuara për çdo lëndë dhe të kombinuara ndërmjet tyre, nisur nga përvoja më e mirë e shkollave ekonomike, nga praktika e punës në kompani dhe nga trendet e zhvillimit të profesioneve.

Ata pajisen me Diplomë: Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil "Administrim Biznesi"



MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KARRIERA PROFESIONALE

Të diplomuarit në Bachelor SHE me profil Administrim Biznesi në përfundim të programit kanë të gjitha aftësitë për të punuar: Në sektorin e administrimit logjistik, të menaxhimit të prodhimit dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore. Ata mund të punojnë në të gjitha organizatat në pozicione që lidhen direkt dhe indirekt me drejtimin e menaxhimit. Mundësitë e punësimit janë edhe në administratën shtetërore, si në pozicione administrative ashtu dhe në pozicione menaxheriale. Në biznese të mëdha dhe të vogla në sektorët e shitjeve, në të gjithë zinxhirin e aktivitetëve përkatës dhe në sistemet me parashitje.

Statistikisht deri më sot pjesa më e madhe e të diplomuarve marrin përvojat e para të punës në keto sektore. Në sektorin e blerjeve, si në institucione shtetërore ku realizohen procedurat e prokurimeve publike, ashtu edhe në sektorin privat ku procedohet me vlerësimin e ofertave me zgjedhje optimale.

Leksionet e hapura në auditor UMSH zhvillon aktivitete dhe leksione të hapura me pjesëmarrjen e specialistëve nga biznesi, institucionet publike dhe academia, që sjellin në auditor risi dhe përvoja në fusha të gjera të ekspertizës. Këto leksione u krijojnë mundësi studentëve të përfitojnë njohuri praktike të profesionit të tyre dhe për integrimin e shpejtë të tyre në tregun e punës.

PLANI MËSIMOR PROFILI ADMINISTRIM BIZNESI

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SOCIOLOGJI	6
2	EKONOMIKS	8
	2.1 Ekonomiks I	4
	2.2 Ekonomiks II	4
3	SHKRIM AKADEMIK	6
4	INFORMATIKË	6
5	GJUHË E HUAJ	8
	5.1 Gjuhë e Huaj I	4
	5.2 Gjuhë e Huaj II	4
6	MATEMATIKË	12
	6.1 Matematikë	6
	6.2 Matematikë	6
7	NJOHURI MBI TRASHËGIMINË KULTURORE DHE NATYRORE TË SHQIPËRISË DHE MESDHEUT	6
8	FINANCË	8

VITI I DYTË:


Nr.	Lëndët	ECTS
1	KONTABILITET	10
	1.1 Kontabilitet I	6
	1.2 Kontabilitet II	4
2	EKONOMI DHE POLITIKA MONETARE	10
	2.1 Politika Monetare	4
	2.2 Ekonomi Monetare	6
3	MENAXHIM	7
4	E DREJTË BIZNESI	8
5	MARKETING	7
6	STATISTIKË	8
7	E- BUSINESS	6
8	Lëndë me Zgjedhje (Zgjidhet 1 lëndë nga studenti) HISTORIA E MENDIMIT EKONOMIK ETIKA DHE KOMUNIKIMI NË BIZNES	4

VITI I TRETË:

Nr.	Lëndët	ECTS
1	KONTABILITET FINANCIAR	8
2	MENAXHIM OPERACIONAL DHE STRATEGJIK	14
	5.1 Menaxhim i Operacioneve	7
	5.2 Menaxhim Strategjik	7
3	MENAXHIM I BURIMEVE NJERËZORE	6
4	BIZNES NDËRKOMBËTAR	6
5	SJELLJE ORGANIZATIVE	6
6	Lëndë me Zgjedhje (Zgjidhet 1 lëndë nga studenti) QEVERISJE KORPORATASH EKONOMIKSI I KONKURENCËS E DREJTA E SHOQËRIVE TREGTARE	6
7	PRAKTIKË	6
8	PROVIM FORMIMI/ DIPLOMA	8

Totali i planit mësimor: 180

FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE



Programi i studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil "Biznes dhe Ligj"

PERSHKRIM I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike (SHE) me profil "Biznes dhe Ligj" është pjesë përbërëse e studimeve të ciklit të parë në strukturën akademike të Fakultetit të Shkencave Ekonomike në UMSH. Qëllimi i këtij programi është përgatitja e specialistëve, që i përshtaten pozicioneve të punës të lidhura me prokurime, kontraktime dhe raporte ekonomiko-juridike, të aplikuar me dije teorike dhe aplikime praktike, të gatshëm për t'u integruar suksesshëm në tregun e punës në sektorin publik, privat dhe jofitimprurës. Programi e realizon këtë objektiv duke ju dhënë studentëve në UMSH një edukim cilësor, të qëndrueshëm dhe praktik me anë të mësimdhënies aktive, kërkimit shkencor, si dhe partneriteteve me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky program mbështetet njëkohësisht në një bashkëpunim të gjerë me biznesin për të evidentuar dinamikën e tregut të punës dhe për të ndërtuar një platformë dijesh të përdorshme, në mënyrë që të diplomuarit të integrohen më shpejt në tregun e punës.

www.umsh.edu.al

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Pajisja e studentëve me njohuritë e nevojshme në fushën e shkencave ekonomike, biznesit dhe elementëve ligjorë që i prekin ato. Mundësimi i studimit teorik dhe aplikativ në fushën e shkencave ekonomike për të përgatitur specialistë me dije dhe aftësi në administrim dhe zbatim të legjislacionit të biznesit, por që marrin edhe njohuritë themelore në fushën e financës, bankave, kontabilitetit dhe fusha të tjera të ndërlidhura: Ofrimi nga ky program i kompetencave teorike dhe praktike në përputhje me nevojat e tregut të punës në Shqipëri, por edhe më gjerë, duke u përshtatur ndryshimeve që sjell zhvillimi i teknologjisë së informacionit. Pajisja e studentëve me njohuri të nevojshme për vazhdimin e studimeve të niveleve më të larta apo specializimeve të mëtejshme në profile më të ngushta.

NJOHURITE KRYESORE TE PROGRAMIT

Ky program studimi ka si mision t'i pajisë studentët me një sistem bazë njohurish që i formon ata në fushën e administrimit dhe menaxhimit të biznesit. Programi mundëson studimin teorik dhe aplikime praktike në fushën e menaxhimit dhe të marketingut, financës dhe kontabilitetit, të ekonomisë dhe të së drejtës së biznesit, teknologjisë së

informacionit, etj. Njohuritë e zgjeruara që ofron programi i pajisin studentet me aftësi të shkruarit, komunikimit dhe punës në grup. Përgatitja e studentëve me dije dhe aftësi vendimmarrëse është synimi kryesor që pedagogët e realizojnë gjatë ciklit të studimeve duke prezantuar dhe aplikuar metoda të avancuara në zgjidhjen e problematikave. Ata përgatiten për të filluar dhe zhvilluar karrierën e tyre në organizata të sektorit privat, të sektorit publik dhe të atij jofitimprurës, në pozicione që kërkojnë dije të fushës ekonomike dhe juridike. Njëkohësisht njohuritë e ofruara nga ky program dhe aftësitë që përfitojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre avancimin drejt një karriere akademike ose kërkimore, nëpërmjet vazhdimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur mundësitë për sukses profesional në tregun e punës.

PRAKTIKAT PROFESIONALE

Studentëve që do të ndjekin programin e studimit Bachelor në Shkenca Ekonomike u ofrohet mundësia ta zhvillojnë praktikën profesionale në institucione bashkepunuese me UMSH ose ta zhvillojnë me orë intensive në auditor. Kështu do të praktikojnë teknikat e menaxhimit, analizës dhe vendimmarrjes në situata konkrete biznesi ose aktivitetesh të tjera. Njëkohësisht mësojnë të përdorin programet kompjuterike

në fushën e menaxhimit dhe të kontabilitetit të aplikuar, duke u praktikuar në veprimet e shumëllojshme që realizimi i aktivitetit të një njësie ekonomike kërkon. Klinika Ligjore që funksionon në UMSH shërben si një laborator idesh dhe rastesh studimore ku studentët e këtij profili marrin eksperiencën të vlefshme për ardhshëm të tyre profesionale. Gjatë praktikës aftësohen në përdorimin e teknologjisë ndihmëse në kërkimin e tregut të punës, mësojnë se si të përgatiten për prezantimet e para me tregun e punës nëpërmjet intervistave të simuluar, bërjes së një letre motivimi dhe një CV të formatit bashkëkohor, për t'ju lehtësuar hyrjen në tregun e punës pas diplomimit.

REZULTATET E DIPLOMIT

Programi ndërthur njohuritë teorike me aplikimin praktik, të lidhura direkt me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës. Në përfundim të programit studentët përfitojnë aftësi, shkathtësi dhe kompetenca të përcaktuara për çdo lëndë dhe të kombinuara ndërmjet tyre, nisur nga përvoja më e mirë e shkollave ekonomike, nga praktika e punës në kompani dhe nga trendet e zhvillimit të profesioneve.

Ata pajisen me Diplomë: Bachelor në Shkenca Ekonomike me profil "Biznes dhe Ligj"



PLANI MËSIMOR PROFILI "BIZNES DHE LIGJ"

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SOCIOLOGJI	6
2	EKONOMIKS	8
	2.1. Ekonomiks I	4
	2.2. Ekonomiks II	4
3	SHKRIM AKADEMIK	6
4	INFORMATIKË	6
5	GJUHË E HUAJ	8
	5.1 Gjuhë e Huaj I	4
	5.2 Gjuhë e Huaj II	4
6	MATEMATIKË	12
	6.1 Matematikë	6
	6.2 Matematikë	6
7	NJOHURI MBI TRASHËGIMINË KULTURORE DHE NATYRORE TË SHQPËRISË DHE MESDHEUT	6
8	FINANCË	8

VITI I DYTË:

Nr.	Lëndët	ECTS
	KONTABILITET	10
1	1.1. Kontabilitet I	6
	1.2. Kontabilitet II	4
	EKONOMI DHE POLITIKA MONETARE	10
2	2.1 Politika Monetare	4
	2.2 Ekonomi Monetare	6
3	MENAXHIM	7
4	E DREJTË BIZNESI	8
5	MARKETING	7
6	STATISTIKË	8
7	E- BUSINESS	6
8	LËNDË ME ZGJEDHJE HISTORIA E MENDIMIT EKONOMIK ETIKA DHE KOMUNIKIMI NË BIZNES	4

VITI I TRETË:

Nr.	Lëndët	ECTS
1	KONTABILITET FINANCIAR	8
2	BIZNES NDËRKOMBËTAR	6
3	MENAXHIM I BURIMEVE NJERËZORE	6
4	E DREJTA ADMINISTRATIVE DHE E PUNËS E DREJTA FISKALE & POLITIKA FISKALE	12
5	5.1 E drejta Fiskale 5.2 Politika Fiskale/Taksim	6
6	LËNDË ME ZGJEDHJE EKONOMIKSI I KONKURENCËS E DREJTA E SHOQERIVE TREGTARE ACQUIS COMMUNITAIRE	6
7	PRAKTIKË	6
8	PROVIM FORMIMI/ DIPLOMA	8

Totali i planit mësimor: 180

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KARRIERA PROFESIONALE


Të diplomuarit në Bachelor në SHE me profil "Biznes dhe Ligj" mund të punojnë në të gjitha pozicionet ku nevojiten dije ekonomike menaxheriale të kombinuara me dije juridike dhe më konkretisht: Në të gjitha pozicionet që përfshijnë operacione të ndërmjetme me varësi ekonomike por njëkohësisht dhe me varësi juridike. Ata mund të zenë pozicione që lidhen me prokurimet, marrëdhëniet kontraktore në kompani prodhimi dhe shërbimi, duke plotësuar nevojat e organizatave për t'ju përgjigjur korrektësisht kërkesave të

legjisacionit fiskal dhe të punës, nëpërmjet angazhimit të punonjësve të kualifikuar dhe me kosto efektive.

LEKSIONET E HAPURA NË AUDITOR

UMSH zhvillon aktivitete dhe leksione të hapura me pjesëmarrjen e specialistëve nga biznesi, institucionet publike dhe akademia, që sjellin në auditor risi dhe përvoja në fusha të gjera të ekspertizës. Këto leksione u krijojnë mundësi studentëve të përfitojnë njohuri praktike të profesionit të tyre dhe për integrimin e shpejtë të tyre në tregun e punës.

FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE



Diplomë Profesionale në "Menaxhim dhe Marketing i Turizmit"

PERSHKRIM I PROGRAMIT

Diplomë profesionale në "Menaxhim dhe Marketing i Turizmit" është risia që UMSH ofron për të gjithë studentët apo të apasionuarit pas industrisë turistike, të cilët do të përmbushin nevojat aktuale dhe dinamike të tregut për profesionistë në funksion të menaxhimit, marketingut, promovimit të turizmit dhe aktiviteteve të lidhura me të. Misioni i këtij programi studimi Diplomë Profesionale Menaxhim dhe Marketing i Turizmit (DP MMT) është të formojë një profil punonjësi profesional të aftë për të punuar në një gamë të gjerë pozicionesh menaxhimi dhe marketingu kryesisht në fushën e turizmit dhe mikpritjes, duke u përfshirë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në tregun e punës pa qenë nevoja e kualifikimeve të tjera.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Të mundësojë formimin e studentëve përgjatë kohës së realizimit të programit, dhe shndërrimin e tyre në punonjës

profesionistë në Menaxhim dhe Marketing i Turizmit.

Të përgatisë studentët për tregun e punës, për ngritjen e aftësive teorike e profesionale dhe për të qenë qytetarë aktivë. Të ndërthurë njohuritë teorike dhe ato praktike si mënyrë lehtësimi për studentët gjatë përshtatjes së tyre në tregun e punës. Të mundësojë zhvillimin e vlerave bashkëpunuese, komunikimit, lidhshmërisë, marrjes së përgjegjësisë për secilin student, që pas diplomimit t'i përcjellin ato në vendet e tyre të punës në sektorin e turizmit.

Të rrisë cilësinë e punonjësve dhe drejtuesve të ardhshëm të bizneseve dhe njësive turistike, përfshirë, por pa u kufizuar, në punonjës të informimit të klientëve, në hotele, bare, restorante dhe struktura të tjera akomoduese, shoqëruar turistësh, punonjës shërbimi në hotele, zyra dhe njësi të tjera në Shqipëri, duke justifikuar diplomën e tyre në cilësinë e menaxherit dhe asistentit.

NJOHURITË KRYESORE

Programi Diplomë Profesionale "Menaxhim dhe Marketing i Turizmit" përgatit punonjës me aftësi organizuese, menaxheriale, marketuese, komunikimi dhe të tjera për pozicione

menaxhimi në struktura dhe njësi të turizmit dhe mikpritjes. Kjo arrihet duke i pajisur studentët me njohuri për menaxhimin e shërbimit turistik, marketingun, kontabilitetin dhe zhvillimi i aftësive të komunikimit, të përdorimit të teknologjisë së informacionit për turizmin. Dijet dhe metodat e përcjelljes së tyre të studentët do të formojnë menaxher të aftë për drejtimin e aktiviteteve të përditshme, për mbajtjen e marrëdhënieve me klientët, për përmirësimin dhe zgjerimin e aktiviteteve duke u bazuar në trashëgiminë kulturore, gjeografike, historike dhe social ekonomike, faktorët mjedisorë të zonave të caktuara apo në nivel kombëtar. Marrja e njohurive për plotësimin e kërkesave të natyrës profesionale u mundëson të diplomuarve përfshirjen në grupe profesionale karakteristike për industrinë e turizmit, punësimin aktual dhe u jep bazën e nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të tyre në të ardhmen.

PRAKTIKA MËSIMORE

Studentëve që do të ndjekin programin e studimit DP "Menaxhim dhe Marketing i Turizmit" u ofrohet mundësia të zhvillojnë praktikën profesionale në institucione bashkëpunuese

me UMSH dhe të kombinuar me orë intensive në auditor. Studentët njihen me funksionimin e organizatave në kushte reale, duke zbatuar në praktikë elemente teorike të marra në lëndët e vecanta të specialitetit. Vend të veçantë zë praktika me sistemet informatike të menaxhimit të aktiviteteve në turizëm, që rrit mundësitë e studentëve për përshtatje me të shpejtë në organizatat ku punësohen. Gjatë praktikës studentët aftësohen edhe në përdorimin e teknologjisë ndihmëse në kërkimin e tregut të punës, përgatiten për prezantimet e para me tregun e punës nëpërmjet intervistave të simuluar, bërjes së një letre motivimi dhe një CV të formatit bashkëkohor, për t'u lehtësuar punësimin pas diplomimit.

REZULTATET E DIPLOMIMIT

Programi ndërthur njohuritë teorike me aplikimin praktik, të lidhura direkt me kërkesën dhe nevojat e tregut të punës. Në përfundim të programit studentët përfitojnë aftësi, shkathtësi dhe kompetenca për menaxhimin dhe marketingun e shërbimeve turistike me cilësi dhe korrektësi, nisur nga përvoja më e mirë e shkollave të turizmit,



nga praktika e punës në kompani dhe nga trendet e zhvillimit të profesioneve. Ata pajisen me Diplomë: Diplomë Profesionale "Menaxhim dhe Marketing i Turizmit".

MUNDËSITË E PUNESIMIT DHE KARRIERA PROFESIONALE

Programi i përshtatet trendit të zhvillimit ekonomik në Shqipëri, me orientimin drejt turizmit dhe përfundimit të kuadrit rregullator, fusha në të cilat ka kërkesa të vazhdueshme për personel të kualifikuar.

Të diplomuarit në DP "Menaxhim dhe Marketing i Turizmit" në përfundim të programit kanë të gjitha aftësitë për të kryer: Detyrat e menaxherit të përgjithshëm me të gjitha rolet dhe kompetencat që ky pozicion pune kërkon në

sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat janë mbizotëruese në turizmin shqiptar gjithëvjetor apo sezonal, malor apo detar, argëtues apo të natyrave të tjera, duke menaxhuar në menyrë gjithëpërfshirëse aktivitetin e njësisë, ose të drejtojnë ndarje funksionale brenda tyre.

Detyrat e menaxherit të nivelit të mesëm në bizneset apo strukturat e mëdha turistike dhe në organizata të tjera në shërbim të turizmit e mikpritjes, duke u angazhuar në një departament të caktuar. Detyrat e punonjësve të informimit të klienteve në resorte turistike, qendra rekreacioni, hotele, bare, restorante dhe struktura të tjera akomoduese, shoqërues turistësh, punonjës shërbimi në operatorë dhe agjenci turistike, si dhe njësi të tjera në shërbim të turizmit e mikpritjes.

PLANI MËSIMOR PROFILI "MENAXHIM DHE MARKETING I TURIZMIT"

VITI I PARË


Nr.	Lëndët	ECTS
1	RESURSET TURISTIKE TË SHQIPËRISË	6
2	SHKRIM DHE KOMUNIKIM	6
3	EKONOMIA E TURIZMIT	7
4	INFORMATIKË	7
5	GJUHË E HUAJ ANGLISHT	7
6	HYRJE NË MENAXHIM	7
7	HYRJE NË MARKETINGUN TURISTIK	7
8	ETIKA NË TURIZËM	7
9	LËNDË ME ZGJEDHJE BUSINESS ENGLISH BAZAT E FINANÇËS	6

VITI I DYTË:

Nr.	Lëndët	ECTS
1	BAZAT E SË DREJTËS	6
2	BAZAT E KONTABILITETIT NE TURIZEM	6
3	MENAXHIMI I BIZNESEVE TE UDHETIMEVE TURISTIKE 1	6
4	SISTEME INFORMATIKE TË SEKTORIT TË TURIZMIT	7
5	BAZAT E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE	7
6	SJELLJE KONSUMATORE	6
7	MENAXHIM AKOMODIMI NE TURIZEM	6
8	MENAXHIMI I BIZNESEVE TE UDHETIMEVE TURISTIKE 2	6
9	PRAKTIKA	4
10	PROVIM FORMIMI	6

Totali i planit mësimor: 120

Leksionet e hapura në auditor UMSH zhvillon aktivitete dhe leksione të hapura me pjesëmarrjen e specialistëve nga biznesi, institucionet publike dhe akademja, që sjellin në auditor risi dhe përvoja në fusha të gjera të ekspertizës. Leksionet e hapura ju krijojnë mundësi studentëve të përfitojnë njohuri praktike të profesionit dhe të integrohen më lehtësisht në tregun e punës.





FAKULTETI I


SHKENCAVE MJEKËSORE

MED

3 BACHELOR **1** MASTER



FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORË



Prof. Dr. *Mihal Tase*

Programi i studimit Bachelor në Infermieri e Përgjithshme

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor në Infermieri e Përgjithshme, është pjesë përbërëse e studimeve të ciklit të parë në strukturën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore në UMSH. Qëllimi i këtij programi është përgatitja e specialistëve të rinj, që i përshtaten pozicioneve të punës të lidhura me zhvillimin e kujdesit shëndetësor në fushën e infermieristikës, si një kusht i rëndësishëm në zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë sot dhe në dekadat që do të vijnë, duke krijuar gjeneratën e re të infermierëve me cilësi të lartë, ekspertizë gjithëpërfshirëse dhe etikë të lartë profesionale. Programi e realizon këtë objektiv duke ju dhënë studentëve në UMSH një edukim cilësor, të qëndrueshëm me anë të mësimdhënies aktive, kërkimit shkencor, si dhe partneriteteve me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare me një accent të theksuar në aspektin e praktik dhe realizimin e saj në institucione të specializuara brenda dhe jashtë vendit.

Programi i studimit Bachelor në Infermieri e Përgjithshme

mbështetet njëkohësisht në një bashkëpunim të gjerë me institucionet e shëndetit të natyrave dhe specialiteteve të ndryshme për të evidentuar dinamikat e tregut të punës dhe për të ndërtuar një platformë dijesh të përdorshme, në mënyrë që të diplomuarit të integrohen më shpejt në të.

QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor në Infermieri e Përgjithshme, ka si qëllim përgatitjen me përgjegjësi të profesionistëve të pajisur me standardet më të larta profesionale në kryerjen me cilësi dhe saktësi të shërbimit duke ju përshtatur sistemit shëndetësor dhe kujdesin shëndetësor gjithnjë e në ndryshim. Të diplomuarit duhet të jenë të përgatitur në ushtrimin e profesionit me metoda që nisin nga ato më tradicionalet, deri në ato më të avancuarat teknologjike dhe shkencore. Për më tepër, ata duhet të kenë aftësinë për t'i shërbyer shoqërisë me etikë dhe përkujdesje profesionale.

MISIONI I PROGRAMIT

Misioni i programit Bachelor në Infermieri e Përgjithshme, është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e teknikës së lartë në kujdesin shëndetësor duke zhvilluar kështu

kompetencat e nevojshme për tu përgatitur si specialistë në këtë fushë. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në studimin e lëndëve para klinike dhe ato pas klinike, infermieristikë, geriatrike, etj. Pjesë e misionit kryesor të këtij programi studimi është jo vetëm përgatitja e një kurrkule dhe e studentëve me njohuritë bazë aplikative në fushën e infermierisë, por edhe formimi i tyre si profesionistë me njohuri të plota në fushat e implementimeve të aparaturave bio-mjekësore dhe në përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre në sintoni të plotë me pacientin dhe mjekun specialist.

OBJEKTIVAT FORMUES:

Programi i studimit Bachelor në Infermieri e Përgjithshme ka për përcaktuar objektivat si më poshtë:

- Zotërimin e një grupi të integruar njohurishë bazë teorike në fushën infermierisë që lejojnë analizimin, vlerësimin, interpretimin, zbatimin dhe planifikimin në mënyrë kritike të aktivitetëve, që lidhen me kujdesin shëndetësor;
- Përvetësimin e njohurive teorike mbi protokollet, rregulloret dhe etiken e kujdesit shëndetësor;
- Përvetësimin e metodave që mundësojnë kryerjen e çdo funksioni me siguri dhe autonomi teknike dhe profesionale gjithnjë

në bashkëpunim me personelin tjetër të ngarkuar me shërbimet e tjera plotësuese;

- Zbatimin në mënyrë rigorozë të protokolleve të punës të përcaktuara nga drejtuesit dhe përgjegjësit;
- Verifikimin e përputhshmërisë së shërbimeve të ofruara me treguesit dhe standardet e paracaktuara në nivel strukture;
- Aftësimin me kapacitetet për të bërë propozime mbi kriteret e planifikimit dhe organizimit të punës brenda strukturës në të cilën veprohet;
- Kontrollin dhe verifikimin e funksioneve të duhura të pajisjeve të përdorura, duke siguruar mirëmbajtjen e zakonshme dhe eliminimin eventual të problematikave;
- Aftësinë për të lexuar, interpretuar dhe kuptuar udhëzimet, simbolet ilustruese të udhëzimeve dhe manualeve të përdorimit, si në gjuhën vendase ashtu edhe në gjuhë të huaj teknike;
- Përdorimin në mënyrë të përshtatshme të gjuhës së huaj për tu përfshirë në mjediset përkatëse të punës jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në atë evropian dhe më gjerë;
- Përvetësimin e përgatitjes globale që mundëson aksesin në formim të mëtejshëm të specializuar.

QËLLIMI I PROGRAMIT

Studenti i diplomuar në programin e studimit Bachelor Infermieri e Përgjithshme mund të ushtrrojë veprimtarinë e tij si punonjës ose profesionist i lirë në strukturat spitalore publike dhe private, të autorizuara nga legjislati në fuqi. Këto struktura përfshijnë:

- Strukturat shëndetësore;
- Spital
- Qendra shëndetësore
- Qendrat komunitare;
- Azil;
- Institucionet arsimore; çerdhe; kopshte; shkolla; universitete

PRAKTIKA PROFESIONALE:

UMSH kujdeset që zhvillimi i praktikave profesionale të studentëve, të jenë sa më efektive në aspektin e kompetencave dhe aftësive profesionale dhe nën kujdesin e tutoratit të përzgjedhur nga institucionet shëndetësore. Në bazë të partneritetit me qendra spitalore dhe universitare, jashtë vendit, studentëve të programit të studimit Bachelor Infermieri e Përgjithshme, u mundësohet kryerja e praktikës profesionale të paguar në vendet më të zhvilluara të BE-së si Gjermani, Itali, etj. si dhe mësimin e gjuhës dhe marrjen e licencës profesionale në këto vende.

LEKSIONET E HAPURA:

Si pjesë të strategjisë së Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, synohet të ofrohen si bashkëpunëtorë të jashtëm profesionistë dhe ekspertë nga tregu i punës, duke mundësuar që në auditor të gërshetohet shumë mirë teoria me praktikën. Përveç kësaj, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, duke shfrytëzuar ekspertizën personale të pedagogëve të vet, organizon në vazhdimësi një sërë aktivitetesh me specialistë/profesionistë të fushës së shëndetit dhe mjekësisë si dhe me anëtarë të bordit të tregut të punës me të cilët Fakulteti mban kontakte të ngushta. Këto aktivitete janë në formën e Webinareve, leksioneve të hapura, tavolinave të rumbullakta, takime të grupeve të interesit në fushën e mjekësisë, etj.

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	ANATOMI PATOLOGJIKE	2
2	FARMAKOLOGJI	3
3	NEUROLOGJI PSIKIATRI	7
3.1	NEUROLOGJI	3
3.2	PSIKIATRI	2
3.3	INFERMIERISTIKË E NEUROPSIKIATRISË	2
4	SËMUNDJET E BRENDESHME	12
4.1	SËMUNDJET E BRENDESHME	6
4.2	INFERMIERISTIKE E SEMUNDJEVE TE BRENDESHME	6
5	SËMUNDJET INFEKTIVE & DERMATOLOGJI	8.5
5.1	SËMUNDJET INFEKTIVE & DERMATOLOGJI	5
5.2	INFERMIERISTIKA E SËMUNDJEVE INFEKTIVE DHE DERMATOLOGJISË	3.5
6	SËMUNDJET PEDIATRIKE	12
6.1	PEDIATRI	6
6.2	INFERMIERISTIKË E PEDIATRISË	6
7	GERIATRI & INFERMIERISTIKË	3
8	NUTRICION	1.5
9	PRAKTIKA	11
	TOTAL Viti II	60

PLANI MËSIMOR: Bachelor Infermieri e Përgjithshme

VITI I PARË


Nr.	Lëndët	ECTS
1	SHËNDETI PUBLIK	5
1.1	SHËNDETI PUBLIK	2.5
1.2	ETIKË	1
1.3	LEGJISLACION	1.5
2	BIOSTATISTIKË DHE INFORMATIKË E MJEKËSISË	3
2.1	BIOSTATISTIKË	2
2.2	INFORMATIKË	1
3	PSIKOSOCIOLOGJI	4
3.1	PSIKOLOGJI	2
3.2	SOCIOLOGJI	2
4	SHKENCA E NATYRËS	8.5
4.1	BIOLOGJI	3
4.2	BIOKIMI	3
4.3	BIOFIZIKE	2.5
5	GJUHË TË HUAJA	7
5.1	LATINISHT	2
5.2	GJUHË E HUAJ I	2.5
5.3	GJUHË E HUAJ II	2.5
6	MORFOLOGJI HUMANE	9
6.1	ANATOMI & HISTOLOGJI	5
6.2	FIZIOLOGJI	4
7	MIKROBIOLOGJI E IMUNOLOGJI	8.5
7.1	MIKROBIOLOGJI E PËRGJITHSHME	3.5
7.2	MIKROBIOLOGJI APLIKATIVE	2.5
7.3	IMUNOLOGJI	2.5
8	BAZAT E INFERMIERISTIKËS DHE PRAKTIKË	7
9	PRAKTIKA	8
	TOTAL Viti I	60

VITI I TRETË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	KIRURGJI DHE INFERMIERISTIKË	11.5
1.1	KIRURGJI E PËRGJITHSHME	6.5
1.2	INFERMIERISTIKË E KIRURGJISË	5
2,1	TRAUMATOLOGJI ORTOPEDI	2.5
2.2	INFERMIERISTIKË TRAUMATOLOGJI-ORTOPEDI	2
3.1	KIRURGJI SPECIALE, OKULISTIKË, ORL	2.5
3.2	INFERMIERISTIKË SPECIALE	2
4.1	ANASTEZI REANIMACION	3
4.2	INFERMIERISTIKË	2
5.1	OBSTETRI GJINOKOLOGJI SHËNDETI RIPODHUES	5
5.2	INFERMIERISTIKË	5
6	SHËNDETI RIPODHUES	2
7	URGJENCAT MJEKËSORE DHE ONKOLOGJI	5
7.1	URGJENCA	3.5
7.2	ONKOLOGJI	1.5
8	LËNDË ME ZGJEDHJE	2
8.1	FIZIOTERAPI	
8.2	RADIOLOGJI	
9	PRAKTIKË	10.5
10	PROVIMI PËRFUNDIMTAR	5
	TOTAL VITI III	60.0

Totali i planit mësimor: 180

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORË



Programi i studimit në Bachelor në Fizioterapi

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi, është pjesë përbërëse e studimeve të ciklit të parë në strukturën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore në UMSH. Qëllimi i këtij programi është përgatitja e specialistëve të rinj, që i përshtaten pozicioneve të punës të lidhura me kryerjen me përgjegjësi, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me figura të tjera shëndetësore, ndërhyrje parandaluese, mjekuese dhe rehabilituese në fushën e aftësive motorike, funksioneve më të larta kortikale dhe funksioneve viscerale që rrjedhin nga ngjarje patologjike, etiologjitet, të lindura ose të fituara. Në një mjedis që ndryshon në mënyrë të vazhdueshme, ky program synon të përgatisë fizioterapistët e të ardhmes të cilët duhet të jenë të pranishëm jo vetëm me njohuritë e duhura teorike por edhe të kenë aftësinë t'i përshtaten ndryshimeve teknologjike dhe revolucionit që kanë sjellë ato në këtë degë specifike të mjekësisë. Programi e realizon këtë objektiv duke ju dhënë studentëve në UMSH një edukim cilësor, të

qëndrueshëm me anë të mësimdhënies aktive, kërkimit shkencor, si dhe partneriteteve me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare me një aksent të theksuar në aspektin e praktikës dhe realizimin e saj në institucione të specializuara brenda dhe jashtë vendit. Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi mbështetet njëkohësisht në një bashkëpunim të gjerë me institucionet e specializuara për të evidentuar dinamikën e tregut të punës dhe për të ndërthtur një platformë dijesh të përdorshme, në mënyrë që të diplomuarit të integrohen më shpejt në të.

QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi, ka si qëllim përgatitjen me përgjegjësi të profesionistëve të pajisur me standardet më të larta profesionale në kryerjen me cilësi dhe saktësi të shërbimit duke ju përshtatur sistemit shëndetësor dhe kujdesin shëndetësor gjithnjë e në ndryshim. Të diplomuarit duhet të jenë të përgatitur në ushtrimin e profesionit me metoda që nisin nga ato më tradicionalet, deri në ato më të avancuarat teknologjike dhe shkencore. Për më tepër, ata duhet të kenë aftësinë për t'i shërbyer shoqërisë me etikë dhe përkujdesje profesionale.

MISIONI I PROGRAMIT

Misioni i programit Bachelor në Fizioterapi Misioni është përgatitja e profesionistëve në fizioterapi, me njohuri e kompetenca të nevojshme fizioterapeutike profesionale teorike dhe praktike, të aftë të punojnë në sektorin e reabilitimit, në përputhje me normat e paracaktuara nga Komuniteti Europian, është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e teknikës së lartë në kujdesin shëndetësor duke zhvilluar kështu kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në studimin e lëndëve që korrespondojnë me metodologjinë e reabilitimit të zbatuar në lidhje me objektivat e rimëkëmbjes funksionale si dhe kryerjen e veprimtarisë studimore, mësimdhënies dhe konsulences profesionale në shërbimet shëndetësore dhe në ato ku kërkohen aftësitë e tyre profesionale, duke ushtruar veprimtarinë e tyre profesionale në institucionet shëndetësore publike ose private, si punonjës ose profesionistë të lirë. Pjesë e misionit kryesor të këtij programi studimi është jo vetëm përgatitja e një kurrikule dhe e studentëve me njohuritë bazë aplikative në fushën e fizioterapisë, por edhe formimi i

tyre si profesionistë me njohuri të plotë në fushat e implementimeve të aparaturave mjekësore dhe në përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre në sintoni të plotë me pacientin dhe mjekun specialist.

OBJEKTIVAT FORMUES:

Objektivat formues:

Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi ka për përcaktuar objektivat si më poshtë:

- Marrja e njohurive teorike dhe praktike në shkencat themelore biomjekësore, shkencat humane dhe sociale dhe ato profesionale klinike të fizioterapisë, për përvetësimin e dijeve profesionale fizioterapeutike;
- Fitimi i aftësive të duhura për kryerjen e aktiviteteve në mënyrë autonome nëpërmjet ndërhyrjeve për parandalim, kurim dhe reabilitim të zonave motore, funksioneve kortikale superiore dhe viscerale me pasoja nga patologji të ndryshme të lindura dhe të fituara;
- Të njohë nocionet e nevojshme për të kuptuar dukuritë biologjike që lidhen me organizimin dhe mekanizmat e funksionimit të organizmave më të lartë;
- Të njohë nocionet e nevojshme për të kuptuar anatominë dhe fiziologjinë e njeriut, veçanërisht për fiziologjinë e lëvizjes dhe proceset njohëse;
- Të njohë bazat fiziologjike të zhvillimit psikik dhe motorik;

- Të kuptojë bazat e patofiziologjisë në situata të ndryshme klinike;
- Të njohë bazat shkencore dhe kulturore të metodologjisë së përgjithshme të rehabilitimit dhe në sektorë të ndryshëm të specializuar;
- Të dijë të identifikojnë dhe vlerësojnë manifestimet që lidhen me rrjedhën e sëmundjeve kryesore, me trajtimin, zakonet e jetesës, reagimet ndaj sëmundjes, ndërhyrjet në spital dhe ndihmës;
- Të dinë se si të identifikojnë nevojat fizike, psikologjike dhe sociale në zonat e ndjeshme ndaj rimëkëmbjes funksionale të individëve të moshave, kulturave dhe kushteve të ndryshme shëndetësore dhe të komuniteteve në fusha të ndryshme sociale;
- Identifikimin e metodave dhe kohërave për aplikimin e teknikave më të përshtatshme të rehabilitimit mbi bazën e të dhënave shkencore;
- Përdorimin, sipas recetave dhe indikacioneve të mjekut, të terapive fizike, manuale, kinesiterapike, psikomotore dhe profesionale, duke marrë parasysh indikacionet dhe kundërshtimet përkatëse;
- Propozimi i përdorimit të mundshëm të ortozave, protezave dhe mjeteve ndihmëse;
- Të dijë të njohin reagimet kryesore të personit ndaj sëmundjes, vuajtjes, paaftësisë dhe shtrimit në spital, duke respektuar dallimet e sjelljes që lidhen me kulturën e origjinës;
- Të dijë të veprojë në përputhje me rregulloret ligjore dhe parimet disiplinore, etike dhe deontologjike të profesionit të fizioterapistit.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT:

Studenti i diplomuar në programin e studimit Bachelor Fizioterapi mund të ushtrojë veprimtarinë e tij si punonjës ose i vetëpunësuar në cilat mund të identifikohen në:

- Spitale;
- Njësi rehabilitimi të përgjithshme, publike ose private;
- Njësi rehabilitimi të specializuara, publike ose private;
- Rezenca të mirëqenies sociale për të moshuarit ose invalidët;
- Shoqata apo grupet sportive;
- Veprimtari autonome, në një strukturë të dedikuar ose në shtëpi.

PRAKTIKA PROFESIONALE:

UMSH kujdeset që zhvillimi i praktikave profesionale të studentëve, të jenë sa më efektive në aspektin e kompetencave dhe aftësive profesionale dhe nën kujdesin e tutoratit të përgjigjedhur nga institucionet shëndetësore. Në bazë të partneritetit me qendra spitalore dhe rehabilituese të përgjithshme apo të specializuara, jashtë vendit, studentëve të programit të studimit Bachelor Fizioterapi, u mundësohet kryerja e praktikës profesionale të paguar në vendet më të zhvilluara të BE-së si Gjermani, Itali, etj. si dhe mësimin e gjuhës dhe marrjen e licencës profesionale në këto vende.

LEKSIONET E HAPURA:

Si pjesë të strategjisë së Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, synohet të ofrohen si bashkëpunëtorë të jashtëm profesionistë dhe ekspertë nga tregu i punës, duke mundësuar që në auditor të gërshetohet shumë mirë teoria me praktikën. Përveç kësaj, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, duke shfrytëzuar ekspertizën personale të pedagogëve të vet, organizon në vazhdimësi një sërë aktiviteteve me specialistë/profesionistë të fushës së shëndetit dhe mjekësisë si dhe me anëtarë të bordit të tregut të punës me të cilët Fakulteti mban kontakte të ngushta. Këto aktivitete janë në formën e webinareve, leksioneve të hapura, tavolinave të rumbullakta, takime të grupeve të interes në fushën e mjekësisë, etj.



VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SHËNDETI PUBLIK	5
1.1	SHËNDETI PUBLIK	2.5
1.2	ETIKË	1
1.3	LEGJISLACION	1.5
2	BIOSTATISTIKË DHE INFORMATIKË E MJEKËSISË	3
2.1	BIOSTATISTIKË	2
2.2	INFORMATIKË	1
3	PSIKOSOCIOLOGJI	4
3.1	PSIKOLOGJI	2
3.2	SOCIOLOGJI	2
4	SHKENCA E NATYRËS	8.5
4.1	BIOLOGJI	3
4.2	BIOKIMI	3
4.3	BIOFIZIKE	2.5
5	GJUHË TË HUAJA	7
5.1	LATINISHT	2
5.2	GJUHË E HUAJ I	2.5
5.3	GJUHË E HUAJ II	2.5
6	MORFOLOGJI HUMANE	9
6.1	ANATOMI & HISTOLOGJI	5
6.2	FIZIOLOGJI	4
7	KINEZIOLOGJI DHE BIOMEKANIKË	8.5
7.1	KINEZIOLOGJI	3.5
7.2	FIZIKE DHE BIOMEKANIKE	2.5
7.3	METODAT BAZË TË VLERËSIMIT NË FIZIOTERAPI	2.5
8	BAZAT E FIZIOTERAPISË	7
9	PRAKTIKA	8
	TOTAL VITI I	60

PLANI MËSIMOR: Bachelor Fizioterapi

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	MORFOLOGJI DHE FARMAKOLOGJI	7
1.1	ANATOMI PATOLOGJIKE	2
1.2	FARMAKOLOGJI	3.5
1.3	ANATOMI IMAZHERIKE	1.5
2	SËMUNDJE TË BRENDSHME	12
2.1	SËMUNDJE TË BRENDSHME	6
2.2	FIZIOTERAPI NË ORTOPEDI DHE TRAUMATOLOGJI	6
3	ORTOPEDI & TRAUMATOLOGJI	8
3.1	ORTOPEDI & TRAUMATOLOGJI	5
3.2	FIZIOTERAPI NË ORTOPEDI DHE TRAUMATOLOGJI	3
4	REUMATOLOGJI	7
4.1	REUMATOLOGJI	4
4.2	FIZIOTERAPI NË REUMATOLOGJI	3
5	SËMUNDJET PEDIATRIKE	12
5.1	PEDIATRI	6
5.2	FIZIOTERAPI NË PEDIATRI	6
6	LËNDË ME ZGJEDHJE	4
6.1	ERGOTERAPI	
6.2	REHABILITIM NË KOMUNITET	
7	PRAKTIKA	10
8	TOTAL Viti II	60


VITI I TRETË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	NEUROLOGJI	4
1.1	NEUROLOGJI	2.5
1.2	FIZIOTERAPI NË NEUROLOGJI	1.5
2	TEKNIKA TRAJTIMI NË FIZIOTERAPI	6
3	MODALITETE TERMO-ELEKTRO-HIDROTERAPI	6
4	MJEKËSIA SPORTIVE E ORTOPROSTETIKA	7
4.1	MJEKËSI SPORTIVE	4
4.2	ORTOPROSTETIKË	3
5	TEKNIKAT E REHABILITIMIT NË SPECIALITETE	7
5.1	REHABILITIM NË DJEGIE PLASTIKE	3.5
5.2	REHABILITIMI URO-GJINEKOLOGJIK E OBSETRIKAL	3.5
6	KIRURGJI E REHABILITIMIT	7
6.1	KIRURGJI E ONKOLOGJI	5
6.2	REHABILITIM NË KIRURGJI E ONKOLOGJI	2
7	LËNDË ME ZGJEDHJE	4
7.1	MENAXHIM NË FIZIOTERAPI	
7.2	REHABILITIM NË FAMILJE	
8	LËNDË ME ZGJEDHJE	4
8.1	MASAZH SPORTIV	
8.2	FIZIOTERAPI NË ORL	
9	PRAKTIKË	10
10	PROVIMI PËRFUNDIMTAR	5
	TOTAL VITI III	60.0

Totali i planit mësimor: 180



FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORË



Programi i studimit Bachelor në TEKNIK LABORATORI

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor: Teknik Laboratori, është pjesë përbërëse e studimeve të ciklit të parë në strukturën akademike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore në UMSH. Qëllimi i këtij programi është përgatitja e specialistëve të rinj, që i përshtaten pozicioneve të punës të lidhura me zhvillimin e kujdesit shëndetësor në fushën e bioteknologjisë mjekësore, si një kusht i rëndësishëm në zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë sot dhe në dekadat që do të vijnë, duke krijuar gjeneratën e re të teknikeve laborantë me cilësi të lartë, ekspertizë gjithëpërfshirëse dhe etikë të lartë profesionale. Programi e realizon këtë objektiv duke ju dhënë studentëve në UMSH një edukim cilësor, të qëndrueshëm me anë të mësimdhënies aktive, kërkimit shkencor, si dhe partneriteteve me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare me një accent të theksuar në aspektin e praktik dhe realizimin e saj në institucione të specializuara brenda dhe jashtë vendit.

Programi i studimit Bachelor: Teknik Laboratori mbështetet njëkohësisht në një bashkëpunim të gjerë me institucionet e

shëndetit të natyrave dhe specialiteteve të ndryshme për të evidencuar dinamikat e tregut të punës dhe për të ndërtuar një platformë dijesh të përdorshme, në mënyrë që të diplomuarit të integrohen më shpejt në të.

QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor: Teknik Laboratori ka si qëllim përgatitjen me përgjegjësi të profesionistëve të pajisur me standardet më të larta profesionale në kryerjen me cilësi dhe saktësi të shërbimit duke ju përshtatur zhvillimeve të sistemit shëndetësor gjithnjë e në ndryshim dhe në mënyrë të veçantë revolucionit teknologjik në fushën e mjekësisë në dekadat e fundit. Të diplomuarit duhet të jenë të përgatitur në ushtrimin e profesionit me metodika që nisin nga ato më tradicionalet, deri në ato më të avancuarat teknologjike dhe shkencore. Për më tepër, ata duhet të kenë aftësinë për t'i shërbyer shoqërisë me etikë dhe përkujdesje profesionale.

MISIONI I PROGRAMIT

Misioni i programit Bachelor: Teknik Laboratori, është të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme bazë në fushën e teknikës së lartë në laboratorët mjekësorë duke zhvilluar kështu

kompetencat e nevojshme për t'u përgatitur si specialistë në këtë fushë. Për realizimin e këtij misioni, programi parashikon thellime në fusha të tilla, si mikrobiologjia, biokimia, histopatologjia, imunologjia, diagnostika molekulare, teknika laboratorike etj.

Pjesë e misionit kryesor të këtij programi studimi është jo vetëm përgatitja e një kurrikule dhe e studentëve me njohuritë bazë aplikative në fushën e Laborantit Mjekësor, por edhe formimi i tyre si profesionistë me njohuri të plota në fushat e implementimeve të aparaturave bio-mjekësore dhe në përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre në sintoni të plotë me pacientin dhe mjekun specialist.

OBJEKTIVAT FORMUES:

Hapja e programit të studimit Bachelor: Teknik Laboratori, ka për përcaktuar objektivat si më poshtë:

- Zotërimin e një grupi të integruar njohurishë bazë teorike në fushën e shkencave dhe teknikeve laboratorike që lejojnë analizimin, vlerësimin, interpretimin, zbatimin dhe planifikimin në mënyrë kritike të aktiviteteve laboratorike biomjekësore dhe bioteknologjike, të lidhura me biokimikën, mikrobiologjinë dhe virologjinë, imunologjinë, patologjitë klinike,

hematologjinë, citologjinë dhe histopatologjinë;

- Përvetësimin e njohurive teorike mbi protokollet e mbrojtjes nga rrezatimi dhe rregulloret përkatëse;

- Përvetësimin e metodave që mundësojnë kryerjen e çdo funksioni me siguri dhe autonomi teknike dhe profesionale gjithnjë në bashkëpunim me personelin tjetër të ngarkuar me shërbimet e tjera plotësuese;

- Zbatimin në mënyrë rigorozë të protokolleve të punës të përcaktuara nga drejtuesit dhe përgjegjësit;

- Verifikimin e përputhshmërisë së shërbimeve të ofruara me treguesit dhe standardet e paracaktuara në nivel strukture;

- Aftësimin me kapacitetet për të bërë propozime mbi kriteret e planifikimit dhe organizimit të punës brenda strukturës në të cilën veprohet;

- Kontrollin dhe verifikimin e funksioneve të duhura të pajisjeve të përdorura, duke siguruar mirëmbajtjen e zakonshme dhe eliminimin eventual të problematikave;

- Aftësinë për të lexuar, interpretuar dhe kuptuar udhëzimet, simbolet ilustruese të udhëzimeve dhe manualeve të përdorimit, si në gjuhën vendase ashtu edhe në gjuhë të huaj teknike;

- Përdorimin në mënyrë të

përshtatshme të gjuhës angleze për t'u përfshirë në mjediset përkatëse të punës jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në atë evropian dhe më gjerë;

- Përvetësimin e përgatitjes globale që mundëson aksesin në formim të mëtejshëm të specializuar.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT:

Studenti i diplomuar në programin e studimit Bachelor Teknik Laboratorit ushtron veprimtarinë e tij si punonjës ose profesionist i lirë në strukturat laboratorike publike dhe private, të autorizuara nga legjislacioni në fuqi. Këto struktura përfshijnë:

- Universitetet dhe institucionet kërkimore publike dhe private;
- Strukturat shëndetësore;
- Industritë bioteknologjike, kimike-farmaceutike, agro-ushqimore, agro-kimike;
- Laboratorët publikë dhe privatë të analizave dhe kontrollit të cilësisë;
- Institutet zooprofilaktike;
- Qendrat e riprodhimit të asistuar;
- Agjencitë e komunikimit dhe përhapjes së rezultateve shkencore.

PRAKTIKA PROFESIONALE:

UMSH kujdeset që zhvillimi i praktikave profesionale të studentëve, të jenë sa më efektive në aspektin e kompetencave dhe aftësive profesionale dhe nën kujdesin e tutoratit të përzgjedhur nga institucionet shëndetësore. Në bazë të partneritetit me qendra institute kërkimore dhe qendra spitalore/universitare, jashtë vendit, studentëve të programit të studimit Bachelor Teknik Laboratori, u mundësohet kryerja e praktikës profesionale të paguar në vendet më të zhvilluara të BE-së si Gjermani, Itali, etj. si dhe mësimin e gjuhës dhe marrjen e liçencës profesionale në këto vende.

LEKSIONET E HAPURA:

Si pjesë të strategjisë së Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, synohet të ofrohen si bashkëpunëtorë të jashtëm profesionistë dhe ekspertë nga tregu i punës, duke mundësuar që në auditor të gërshetohet shumë mirë teoria me praktikën. Përveç kësaj, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, duke shfrytëzuar ekspertizën personale të pedagogëve të vet, organizon në vazhdimësi një sërë aktivitetesh me specialistë/profesionistë të fushës së shëndetit dhe mjekësisë si dhe me anëtarë të bordit të tregut të punës me të cilët Fakulteti mban kontakte të ngushta. Këto aktivitete janë në formën e webinarëve, leksioneve të hapura, tavolinave të rrumbullakta, takime të grupeve të interesit në fushën e mjekësisë, etj.

PLANI MËSIMOR: Bachelor Teknik Laboratori

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SHËNDETI PUBLIK	5
1.1	SHËNDETI PUBLIK	2.5
1.2	ETIKË	1
1.3	LEGJISLACION	1.5
2	BIOSTATISTIKË DHE INFORMATIKË E MJEKËSISË	3
2.1	BIOSTATISTIKË	2
2.2	INFORMATIKË	1
3	PSIKOSOCIOLOGJI	4
3.1	PSIKOLOGJI	2
3.2	SOCIOLOGJI	2
4	SHKENCA E NATYRËS	8.5
4.1	BIOLOGJI	3
4.2	BIOKIMI	3
4.3	BIOFIZIKE	2.5
5	GJUHË TË HUAJA	7
5.1	LATINISHT	2
5.2	GJUHË E HUAJ I	2.5
5.3	GJUHË E HUAJ II	2.5
6	Morfologji humane	9
6.1	ANATOMI & HISTOLOGJI	5
6.2	FIZIOLOGJI	4
7	MIKROBIOLOGJI E IMUNOLOGJI	8.5
7.1	MIKROBIOLOGJI E PËRGJITHSHME	3.5
7.2	MIKROBIOLOGJI APLIKATIVE	2.5
7.3	IMUNOLOGJI	2.5
8	KIMI DHE FIZIKË	7
8.1	KIMI INORGANIKE	2.5
8.2	KIMI ORGANIKE	2.5
8.3	FIZIKË	2
8	PRAKTIKA	8
	TOTAL Viti I	60



VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	ANATOMI PATOLOGJIKE	4
1.1	MIKROBIOLOGJI SPECIALE	2.5
2	TEKNIKAT HISTO-PATOLOGJIKE	6
3	SËMUNDJET E BRENDSHME DHE URGJENCA	6
4	PEDIATRI	7
4.1	HEMATOLOGJI DHE HEMOSTAZË	4
5	IMUNOLOGJI DIAGNOSTIKË	7
5.1	PARIMET BAZË LABORATORIKE	3.5
6	LËNDË ME ZGJEDHJE	7
6.1	ORGANIZIM DHE MENAXHIM LABORATORI	5
6.2	TEKNIKAT E AUTOMATIZIMIT LABORATORIK	2
7	SHKENCA BIOMJËKSORE	4
7.1	BIOKIMI KLINIKE	
7.2	MARKUESIT TUMORALË	
8	PRAKTIKA	4
TOTAL Viti II		60.0

VITI I TRETË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	DIAGNOSTIKA MIKROBIOLOGJIKE DHE MOLEKULARE	
1.1	DIAGNOSTIKË MIKROBIOLOGJIKE	5
1.2	DIAGNOSTIKË MOLEKULARE	5
2	LËNGJET BIOLOGJIKE	
2.1	EKZAMINIMI I URINËS	3
2.2	EKZAMINIMI I LËNGJEVE BIOLOGJIKE	4
3	SËMUNDJET HEMATOLOGJIKE	
3.1	HEMATOLOGJI LABORATORIKE	8
3.2	IMUNOHEMATOLOGJI	2
3.3	IMUNOPATOLOGJI	2
3.4	SËMUNDJET E GJAKUT	5
4	ANALIZA E URGJENCËS	3
5	BIOKIMI E APLIKUAR	5
6	LËNDË ME ZGJEDHJE	3
6.1	NUTRICION	
6.2	SIGURIA NË PUNE	
7	PRAKTIKË	10
8	PROVIMI PËRFUNDIMTAR	5
TOTAL Viti III		60

Totali i planit mësimor: 180







FAKULTETI I
DREJTËSISË
DHE

SHKENCAVE HUMANE

LAW &
HUMAN SCIENCES

7 BACHELOR 14 MASTER



FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE



Ksenofon Krisafi

Prof.Dr.

Program i integruar në DREJTËSI (5-vjeçar)

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i Studimit të integruar në Drejtësi (5-vjeçar) është pjesë e kurrikulës së Fakultetit të Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Duke iu referuar dispozitave ligjore dhe akteve të brendshme të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë u bë një riorganizim i programeve të mëparshme të studimeve në Drejtësi. Risi e këtij programi studimi, i cili shtrihet në 5 vite akademike, është ndërthurja e kurrikulave të programeve të mëparshme Bachelor dhe Master i Shkencave në një program të vetëm studimi të integruar. Në fund të studimeve i diplomuari merr gradën shkencore "Master i Shkencave". Ky program studimi është projektuar si një tërësi integrale vlerash akademike dhe shkencore dhe është fryt i akumulimit progresiv të përvojave më të mira, të konsoliduara tashmë në fushën akademike në nivel kombëtar, rajonal e më gjerë. Këto vlera do të shërbejnë për të zhvilluar në vazhdimësi identitetin akademiko-mësimor dhe didaktik për realizimin e këtij programi, si pjesë integrale e aktivitetit dhe strategjisë që realizon institucioni ynë.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Ofrimi i një formimi juridik të thelluar e të gjerë të një karakteri si sistematik ashtu dhe metodologjik në fushën e të drejtës dhe institucioneve juridike, duke përfshirë edhe disa fusha mbështetëse të saj, si dhe duke patur parasysh si dimensionin kombëtar dhe ndërkombëtar të tyre. Krijimi i një profili kulturor dhe profesional të studentit në përfundim të programit të studimit. Të formojë specialistë në fushat e së drejtës, si ajo e së drejtës publike, e së drejtës private, si dhe të së drejtës penale, të para këto në këndvështrimin krahasues e të praktikës gjyqësore. Aftësimi i kapacitetit të të kuptuarit në lidhje me arsyetimin juridik që duhet të përdorë në referim të problematikave të veçanta të secilës prej fushave dhe vënia në zbatim praktik të këtyre njohurive. Aftësimi i studentëve për t'iu përgjigjur kërkesave të reja të kohës, veçanërisht në përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian. Mundësimi i studentëve në përvetësimin e kulturës ligjore bazë, si dhe pajisjen me instrumentet themelore të nevojshme për të përditësuar aftësitë e tyre. Kjo do të përmbushet përmes thellimit të

njohurive, përfshirë ato historike, të cilat lejojnë vlerësimin e instituteve të së drejtës pozitive, duke mbajtur parasysh evoluimin e tyre. Organizimi i aktiviteteve plotësuese ekstrakurrikulare do të zhvillojë më tej aftësitë e veçanta dhe kapacitetet interpretuese të studentëve.

NJOHURITË KRYESORE

Përfundimi i njohurive bazë të së drejtës pozitive, si dhe thellimi i studimeve në fusha të veçanta të së drejtës.

Zhvillimet e fundit në legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar (kryesisht të BE- së) si në të drejtën publike, ashtu edhe në atë private. Ndryshimet e fundit në lidhje me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore të reformës në drejtësi ku përfshihen institute të rëndësishme të së drejtës publike Studimi i rasteve praktike në fushën e shkencave të së drejtës. Gërshetimi i dijeve teorike me praktikën gjyqësore sillet në auditor nëpërmjet pedagogëve tanë juristë.

PRAKTIKAT PROFESIONALE

Studentët që do të ndjekin studimet për Master të Shkencave Drejtësi në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë do të kenë mundësi të kryejnë praktikën profesionale pranë: Kuvendit të RSH, Dhomës Kombëtare të

Ndërmjetësve, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, institucioneve publike dhe jopublike, zyrave ligjore, bankave të nivelit të dytë, zyrave përbarimore, shoqërive tregtare, OJF-ve, Klinikës Ligjore "Mesdhetari", etj. Këto mundësi ofrohen në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që universiteti ynë ka me institucionet dhe njësitë e sipërpërmendura. Mundësia e kryerjes së praktikës, njohuritë që do të marrin dhe puna individuale e studentëve do të jenë elementët përbërës të temës së diplomës si dhe një mundësi punësimi pranë tyre në të ardhmen.

REZULTATET E DIPLOMIT

Emërtimi i Diplomës: "Master i Shkencave në Drejtësi. Studentët, në përfundim të këtij cikli studimi 5 vjeçar, me 300 kredite (ECTS) do të mund të krijojnë hapësira të plota për punësimin dhe integrimin e tyre në tregun e punës. Njohuritë e përfituara gjatë këtyre studimeve mundësojnë krijimin e një profili të plotë si jurist, duke pasur dijen e nevojshme për të drejtën. Ky program studimi është hartuar në përputhje të plotë me ligjin "Për asimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH" dhe aktet nënligjore të dala në dhe për zbatim të tij.



PLANI MËSIMOR PROFILI DREJTËSI

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	E DREJTE ROMAKE	8
2	E DREJTE PUBLIKE	12
3	HISTORI E INSTITUCIONEVE, SHTETIT DHE TË DREJTËS	12
	3.1 Histori e institucioneve	6
	3.2 Histori e Shtetit dhe së drejtës	6
4	GJUHË E HUAJ JURIDIKE	6
5	FILOZOFI DHE SOCIOLOGJI E SË DREJTËS	8
	5.1 Filozofi e se Drejtes	4
	5.2 Sociologji e se Drejtes	4
6	HYRJE NË EKONOMI	6
7	INFORMATIKË	8

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	METODA E KËRKIMIT SHKENCOR	4
2	E DREJTË CIVILE (PRONËSI DHE TRASHËGIMI)	12
	2.1 E drejtë civile (Pjesa e Përgjithshme)	6
	2.2 Pronësi dhe trashëgimi	6
3	E DREJTA PENALE (P.JESA E PËRGJITHSHME)	12
	E DREJTË KUSHTETUESE DHE E KRAHASUAR	12
	4.1 E drejtë kushtetuese	6
4	4.2 E drejtë kushtetuese e krahasuar	6
	E DREJTË ADMINISTRATIVE	12
	DHE PROCEDURË ADMINISTRATIVE	6
5	5.1 E drejtë administrative	6
	5.2 Procedurë administrative	6
6	E DREJTË FAMILJARE	4
7	LËNDË ME ZGJEDHJE	4
	E drejtë administrative e BE-së	4
	E drejtë migracioni E drejtë familjare europiane	4

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Përfundimi me sukses i këtij programi studimi u mundëson studentëve një karrierë të sigurtë si juristë, përmbarues, avokatë, apo dhe konkurimin pranë Shkollës së Magjistraturës për t'u bërë gjyqtarë ose prokurorë.

Gjithashtu përfundimi i këtij cikli studimi mundëson hapjen e derve për të vijuar më tej studimet kërkimore të avancuara siç janë ato të Doktoratës, duke rritur më tej mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre akademike ose profesionale.

VITI I TRETË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	E DREJTA E DETYRIMEVE	12
2	E DREJTË PENALE(P.JESA E POSACME)	12
3	E DREJTË NDËRKOMBËTARE PUBLIKE	12
4	E DREJTË E PUNËS DHE E SIGURIMEVE SHOQËRORE	8
	4.1 E drejta e punës 4.2 E drejta e sigurimeve shoqërore	4
5	E DREJTA FINANCIARE DHE BANKARE	6
6	LËNDË ME ZGJEDHJE	4
	E drejta e mediave E drejta sportive E drejtë e falimentimit	4
	E DREJTA TREGTARE	6

VITI I KATËRT

Nr.	Lëndët	ECTS
1	PROCEDURË PENALE	12
2	PROCEDURË CIVILE	12
3	KRIMINALISTIKË	6
4	ZGJIDHJE ALTERNATIVE E MOSMARRËVESHJEVE ME NDËRMJETËSIM	6
5	E DREJTË NDËRKOMBËTARE PRIVATE	6
6	KRIMINALOGJI-PENALOGJI	8
7	DREJTËSIA PENALE PËR TË MITUR	6
8	LËNDË ME ZGJEDHJE	4
	E drejta e profesioneve të lira E drejta e konkurrencës dhe tregu i përbashkët european Negociatat, arbitrazhi dhe Gjykatat ndërkombëtare	4

VITI I PESTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	MJEKSI DHE PSIKIATRI LIGJORE	4
2	E DREJTA PENALE NDËRKOMBËTARE DHE EUROPIANE	12
	2.1 E drejtë penale ndërkombëtare 2.2 E drejtë penale europiane	6
3	TEKNIKAT LEGJISLATIVE	4
4	LËNDË ME ZGJEDHJE	4
	PROCEDURË CIVILE E BE-SË E DREJTA AGRARE E DREJTA E KONSUMATORIT	4
5	E DREJTA EUROPIANE	12
	5.1 E drejtë Publike europiane 5.2 E drejtë private europiane	6
6	PRAKTIKË/KLINIKË E LIGJIT	12
7	DIPLOMË/PROVIM PËRFUNDIMTAR	12

Totali i planit mësimor: 300 ECTS

LEKSIONET E HAPURA

Në çdo semestër gjatë gjithë ciklit të studimeve të integruara në Drejtësi pranë Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë studentët kanë mundësi të jenë pjesë e leksioneve të hapura nga profesionistët më të mirë të fushës, juristë, gjyqtarë,

prokurorë, avokatë të njohur, drejtues apo anëtar të institucioneve të VETTING- ut, profesorë të huaj dhe shqiptarë. Këto leksione u krijojnë mundësinë studentëve të përfitojnë nga përvojat e profesionistëve të fushës.

FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE



Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare”

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit Bachelor në "Marrëdhënie dhe Institucionet Ndërkombëtare" filloi të ofrohet për herë të parë në UMSH në vitin akademik 2009-2010. Programi ka qenë në vëmendje të punës akademike dhe shkencore të departamentit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Fakultetin e Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për të ofruar vazhdimisht elementë të përmirësuar në të dhe është me kurrikulat bashkëkohore nga universitete të njohura në Europë dhe në botë. Programi i Bachelor në Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare është hartuar në mënyrë të tillë që t'i përgjigjet nevojave të vendit për një brez të diplomuarish të cilët do të kontribuojnë në përmbushjen e proceseve integruese si edhe aspekteve të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian, hyrjen dhe konsolidimin e pozicionit të Shqipërisë në NATO dhe në përgjithësi në ridimensionimin e rolit në rajon dhe në marrëdhëniet bilaterale.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Të pajisë studentët me aparatën e duhur teorik dhe konceptual për të njohur, analizuar dhe krahasuar zhvillimet ndërkombëtare në nivel rajonal dhe global.

Të aftësojë studentët në dhënien e alternativave të ndryshme për të zgjidhur situata konfliktuale në arenën ndërkombëtare. Të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për organizimin dhe funksionimin e organizatave ndërkombëtare rajonale dhe globale. Të pajisë studentët me njohuritë themelore mbi teoritë e integritimit duke u fokusuar te integritimi evropian.

Të pajisë studentët me njohuritë themelore mbi krijimin, organizimin, funksionimin dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian. Të pajisë studentët me aparatën e duhur teorik për formulimin dhe zbatimin e politikës së jashtme në funksion të shërbimit të interesit shtetëror. Të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për të analizuar zhvillimet ndërkombëtare nga këndvështrimi i gjeopolitikës dhe i rëndësisë së burimeve energjitike.

NJOHURITË KRYESORE:

Sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program studimi dhe

aftësitë e kompetencat që do të zotërojnë studentët pas përfundimit të tij, pra formimi i plotë dhe ndërshkencor i përfutur gjatë nivelit Bachelor, do t'ju krijojnë atyre mundësinë edhe për ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimet të studimeve të Masterit SHkencor, ose të studimeve të një Masteri profesional, jo vetëm në fusha shkencore të përafërta me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacinë si Studime Evropiane, Studime Ballkanike apo Mesdhetare, Studime Sigurie dhe Strategjie, por edhe në Studime Ekonomike Ndërkombëtare, Marketing dhe Biznes Ndërkombëtar, Gazetari, Histori dhe Shkenca politike.

REZULTATET E DIPLOMIT

Bachelor në "Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare" Studentët, në përfundim të këtij cikli studimi 3 vjeçar do të mund të krijojnë hapësira të plota për punësimin dhe integrimin e tyre në tregun e punës. Programi i studimit Bachelor në Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare është një program që reflekton ligjin e Arsimit të lartë, strategjinë kombëtare për zhvillim dhe Integrim, nevojat për tregun e punës për specialistë të

Marrëdhënieve Ndërkombëtare, por jo vetëm, ai është një program konkurrent me tregun ndërkombëtar të punësimit të specialistëve të kësaj fushe.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Pas përfundimit të këtij programi studimi, në sajë të njohurive të marra, studenti aftësohet për mundësinë e punësimit në sektorin publik dhe në atë privat, si punonjës dhe specialist të Shërbimit të jashtëm të RSH, administratës shtetërore në nivel lokal dhe qendror, organizata të ndryshme ndërkombëtare të nivelit rajonal, evropian e botëror, institute kërkimi, etj., si dhe në sektorin privat si punonjës në median elektronike dhe të shkruar, kompani shumëkombëshe biznesi, organizata dhe fondacione të ndryshme publike e jo publike. Programi i studimit Bachelor në Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare është një program që reflekton ligjin e Arsimit të lartë, strategjinë kombëtare për zhvillim dhe Integrim, nevojat për tregun e punës për specialistë të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, por jo vetëm, ai është një program konkurrent me tregun ndërkombëtar të punësimit të specialistëve të kësaj fushe.



PLANI MËSIMOR PROFILI “MARRËDHËNIE DHE INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE”

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SOCIOLOGJI	6
2	ECONOMICS Economics I Economics II	8 4 4
3	SHKRIM AKADEMIK	6
4	INFORMATIKË	6
5	GJUHE E HUAJ 5.1 Gjuhë e huaj I 5.2 Gjuhë e huaj II	8 4 4
6	SHKENCA POLITIKE 6.1 Bazat e shkencës politike 6.2 Filozofi politike	12 7 5
7	NJOHURI MBI TRASHIGIMINË KULTURORE DHE NATYRORE TË SHQIPËRISË DHE MESDHEUT	6
8	HISTORIA POLITIKE E EUROPES DHE INTEGRIMIT EUROPIAN 8.1 Historia e Europës 8.2 Historia e integritimit europian	8 4 4

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	E DREJTË PUBLIKE	5
2	TEORIA E DEMOKRACISË/QEVERISJE EUROPIANE 2.1 Teoria e demokracisë/Qeverisje europiane I 2.2 Teoria e demokracisë/Qeverisje europiane II	10 5 5
3	LIDERSHIPI	7
4	BAZAT E DIPLOMACISË POLITIKË E JASHTME 5.1 Toritë e politikës së jashtme 5.2 Diplomacia e Shqipërisë	7 9 4 5
6	SISTEMET NDËRKOMBËTARE TË SIGURISE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	7 10
7	7.1 Histori e MND 7.2 Bazat teorike të MND	5 5
8	LËNDË ME ZGJEDHJE SHOQËRIA CIVILE DHE TË DREJTAT E NJËRIUT NË EPOKËN E GLOBALIZMIT KURS SPECIAL	5

PRAKTIKAT MËSIMORE

Studentët që do të ndjekin Programin Bachelor në Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare do të kenë mundësinë të zhvillojnë praktikat mësimore dhe vizita studimore falë bashkëpunimit shumë të mirë institucional të UMSH me një sërë institucionesh dhe zyra homologe si Ministrinë për Europën dhe Punëve të Jashtme, Ministrinë e Brendshme, Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Këshillin e Ministrave, Bashkinë Tiranë, institucione të tjera të pushtetit vendor dhe organizata të tjera kombëtare dhe Ndërkombëtare.

LEKSIONET E HAPURA

Në çdo semester të tre viteve akademike të Programit Bachelor në Marrëdhënie dhe Institucione Ndërkombëtare. Studentët do të marrin leksione nga profesionistët më të mirë ish-diplomatë karriere, dhe përfaqësues institucionalë me përvojë në politikën e jashtme. Këto leksione të hapura u krijojnë mundësi studentëve të përfitojnë nga përvojat unike të çdo lektori, si dhe njohuri praktike të profesionit të tyre.

VITI I TRETË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	INSTITUCIONET DHE LEGJISLACIONI I BE-SË 1.1 Institucionet dhe legjislacioni i BE-së I 1.2 BE dhe Zgjidhja e Krizave Ndërkombëtare	12 6 6
2	ROLI I MULTIKULTURALIZMIT NË NEGOCIATA DHE NË ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE	7
3	INSTITUCIONET FINANCIARE NDËRKOMBËTARE	7
4	MENAXHIM I PROJEKTEVE EUROPIANE	8
5	E DREJTA NDËRKOMBËTARE 5.1 E drejta ndërkombëtare publike 5.2 Organizatat dhe institucionet Ndërkombëtare	12 6 6
6	PRAKTIKË	6
7	PROVIM FORMIMI	8

Totali i planit mësimor: 180 ECTS

FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE



Programi i studimit Bachelor në “Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun”

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit "Komunikim dhe Marrëdhënie Me Publikun" në ciklin e studimeve Bachelor është strukturuar në mënyrë që t'u ofrojë studentëve përvetësimin e dijeve dhe kulturës se nevojshme në këtë fushë. Ata pajisen me instrumentet themelore të domosdoshëm për të përballuar kërkesat e tregut të punës për një sërë profesione që lidhen me shumë elementë të funksionimit të bizneseve private, nevojave të veçanta të administratës publike dhe pushtetit vendor. Ky program përmban të gjithë elementet e tjerë të nevojshëm që garantojnë kalimin në mjaft sisteme të mësimin të vazhdueshëm të përshtatshëm për metamorfozat e tregut të punës.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Synimi i këtij programi është të formojë një profil drejtuesi apo specialisti të aftë për të punuar në një gamë të gjerë profesione kryesisht në subjekte private të tregut pa lënë mënjanë administratën publike dhe pushtetin lokal. Ky program studimi ka si qëllim të përgatisë studentët për tregun e punës, për ngritjen e aftësive shkencore e profesionale dhe për të qenë

qytetarë aktivë. Nëpërmjet dijeve të transmetuara në auditor, teorive të komunikimit, praktikës së vazhdueshme laboratorike si edhe praktikës në kompani me të cilat kemi aktualisht marrëveshje apo jemi në diskutime për të lidhur marrëveshje, studentët e këtij cikli studimesh, do të jenë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin programeve të ndryshme me interes në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Programi i studimit "Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun" përgatit studentët që të dalin në tregun e punës si drejtues të marrëdhënieve me publikun dhe specialistë komunikimi.

NJOHURITË KRYESORE:

Në fund të programit të studimeve çdo kandidat duhet të ketë fituar shprehinë e nevojshme për të realizuar një punë cilësore të pavarur, të jetë aftësuar në punën organizative, koordinuese, hartuese dhe planifikuese të eventeve si dhe në aplikimin e teknologjive të reja në procesin e komunikimit. Gjithashtu ky kandidat duhet të ketë plotësuar të gjitha elementet e tjerë që formojnë profilin e një specialisti komunikimi dhe drejtuesi të marrëdhënieve me publikun..

PRAKTIKA MËSIMORE

Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në "Komunikim

dhe Marrëdhënie me Publikun" në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë kanë mundësinë, që praktikën mësimore të zhvillojnë në auditore me ekspertë të fushës së komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun, duke bërë të mundur përfitimin e eksperimenteve më të mira të punës, si dhe për të sjellë në praktikë njohuritë e tyre të përvetësuara gjatë studimeve universitare. Praktikën mësimore të studentëve organizohen në nivel të Njësia bazë që është Departamenti, i cili përcakton lektorin përgjegjës për tutorimin e studentëve dhe ndjekjen e praktikave mësimore.

REZULTATET E DIPLOMIT

Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun. Ky program studimi zgjat tre vite akademike gjatë të cilëve përftohen 180 kreditë. Në fund të programit të studimeve Çdo kandidat duhet të ketë fituar shprehinë e nevojshme për të realizuar një punë cilësore të pavarur, të jetë aftësuar në punën organizative, koordinuese, hartuese dhe planifikuese të eventeve si dhe në aplikimin e teknologjive të reja në procesin e komunikimit. Gjithashtu ky kandidat duhet të ketë plotësuar të gjitha elementet e tjerë që formojnë profilin e një specialisti komunikimi dhe drejtuesi të marrëdhënieve me publikun.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Statusi profesional që përfton i diplomuari në këtë program studimi është: Drejtues i marrëdhënieve me publikun dhe reklamave Drejtues i informacionit në shërbime të marrëdhënieve publike; Drejtues i shërbimit për publicitet/reklama; Drejtues i shërbimit të marrëdhënieve publike. Specialist i marrëdhënieve me publikun Specialist i marrëdhënieve me shtypin, Specialist Komunikimi Specialist koordinimi, Zëdhënës komunikimi me publikun, Specialist i marketingut dhe reklamës, Folës në radio, TV dhe media të tjera. Etj.

LEKSIONET E HAPURA

Gjatë vitit akademik studentet në nivelin Bachelor kanë mundësi të ndjekin leksione të hapura nga specialistë, ekspertë të spikatur nga shoqëria civile, institucionet kërkimore si dhe personalitete në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nga fusha e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. Këto leksione, u krijojnë mundësi studentëve të përfitojnë nga përvoja unike e çdo lektori si dhe njohuritë praktike të ekspertizës së tyre.



PLANI MËSIMOR PROFILI “KOMUNIKIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN”

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SHKRIM AKADEMIK EKONOMIKS	6 8
2	Hyrje në Ekonomi Hyrje në menaxhim	4 4
3	KOMUNIKIM MASIV	6
4	NJOHURI BAZË TË INFORMATIKËS GJUHË E HUAJ	6 8
5	Gjuhë e Huaj 1 Gjuhë e Huaj 2 HYRJE NË KOMUNIKIM	4 4 12
6	Elementët e Komunikimit Teoritë e Komunikimit	7 5
7	KOMUNIKIMI DIXHITAL NË ORGANIZATË SOCIOLOGJI-ANTROPOLOGJI SOCIALE	6 8
8	Sociologji Antropologji Sociale	4 4

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN DHE KOMUNIKIM 1.1. Marrëdhënie publike 1.2. Të shprehurit në publik	5 5
2	KOMUNIKIMI NË LIDERSHIP	7
3	PSIKOLOGJI E KOMUNIKIMIT 3.1. Hyrje në psikologji 3.2. Liria e të shprehurit dhe etika në komunikim	5 5
4	KOMUNIKIMI POLITIK DHE ORGANIZATIV 4.1. Komunikim politik 4.2. Komunikim organizativ	4 4
5	KOMUNIKIMI DHE SHOQËRIA	7
6	LËNDË ME ZGJEDHJE 6.1. Historia e Europës 6.2. Kurs special	4
7	KOMUNIKIMI NDËRKULTUROR	7
8	KOMUNIKIMI VIZUAL	7

VITI I TRETË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	PARIMET E LIGJËRIMIT 1.1. Elementët e semiotikës 1.2. Analizë ligjërimit	6 6
2	HYRJE NË MARKETING	6
3	MEDIA DHE PROMOCIONI	7
4	NEGOCIATAT DHE ZGJIDHJET E KONFLIKTEVE	6
5	ORGANIZIMI I SHOQËRISË 5.1. Format e organizimit të shoqërisë, shtetit dhe institucioneve shtetërore 5.2. Format e organizimit të shoqërive tregëtare	5 5
6	MODUL 6.1. Logjikë dhe Arsyetim 6.2. Kurs special në informatikë (Programe informatike në përdorim të komunikimit)	5
7	PRAKTIKË	6
8	DIPLOMA (PROVIM FORMIMI)	8

Totali i planit mësimor: 180 ECTS

FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE



Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor" është i lidhur me objektivat e brendshme për zgjerimin e fushave të studimit në Universitetin Mesdhetar, me mundësitë dhe interesimin shkencor akademik në njësinë drejtuese dhe në njësitë bazë, si dhe duke mbajtur në vëmendje gjendjen e arsimit fillor në veçanti, si pjesë e qëllimit të përgjithshëm të arsimit parauniversitar. Ky program do të shërbejë që të krijojë gjenerata të reja të mësuesve duke kombinuar traditën më të mirë pozitive të arsimit tonë me edukimin dhe formimin e aftësive të reja që lidhen me ndryshimin e përgjithshëm në fushën e arsimit si dhe me nevojat, prirjet dhe objektivat e zhvillimit të arsimit në veçanti dhe shoqërisë në përgjithësi. Me këtë cikël të ri të edukimit fillor, ne synojmë të sjellim një model në këtë fushë, të krahasueshëm me modelet më të mira europiane. Ky program është pjesë e edukimit universitar të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, hartuar në harmoni të plotë me paketën e e zhvillimit profesional

të mësuesve, sipas dokumentit të standardeve profesionale të mësuesit të arsimit fillor, ku kërkohet që mësuesi të ketë në vëmendje arritjet e fëmijëve sipas fushave të zhvillimit dhe të të nxëniet. Objektivi ynë është të formojmë mësues cilësisht të aftë për të përmbushur zhvillimin e përgjithshëm dhe të nxëniet e fëmijëve, që i inkurajon ata të zhvillojnë nivele të larta të aftësive për mësimdhënie, për zbatimin e plotë të kurrikulës bazuar në kompetenca nëpërmjet mësimdhënies efektive dhe shfrytëzimit të burimeve të cilësisë së lartë, zhvillimit të kompetencës digjitale dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të mësuarit. Programi merr në konsideratë teoritë e konfirmuara të zhvillimit dhe të të nxëniet për këtë grupmoshë. Mbi këtë bazë, janë konceptuar fushat e të nxëniet, është përcaktuar mjedisi i të nxëniet, është konfirmuar domosdoshmëria e partneritetit me familjen.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Pajisjen e studentëve me një --formim sa më bashkëkohor si edhe formimin e ekspertëve në fushën e Mësuesisë. Promovimin e zhvillimit të lirë të studimit,

procesit mësuesor dhe të kërkimit shkencor. Thellimin e njohurive të çdo studenti, zhvillimin e aftësive për mendim të thelluar analitik- kritik, si edhe zhvillimin e aftësive personale dhe profesionale në Mësuesi për Arsimin Fillor. Kujdesin për të ndërtuar mendim të pavarur dhe jo thjesht riprodhues, pra ndërtimi me kujdes që në moshat e hershme e të menduarit krijues. Kombinimin e edukimit gjuhësor dhe gramatikor edhe me edukimin logjik dhe me shprehje të komunikimit etik dhe qytetar si edhe edukimin psikologjik. Pajisjen e studentëve me njohuri për të përfshirë edukimin me artin, muzikën, vizatimin, me qëllim që ky lloj edukimi aq i rëndësishëm në edukimin qytetar dhe në nxitjen e dashurisë për të bukurën dhe punën e pavarur, në zbulimin e hershëm të talenteve të zërë një vend qendror në krijimin e personalitetit. Kombinimin e edukimit me teknologjitë e reja duke hedhur bazat e duhura për edukimin dixhital, për të krijuar inteligjencën artificiale dhe komunikimin me instrumentet inteligjente.

NJOHURITË KRYESORE

Përfshirjen e veçorive përmbajtësore, didaktike, kurrikulare,

metodologjike, dhe shkencore që përputhen me objektivat e mijëvjeçarit si dhe me detyrat që ka strategjia kombëtare e zhvillimit të arsimit për këtë nivel.

Përfshirjen e disa tipareve që nuk janë aq prezent në gjendjen aktuale ku konsiston në shumë orë matematike dhe gjuhe dhe lëndët jepen si strukturë shkencore e kombinuar me didaktikë.

Ofrimin e programit dhe kurrikulës, syllabuset dhe praktikat laboratorike të cilat do të konsultohen me psikologun e moshës.

Ofrimin e edukimit ekologjik, dashurinë për natyrën dhe fenomenet e saja ku do të zënë një vend të veçantë e të dallueshëm në këtë program. Edukimin me artin si vizatimi dhe muzika ku do të zënë një vend më të gjerë se më parë. Krijimin e një salle me të gjithë elementet didaktikë dhe pedagogjikë me qëllim që formimi i mësuesve të ardhshëm të bëhet në kushtet e një klase ku normalisht zhvillohet mësimi me fëmijët e kësaj brezmoshe.

PRAKTIKA MËSIMORE

Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë kanë mundësinë që praktikat mësimore



t'i zhvillojnë në auditore me ekspertë të fushës së edukimit, duke bërë të mundur përfitimin e eksperiencave më të mira të punës, si dhe për të sjellë në praktikë njohuritë e tyre të përvetësuar gjatë studimeve universitare. Praktikën mësimore të studentëve organizohen në nivel të Njësisë bazë që është Departamenti, i cili përcakton lektorin përgjegjës për tutorimin e studentëve dhe ndjekjen e praktikave mësimore.

REZULTATET E DIPLOMIT

Emërtimi i Diplomës: Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor
Programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor është konceptuar dhe realizuar i tillë që kombinon funksionalisht mësimnxënien. Programi i studimit është i bazuar në analizën e gjendjes aktuale të tregut të mësuesisë dhe të perspektivës. Arsyetimi ynë mbi rekrutimet është i bazuar edhe te nevojat për ndryshime cilësore në treg, çka shpreh një shqetësim institucional dhe shoqëror dhe që ka lidhje me mesataren e cilësuar të pranimit me notën 7,5 si mesatare e maturës shtetërore. Pra qasja jone është e tillë që të ndryshojmë gjendjen sasore të ofertë-kërkesës dhe aspektin cilësor të këtij raporti. Më thjeshtë, ky program studimi sjell për tregun e punësimit mësues të shekullit XXI metribute cilësore. Programi i studimit "Mësuesi për

arsimin fillor" është bazuar në analizën e gjendjes aktuale të tregut të mësuesisë dhe të perspektivës. Me gjithë rritjen e ndjeshme të numrit të mësuesve ndihmës në shkollat e zakonshme dhe trajnimet e zhvilluara, kapacitetet e tyre profesionale nuk janë akoma në nivelin e kërkuar në raport me rolin që kanë, njëkohësisht për shkak të hapësirës së pamjaftueshme shkollore, në zonat urbane ka mbingarkesë të klasave me nxënës. Nevojat e tregut të punës për këto specialitete kanë marrë parasysh standardet e cilësisë së mësimdhënies dhe dinamikën e zhvillimit të vendit.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Duke qënë se programi i studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor është konceptuar dhe realizuar i tillë që kombinon formimin e njohurive në fushën e arsimit fillor bazë të standarteve akademike me nevojat dhe aftësitë aplikative, në përfundim të studimeve studentët kanë përftuar të gjithë njohuritë e nevojshme në fushën përkatëse. Do të mundësohet punësimi në institucione publike dhe institucione private. Pas diplomimit studentët aftësohet për zhvillimin e një karriere të suksesshme në fushën e arsimit fillor.

LEKSIONET E HAPURA

Gjatë tre viteve të studimit të programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor, studentët marrin leksione të hapura edhe nga

PLANI MËSIMOR I TRE VITEVE TË STUDIMIT PROFILI "MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR"

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	PSIKOLOGJI ZHVILLIMI	8
2	TEORITË E SHKENCAVE TË EDUKIMIT	6
3	GJUHA SHQIPE	8
4	INFORMATIKË	6
5	METODOLOGJI E MËSIMDHËNIES	6
6	SHKRIM AKADEMIK	6
7	KOMUNIKIM PEDAGOGJIK	3
8	EDUKIM FIZIK, SPORTIV DHE DIDAKTIK	6
9	EDUKIM QYTETAR	3
10	ANGLISHT	8

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	ART PAMOR	6
2	MATEMATIKË SPECIALE	5
3	PSIKOLOGJI EDUKIMI DHE PRAKTIKAT E TË NXËNIT	7
4	MATEMATIKË 1 DHE 2	12
5	DIDAKTIKA E GJUHËS SHQIPE	6
6	PSIKOPATOLOGJI E MOSHËS SË HERSHME DHE ADOLESHENCËS	7
7	TEATËR/KËRCIM	3
8	TË MËSUARIT NËPËRMJET LOJËS	4
9	BOTA SPECIALE E FËMIJËS	4
10	PRAKTIKË PROFESIONALE	6

VITI I TRETË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	DIDAKTIKE E MATEMATIKES	6
2	LETËRSI PER FEMIJE	6
3	NJOHURI NGA BIOLOGJIA DHE DIDAKTIKE	3
4	NJOHURI NGA KIMIA DHE DIDAKTIKE	3
5	NJOHURI NGA FIZIKA DHE DIDAKTIKE	3
6	EDUKIM MJEDISOR	3
7	HISTORI E SHQIPERISE	8
8	NJOHURI MBI GJEOGRAFINE DHE DIDAKTIKE	3
9	EDUKIM MUZIKOR	8
10	BUKURSHKRIM/EDUKIM SHENDETESOR	3
11	PRAKTIKA PROFESIONALE	9
12	PROVIM FORMIMI/PUNIME DIPLOME	5

Totali i planit mësimor: 180

specialistët më të mirë vendas dhe të huaj më të mirë në treg, të cilët kanë një përvojë të mirë në zhvillimin e seminareve dhe workshopeve, në rang lokal dhe kombëtar, promovime librash, afishime online, si dhe komunikimi me shoqërinë dhe institucionet e

linjës. Organizimi i seminareve UMSH siguron akses në bibliotekat dixhitale më të specializuara në rang ndërkombëtar. Ndërmjet leksioneve të hapura studentet përftojnë njohuri praktike në fushat përkatëse.

FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE



Programi i Studimit Bachelor në “Mësuesi në Arsimin Parashkollor”

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi Bachelor në "Mësuesi në Arsimin Parashkollor" është i lidhur me objektivat e brendshme për zgjerimin e fushave të studimit në Universitetin Mesdhetar, me mundësitë dhe interesimin shkencor akademik në njësinë drejtuese dhe në njësitë bazë, si dhe duke mbajtur në vëmendje gjendjen e arsimit parashkollor në veçanti, si pjesë e qëllimit të përgjithshëm të arsimit parauniversitar. Sipas dokumentit të strategjisë kombëtare të arsimit, në pesë vitet e ardhshme do të krijohen kushtet që të gjithë fëmijët e moshës 5-6 vjeç të kenë akses në arsimin parashkollor, goftë nëpërmjet regjistrimit në grupet e 3-ta në kopshte, ose në klasa përgatitore. Një mësues që do të merret me mësimin dhe edukimin e këtyre breznive do të duhet të ketë një formim të përshtatshëm dhe në gjendje të përballojë sfidat e zhvillimit, vendor dhe atij ndërkombëtar. Ndryshimi nuk mund të realizohet nëse nuk formohet një staf i mësuesve të ciklit parashkollor, i ri në mentalitet, kapacitete dhe kulturë të përgjithshme. Gjithçka që mësohet mirë, shkencërisht

korrekt, në përputhje me psikologjinë e moshës, dhe që ndihmon në qëmtimin e prirjeve dhe mirformimin e karakterit si dhe të ndërtimit të tipareve të njeriut të shekullit XXI, ndihmojnë në realizimin e objektivave të shoqërisë dhe ecjen e saj përpara. Kjo ndërmarrje kushtëzohet se me cilët mësues mësojnë fëmijët e moshës 3-5 vjeçarë. Programi është konceptuar në frymën e kurrikulave të arsimit të detyruar, duke iu referuar dimensioneve themelore në mirërritje dhe edukim të fëmijës në grupmoshat 3-6 vjeç. Programi merr në konsideratë teoritë e konfirmuara të zhvillimit dhe të të nxënës për këtë grupmoshë, të cilat i japin rëndësi të veçantë aspektit akademik që ato përcjellin. Mbi këtë bazë, janë konceptuar fushat e të nxënës edhe është përcaktuar mjedisi i të nxënës. Cikli i programit të Arsimit Parashkollor është ndarë në pesë fusha të zhvillimit të fëmijës: në atë fizik dhe motorik; konjitiv; emocional; social; gjuha. Fushat e mësipërme janë konceptuar të trajtohen në mënyrë sinergjike dhe secilës fushë i korrespondon një kompetencë përkatëse. Secila prej tyre ka dy fusha zhvillimi i cili nga ana e tij shpaloset në një numër përbërësish të formuluar mbi bazën e perspektivës së fëmijës.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Pajisjen e studentëve me një formim sa më bashkëkohor si edhe formimin e ekspertëve në fushën e Arsimit Parashkollor. Promovimin e zhvillimit të lirë të studimit, procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor. Thellimin e njohurive të çdo studenti, zhvillimin e aftësive për mendim të thelluar analitik-kritik, si edhe zhvillimin e aftësive personale dhe profesionale në Arsimin Parashkollor. Kujdesin për të ndërtuar mendim të pavarur dhe jo thjesht riprodhues, pra ndërtimi me kujdes që në moshat e hershme e të menduarit krijues. Krijimin e mundësive për formimin cilësor të mësuesve të ardhshëm, që i inkurajon ata të zhvillojnë nivele të larta të aftësive për mësimdhënie. Zbatimin e plotë të kurrikulës së bazuar në kompetenca nëpërmjet mësimdhënies efektive dhe shfrytëzimit të burimeve të cilësisë së lartë. Zhvillimin e kompetencës dixhitale nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për mësimdhënie dhe të mësuarit. Njohuritë kryesore Programi i arsimit parashkollor ka në qendër interesat individuale të fëmijëve, aftësitë dhe stilet e ndryshme të të

nxënës, ndryshimet ndërmjet individëve dhe nevojave të tyre të veçanta; Trajtimin e të gjithë fëmijëve në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe dinjitoze, duke treguar respekt për çdo fëmijë dhe familjen e tij, pavarësisht prejardhjes dhe kulturës së saj në mënyrë që çdo fëmijë të përmbushë potencialin e tij; Ndryshimin e strukturës dhe planit mësimor, duke realizuar një raport ambicioz, midis formimit shkencor (matematikë, gjuhë, histori, etj) dhe formimit profesional (pedagogji, didaktike, psikologji etj.) Aftësimin e mësuesve për përdorim me efikasitet të Teknologjisë së Informacionit dhe asaj dixhitale. Rikonceptimin e praktikave mësimore duke bashkëpunuar me shkollat të arsimit parauniversitar. (Kontrata me shkollat cilësore me interes të përbashkët, konkretisht me shkollën "Elite"). Konsultimin e programit dhe kurrikulës, syllabusit dhe praktikave laboratorike me psikologun e moshës. Krijimin e një salle me të gjithë elementet didaktikë dhe pedagogjikë me qëllim që formimi i mësuesve të ardhshëm të bëhet në kushtet e një klase ku



normalisht zhvillohet mësimi më fëmijët e kësaj brezmoshe.

PRAKTIKA MËSIMORE

Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Mësuesi në Arsimin Parashkollor në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë kanë mundësinë që praktikat mësimore t'i zhvillojnë në auditore me ekspertë të fushës së edukimit dhe arsimit parashkollor, duke bërë të mundur përfitimin e eksperincave më të mira të punës, si dhe për të sjellë në praktikë njohuritë e tyre të përvetësuara gjatë studimeve universitare. Praktikrat mësimore të studentëve organizohen në nivel të Njësisë bazë që është Departamenti, i cili përcakton lektorin përgjegjës për tutorimin e studentëve dhe ndjekjen e praktikave mësimore.

REZULTATET E DIPLOMIT

Emërtimi i Diplomës: Bachelor në Mësuesi në Arsimin Parashkollor Programi i studimit Bachelor në Mësuesi në Arsimin Parashkollor është bazuar në analizën e gjendjes aktuale të tregut të mësuesisë dhe të perspektivës. Arsyetimi ynë mbi rekrutimet është i bazuar edhe te nevojat për ndryshime cilësore në treg, çka shpreh një shqetësim institucional dhe shoqëror dhe që ka lidhje me mesataren e cilësuar të pranimit me notën 7,5 si mesatare e maturës shtetërore. Përmes këtij programi UMSH do të materializojë ato tipare dhe metoda pune, sipas parimeve europiane dhe anglosaksone në shkollimin e fëmijëve të

kësaj moshe, që përputhen me objektivat e mijëvjeçarit si dhe me detyrat që ka strategjia kombëtare e zhvillimit të arsimit për këtë nivel.

Hartimi i kurrikulave të dallueshme nga ato që janë aktualisht në treg, duke venë në qendër interesat individuale të fëmijëve, aftësitë dhe stilet e ndryshme të të nxëniet, ndryshimet ndërmjet individëve dhe nevojave të tyre të veçanta; duke realizuar një raport ambicioz, midis formimit shkencor (matematikë, gjuhë, histori, etj) dhe formimit profesional (pedagogji, didaktike, psikologji etj).

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Duke qënë se programi i studimit Bachelor në Mësuesi në Arsimin Parashkollor është konceptuar dhe realizuar i tillë që kombinon formimin e njohurive në fushën e arsimit parashkollor bazë të standarteve akademike me nevojat dhe aftësitë aplikative, në përfundim të studimeve studentët kanë përfutur të gjithë njohuritë e nevojshme në fushën përkatëse. Do të mundësohet punësimi në institucione publike dhe institucione private. Pas diplomimit studentët aftësohet për zhvillimin e nje karriere të suksesshme në fushën e arsimit parashkollor.

LEKSIONET E HAPURA

Gjatë tre viteve të studimit të programit të studimit Bachelor në Mësuesi në Arsimin Parashkollor, studentët marrin leksione të hapura edhe nga specialistët më të mirë vendas dhe të huaj më të

PLANI MËSIMOR PROFILI MËSUESI NË ARSIMIN PARASHKOLLOR

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	PSIKOLOGJI ZHVILLIMI	8
2	METODOLOGJI E MËSIMDHËNIES	6
3	GJUHA SHQIPE	8
4	INFORMATIKË	6
5	TEORITË E SHKENCAVE TË EDUKIMIT	6
6	SHKRIM AKADEMIK	6
7	KOMUNIKIM PEDAGOGJIK	3
8	EDUKIM FIZIK, SPORTIV DHE DIDAKTIK	6
9	EDUKIM QYTETAR	3
10	ANGLISHT	8

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	ART PAMOR	6
2	MATEMATIKË NËPËRMJET LOJËS	5
3	PSIKOLOGJI EDUKIMI DHE PRAKTIKAT E TË NXËNIT	7
4	MATEMATIKË ELEMENTARE	12
5	DIDAKTIKA E GJUHËS SHQIPE	6
6	PSIKOPATOLOGJI E MOSHËS SË HERSHME DHE ADOLESHENCËS	7
7	KULTURA E LEXIMIT/KËRCIM	3
8	TË MËSUARIT NËPËRMJET LOJËS	4
9	BOTA SPECIALE E FËMIJËS	4
10	PRAKTIKË PROFESIONALE	6

VITI I TRETË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SOCIOLOGJI E SJELLJES	6
2	KULTURA E TË FOLURIT	6
3	EDUKIM TEKNOLOGJIK	4
4	EDUKIM MJEDISOR	4
5	KURRIKULA	8
6	DRAMA, KUKULLAT, MEDIA	6
7	EDUKIM MUZIKOR	8
8	KUJDESI PER VETEN, SIGURIA DHE HIGJENA/EDUKIM ARTISTIK	4
9	PRAKTIKA PROFESIONALE	9
10	PROVIM FORMIMI/PUNIME DIPLOME	5

Totali i planit mësimor: 180

mirë në treg, të cilët kanë një përvojë të mirë në zhvillimin e seminareve dhe workshopeve, në rang lokal dhe kombëtar, promovime librash, afishime on-line, si dhe komunikimi me shoqërinë dhe institucionet e linjës. Organizimi i seminareve

UMSH siguron akses në bibliotekat dixhitale më të specializuara në rang ndërkombëtar. Ndërmjet leksioneve të hapura studentet përfitojnë njohuri praktike në fushat përkatëse.

FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE



Programi i Studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative me profil: "Politikat e Integritit dhe Qeverisjes"

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profil "Politikat e Integritit dhe Qeverisjes" në vazhdimësi ka përmirësuar kurrikulat që ti përgjigjet nevojave të vendit dhe të tregut për një brez të diplomuarish të cilët do të kontribuojnë në përmbushjen e proceseve politike, ekonomike, sociale dhe administrative. Integrimi në Bashkimin Evropian, përbalja me problemet politike, ekonomike, vështirësitë sociale, depolitizimi i administratës së vendit, modernizimi i saj, forcimi i institucioneve, rrënjësia e demokracisë, krijimi i një opinion publik të shëndoshë, konsolidimi i shtetit të së drejtës, punësimi, zhvillimi i politikave të mira etj janë disa prej sfidave kryesore me të cilat vazhdon edhe sot të përballet Shqipëria. Programi Bachelor i Shkenca Politike e Administrative me profil: "Politika e Integritit dhe Qeverisjes" është pjesë e kurrikulës së Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. Programi ka si qëllim pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara në fushën e studimeve europiane dhe politikave qeverisëse në nivel lokal dhe rajonal. Programi e përmbush këtë qëllim duke ju dhënë studentëve në UMSH një edukim

cilësor, të qëndrueshëm dhe praktik me anë të teknikave novatore të mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe partneriteteve me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky program mbështetet njëkohësisht në një bashkëpunim të gjerë me përfaqësues të shoqërisë civile, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, ambasada si dhe drejtues të pushtetit lokal dhe qendror në vend. Në këtë mënyrë studentët mund të integrohen më shpejt në tregun e punës.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Të përgatisë studentët me aparat praktik dhe teorik për të ndërtuar një analizë politike rreth asaj që ndodh në vendin tonë, në rajon por edhe në arenën ndërkombëtare; Të zhvillojë njohuritë e studentëve, mbi mekanizmat e konsolidimit të një shteti demokratik nëpërmjet implementimit të politikave qeverisëse, të integritit si dhe t'i njohi me rreziqet që i kanosen një demokracie në tranzicion; t'i pajisë studentët me aparat duhur teorik për analizimin dhe krahasimin e sistemeve politike, me njohuritë e nevojshme për kontekstin historik, ekonomik dhe social brenda të cilave sistemet politike të analizuar janë zhvilluar dhe kanë marrë formën që kanë sot Të përgatisë studentët që të marrin njohuri të thelluara për funksionimin e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe

gjyqësor si dhe për kompetencat dhe rolin e Presidentit në sisteme të ndryshme politike. Të realizojë njohjen e studentëve me idenë e projektit european, politikat integruese, politikat rishpërndarëse si edhe mënyrat e ngritjes së institucioneve mbinacionale si edhe me procesin e zgjerimit ku edhe ndodhet Shqipëria

NJOHURITË KRYESORE

Ky program studimi synon të aftësojë studentët për të analizuar aspekte dhe aktivitete të ndryshme të politikave të integritit, institucioneve të Bashkimit Evropian, politikave të BE-së, si ato rishpërndarëse, ekonomike, juridike, të formave të qeverisjes në përgjithësi. Studentët njihen më në thellësi me procesin e integritit (rajonal dhe evropian) i cili është pjesë e pandarë e rrugëtimit të Shqipërisë drejt familjes evropiane. Në këtë program studimi, një rol të rëndësishëm zë fitimi i njohurive të reja të natyrës teorike dhe praktike, menaxhimit të projekteve evropiane, të drejtës ndërkombëtare dhe evropiane, etika e qeverisjes dhe administrimit publik, shoqëria civile dhe të drejtat e njeriut në epokën e globalizimit, digjitalizimi i procesit politik, e drejta administrative, e drejta publike, ekonomia e burimeve njerëzore etj. Njohuritë e ofruara nga ky program dhe aftësitë që përfitojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre avancimin drejt një karriere akademike ose kërkimore, nëpërmjet

vazhdimet të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur mundësitë për sukses profesional në tregun e punës.

PRAKTIKA MËSIMORE

Studentët që do të ndjekin programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profil: "Politika e Integritit dhe Qeverisjes" ju ofrohet mundësia ta zhvillojnë praktikën profesionale në institucionet bashkëpunuese të UMSH ose në ore intensive në auditoret e universitetit. Përfaqësues të shoqërisë civile, administratës publike, institucioneve kërkimore si dhe zyrtar të pushtetit lokal dhe qendror vijnë në ambjentet e universitetit për të transmetuar njohuri praktike nga fushate e ekspertizës së tyre si dhe informacione mbi sfidat e reja të tregut të punës. Kjo mundësi për studentet vjen falë bashkëpunimit dhe marrëveshjeve që UMSH ka me këto partnerë të rëndësishëm. Aktivitetet zhvillohen sipas një kalendarit të mirëpërcaktuar gjatë gjithë semestrit të dytë të vitit të tretë akademik.

REZULTATET E DIPLOMIT

Emërtimi i Diplomës: Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisjes"

Programi i Shkencave Politike e Administrative me profile: "Politikat e Integritit dhe Qeverisjes" jep mundësi për të nisur një karrierë të rëndësishme në administratën dhe manaxhimin e organizatave



PLANI MËSIMOR PROFILI POLITIKAT E INTEGRIMIT DHE QEVERISJES

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SOCIOLOGJI EKONOMIKS	6
2	1. Ekonomiks 1 2. Ekonomiks 2	4 4
3	SHKRIM AKADEMIK	6
4	INFORMATIKË	6
5	GJUHË E HUAJ 1. Gjuhë e Huaj 1 2. Gjuhë e Huaj 2	4 4
6	SHKENCA POLITIKE 1. Bazat e Shkencës Politike 2. Filozofi politike	7 5
7	NJOHURI MBI TRASHËGIMINË KULTURORE DHE NATYRORE TË SHQIPËRISË DHE TË MESDHEUT HISTORIA POLITIKE E EUROPËS DHE E INTERGIMIT EUROPIAN	6 4
8	1. Historia e Europës 2. Historia e Intergimit European	4 4

vendase dhe të huaja. Njohuritë e ofruara nga ky program dhe aftësitë që përfitojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre avancimin drejt një karriere akademike ose kërkimore, nëpërmjet vazhimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur mundësitë për sukses profesional në tregun e punës. Për ta bërë sa më të thjeshtë dhe të lehtë momentin e takimit të studentëve të diplomuar me kërkesat e tregut të punës, është konsideruar me një rëndësi të madhe forcimi i bashkëpunimeve të gjera me institucionet e ndryshme, publike në nivel qendror dhe lokal, me organizata të ndryshme ndërkombëtare, me biznesin, OJF dhe OJQ.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Pas përfundimit të këtij programi studimi, studentët aftësohen si

specialistë të Shkencave Politike në përgjithësi dhe të politikave integruese dhe qeverisëse në vecanti. Mundësitë e punësimit ofrohen si në sektorin publik dhe atë privat, nivel qendror dhe lokal. Më specifikisht: Në Organizata Ndërkombëtare Rezidente në Shqipëri. Në Institucione Kërkimore Shkencore. Në sektor të vecantë të pushtetit lokal. Në sektor të vecantë brenda ministrive që lidhen me politikën dhe proceset integriese të Shqipërisë drejt BE-së. Në media tradicionale dhe elektronike Në OJF dhe OJQ, Në departamentet e korporatave që mbulojnë marrëdhëniet me jashtë. Në strukturat e partive politike

LEKSIONET E HAPURA

Gjatë vitit akademik studentet në nivelin Bachelor kanë mundësi të

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	TEORITË E DEMOKRACISË/ QEVERISJA EUROPIANE (TDQE)	5
	1. TDQE 1 2. TDQE 2	5
2	LIDERSHIPI	7
3	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE 1. Histori e Marrëdhënieve Ndërkombëtare 2. Bazat Teorike të Marrëdhënieve Ndërkombëtare	5 5
4	BAZAT E DIPLOMACISË	7
5	GJEOGRAFI POLITIKE	6
6	SISTEMET POLITIKE 1. Sistemet Politike në Botën e Sotme 2. Shoqëria Civile dhe të Drejtat e Njeriut në Epokën e Globalizmit	5 5
7	E DREJTË PUBLIKE	5
8	LËNDË ME ZGJEDHJE 1. E drejtë e Punës 2. Tre degët e qeverisje	5

VITI I TRETË

Nr.	Lëndët	ECTS
1.	INSTITUCIONET DHE LEGJISLACIONI I BE-SË 1. Institucionet dhe legjislacioni i BE-së 1 2. Institucionet dhe legjislacioni i BE-së 2	6 6
2	POLITIKAT E RISHPËRNDARJES TË BE-SË	7
3	DIGJITALIZIMI I PROCESIT POLITIK	7
4	OPINIONI PUBLIK DHE BAROMETRI ELEKTORAL 1. Opinioni Publik 2. Barometri Elektoral	6 6
5	MENAXHIM I PROJEKTEVE EUROPIANE	8
6	PRAKTIKA	6
7	DIPLOMA (PROVIMI FORMUES)	8

Totali i planit mësimor: 180 ECTS

ndjekin leksione të hapura nga specialistë, ekspertë të spikatur nga shoqëria civile, institucionet kërkimore si dhe personalitete në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

nga fusha politike. Këto leksione, u krijojnë mundësi studentëve të përfitojnë nga përvoja unike e çdo lektori si dhe njohuritë praktike të ekspertizës së tyre.

FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE



Programi i studimit Bachelor në Shkenca Politike dhe Administrative me profil: "Administratë Publike"

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profil "Administratë Publike" në vazhdimësi ka përmirësuar kurrikulat që t'i përgjigjet nevojave të vendit dhe të tregut për një brez të diplomuarish të cilët do të kontribuojnë në përbushjen e proceseve politike, ekonomike, sociale dhe administrative. Depolitizimi i administratës së vendit, modernizimi i saj, forcimi i institucioneve, konsolidimi i shtetit të së drejtës, zhvillimi i politikave të mira etj janë disa prej sfidave kryesore me të cilat vazhdon edhe sot të përballtet administrata publike në Shqipëri. Programi Bachelor i Shkenca Politike e Administrative me profil: "Administratë Publike" është pjesë e kurrikulës së Fakultetit të Shkencave Psikologjike, Sociale dhe Politike. Programi ka si qëllim pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara në fushën e administratës publike. Programi e përbush këtë

qëllim duke ju dhënë studentëve në UMSH një edukim cilësor, të qëndrueshëm dhe praktik me anë të teknikave novatore të mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe partneriteteve me institucione homologe kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky program mbështetet njëkohësisht në një bashkëpunim të gjerë me përfaqësues të administratës publike, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë mënyrë studentët mund të integrohen më shpejt në tregun e punës.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Të përgatisë studentët me aparatin praktik dhe teorik për të ndërtuar një analizë politike rreth asaj që ndodh në vendin tonë, në rajon por edhe në arenën ndërkombëtare; Të zhvillojë njohuritë e studentëve, mbi mekanizmat e konsolidimit të një shteti demokratik nëpërmjet implementimit të politikave qeverisëse, të integritit si dhe t'i njohi me rreziqet që i kanosen një demokracie në tranzicion; Ti pajisë studentët me aparatin e duhur teorik për analizimin dhe

krahasimin e sistemeve politike, me njohuritë e nevojshme për kontekstin historik, ekonomik dhe social brenda të cilave sistemet politike të analizuar janë zhvilluar dhe kanë marrë formën që kanë sot. Të aftësojë studentët me mënyrat e administrimit publik, me politikën publike, me fazat e shqyrtimit të politikave publike, me mënyrat e vlerësimit të një problemi publik, me llojet e komunikimit mes aktorëve të politikës publike dhe rolin e politikave publike në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqënies.

NJOHURITË KRYESORE

Ky program studimi synon të përgatisë administratorë dhe funksionar publik të aftë për të kontribuar në zhvillimin politik të vendit, emancipimin e klasës politike si dhe në modernizimin dhe performancën e administratës publike në Shqipëri. Studentët njihen me Shkencën e Administratës Publike në tërësi si dhe me sistemet administrative të vendeve të zhvilluara të BE-së dhe më gjerë. Në këtë program studimi, një rol të rëndësishëm zë fitimi i njohurive të reja të natyrës teorike dhe praktike në drejtim të menaxhimit të projekteve rajonale dhe evropiane, etika e qeverisjes dhe administrimit publik, digjitalizimi i

procesit politik, e drejta administrative, e drejta publike, ekonomia e burimeve njerëzore etj. Njohuritë e ofruara nga ky program dhe aftësitë që përfitojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre avancimin drejt një karriere akademike ose kërkimore, nëpërmjet vazhdimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur mundësitë për sukses profesional në tregun e punës si dhe një vend dinjitoz në administratën publike dhe jo publike.

PRAKTIKA MËSIMORE

Studentët që do të ndjekin programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profil: "Administratë Publike" ju ofrohet mundësia ta zhvillojnë praktikën profesionale në institucionet bashkëpunuese të UMSH ose në orë intensive në auditoret e universitetit. Përfaqësues të shoqërisë civile, administratës publike dhe institucioneve kërkimore vijnë në ambjentet e universitetit për të transmetuar njohuri praktike nga fushat e ekspertizës së tyre si dhe njohuri mbi sfidat e reja të tregut të punës. Aktivitetet zhvillohen sipas një kalendari të mirëpërcaktuar gjatë gjithë semestrit të dytë të vitit të tretë



akademik. Kjo mundësi për studentet vjen falë bashkëpunimit dhe marrëveshjeve që UMSH ka me këto partner të rëndësishëm.

REZULTATET E DIPLOMIT

Emërtimi i Diplomës: Bachelor në Shkenca Politike e Administrative me profile "Administratë Publike" Programi i Shkencave Politike e Administrative me profile: "Administratë Publike" jep mundësi për të nisur një karrierë të rëndësishme në administratën publike dhe jo publike si dhe në organizata dhe institucione kombëtare dhe ndërkombëtare. Njohuritë e ofruara nga ky program dhe aftësitë që përfitojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre avancimin drejt një karriere akademike ose kërkimore, nëpërmjet vazhdimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur mundësitë për sukses profesional në tregun e punës. Për ta bërë sa më të thjeshtë dhe të lehtë momentin e takimit të studentëve të diplomuar me kërkesat e tregut të punës, UMSH i ka dhënë një rëndësi të madhe forcimit të bashkëpunimeve me institucionet e ndryshme publike në nivel qendror dhe lokal, me organizata

të ndryshme ndërkombëtare, me biznesin, OJF dhe OJQ.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Pas përfundimit të këtij programi studimi, studentët aftësohen si specialistë të shkencave politike në përgjithësi dhe të administratës publike dhe jo publike në vecanti. Mundësitë e punësimit ofrohen si në sektorin publik dhe atë privat, nivel qendror dhe lokal. Më specifikisht: Në Administratën Publike Në Administratën e Kompanive Private:

Në Organizata Ndërkombëtare
Rezidente në Shqipëri Në Institucione Kërkimore Shken-
core
Në media tradicionale dhe elektronike:
Në OJF dhe OJQ.

LEKSIONET E HAPURA

Gjatë vitit akademik studentet në nivelin Bachelor kanë mundësi të ndjekin leksione të hapura nga specialistë, ekspertë të spikatur nga administrata publike, shoqëria civile si dhe institucionet kërkimore në vend.. Këto leksione, u krijojnë mundësi studentëve të përfitojnë nga përvoja unike e çdo lektori si dhe njohuritë praktike të ekspertizës së tyre.

PLANI MËSIMOR PROFILI ADMINISTRATË PUBLIKE

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	SOCIOLOGJI	6
2	EKONOMIKS 1. Ekonomiks 1 2. Ekonomiks 2	4 4
3	SHKRIM AKADEMIK	6
4	INFORMATIKË	6
5	GJUHË E HUAJ 1. Gjuhë e Huaj 1 2. Gjuhë e Huaj 2	4 4
6	SHKENCA POLITIKE 1. Bazat e Shkencës Politike 2. Filozofi Politike	7 5
7	NJOHURI MBI TRASHËGIMINË KULTURORE DHE NATYRORE TË SHQIPËRISË DHE TË MESA-DHEUT	6
8	HISTORIA POLITIKE E EUROPËS DHE E INTERGIMIT EUROPIAN 1. Historia e Europës 2. Historia e intergimit European	4 4

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	TEORITË E DEMOKRACISË/QEVERISJA EUROPIANE (TDQE) 1. TDQE 1 2. TDQE 2	5 5
2	LIDERSHIPI	7
3	MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE 1. Histori e Marrëdhënieve Ndërkombëtare 2. Bazat Teorike të Marrëdhënieve Ndërkombëtare	5 5
4	TEORI TË QEVERISJES 1. Tre degët e Qeverisjes. 2. Etika e Qeverisjes dhe Administrimi Publik	5 7
5	ADMINISTRIMI PUBLIK	7
6	E DREJTA ADMINISTRATIVE	5
7	E DREJTË PUBLIKE	5
8	LËNDË ME ZGJEDHJE ✓ Politikat Publike ✓ E Drejte Fiskale	5

VITI I TRETË

Nr.	Lëndët	ECTS
1.	INSTITUCIONET DHE LEGJISLACIONI I BE-SË 1. Institucionet dhe legjislacioni i BE-së 1 2. Institucionet dhe legjislacioni i BE-së 2	6 6
2	POLITIKAT E RISHPËRNDARJES TË BE-SË	7
3	MENAXHIMI I PROJEKTEVE EUROPIANE	8
4	E DREJTA E PUNËS	5
5	EKONOMIA E BURIMEVE NJERËZORE	6
6	POLITIKAT BUXHETORE	8
7	PRAKTIKA	6
8	DIPLOMA (PROVIM FORMUES)	8

Totale i planit mësimor: 180 ECTS

FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE



Programi i studimit në Bachelor në “Psikologji e Përgjithshme”

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i studimit në Bachelor në "Studime Psikosociale" ofron themelin e njohurive teorike dhe analitike në fushën e psikologjisë. Rëndësia e programit qëndron në faktin se studimet në psikologji kanë kontribuar për të mirën më të madhe të shoqërisë në fusha të ndryshme. Gjithnjë e më tepër vihet re një ndërgjegjësim nga instancat shtetërore dhe entet private, për të përfshirë psikologun në shërbim të nevojave të vendit. Aktualisht në vendin tonë roli i psikologut ka marrë një rëndësi, që me stabilizimin e profesionit me themelimin e Urdhrit të psikologut. Duke qenë se legjislacioni shqiptar i ofron një garanci dhe mbështetje ligjore të miturit, nëpërmjet respektimit të të drejtave të tij për një jetë normale, të sigurt dhe të qetë, një familje të shëndoshë që kujdeset për mirërritjen, edukimin, zhvillimin, mirëqenien dhe arsimimin e tij, ai përcakton detyra specifike për shtetin dhe shoqërinë me fokus sigurimin e të gjitha kushteve, të

cilat bëjnë të mundur këtë mirëqenie dhe parandalojnë keqtrajtimin psikologjik, social, fizik, ekonomik etj. të fëmijëve në familje, në shkollë dhe në të gjitha ambientet e institucionet për të mitur.

OBJEKTIVAT KRYESORE FORMUESE

Pajisjen e studentëve me një formim sa më bashkëkohor në Psikologji. Përvetësimin nga ana e studentëve të teorive klinike, këshillimore, dhe sociale. Përgatitja me njohuri multidisiplinare nëpërmjet gërshetimit të dijes në psikosociologji me disiplina të sektorëve më social dhe ekonomik, me ndikim gjithnjë e më të madh sot tek individit, mirëqenia dhe vendimarrja e tij brenda në organizata. Pajisjen me njohuri bazë të kërkimit shkencor si edhe përgatitjen e profesionistëve të aftë për të ndjekur nivele gjithnjë e më të larta të studimeve në fushën e psikologjisë. Pajisjen e studentëve me dije sa më koherente edhe në shkencat sociale siç janë metodologji e kërkimit shkencor, studime gjinore, etj, përveç disiplinave të orientimit psikologjik si psikologji sociale, bazat e studimeve psikologjike, psikologji e familjes,

psikologji edukimi, konjicion social, psikologji personaliteti, psikologji klinike dhe teori këshillimi. Ofrimin e teorive bazë si dhe pajisjen me instrumentat kryesorë për vënien në praktikë të aftësive të tyre. Kjo përmbushet nëpërmjet thellimit të njohurive që lejojnë vlerësimin e shoqërisë dhe të individit mbi bazën e dijeve që marrin në konsideratë ndikimet kontekstuale, kulturore dhe sociale. Kapaciteti për të identifikuar dhe analizuar fenomenet, sensi i lartë i etikës profesionale janë objektiva formuese, pa lënë mënjanë gjithashtu respektimin e diversitetit dhe identitetin etnik të individit.

NJOHURITË KRYESORE

Formimi i specialistëve në fushën e psikologjisë me fokus të veçantë në aspektet sociale, këshillimore, klinike, familjare dhe organizative. Përvetësimi nga ana e studentëve i teorive të psikosociologjisë individuale dhe asaj sociale, klinike, në këshillim si dhe atyre, që analizojnë marrëdhëniet e njeriut në raportet organizative; Përvetësimi i dijes multidisiplinare, duke gërshetuar njohuritë psikologjike mbi ato në fushën, sociale, instrumentale, teknologjike, etj

Promovimi i kapaciteteve hulumtuese si edhe përgatitja e specialistëve të aftë për të ndjekur nivelet më të larta formimi në fushën e Psikologjisë.

PRAKTIKA MËSIMORE

Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në Studime Psikosociale në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë kanë mundësinë, që praktikant mësimore t'i zhvillojnë në auditore me ekspertë të fushës së psikologjisë klinike, organizative, komunitare, duke bërë të mundur përfitimin e eksperimenteve më të mira të punës, si dhe për të sjellë në praktikë njohuritë e tyre të përvetësuara gjatë studimeve universitare. Praktikant mësimore të studentëve organizohen në nivel të Njesisë bazë që është Departamenti, i cili përcakton lektorin përgjegjës për tutorimin e studentëve dhe ndjekjen e praktikave mësimore.

REZULTATET E DIPLOMIMIT



PLANI MËSIMOR PROFILI PSIKOLOGJI E PËRGJITHSHME

VITI I PARË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	FILOZOFI	6
2	SHKRIM AKADEMIK	6
3	INFORMATIKË	6
4	GJUHË E HUAJ	4
5	ANGLISHT 1	4
6	ANGLISHT 2	4
7	HYRJE NE PSIKOLOGJI	6
8	PSIKOLOGJI ZHVILLIMI I	6
9	PSIKOLOGJI ZHVILLIMI II	4
10	BIOLOGJI	6
11	SOCIOLOGJI	6
12	PSIKOLOGJI ORGANIZATIVE	6

kërkesës në tregun e punës është bërë nga analiza e përshkrimit të vendit të punës për ofertën dhe nga tipi i programit të studimit universitar për ofertën. Analiza e ofertës përmban një vështrim të të gjithë tregut universitar të programeve të akredituara në Psikologji për periudhën 2016-2020. Nevojat e tregut të punës për këto specialitete kanë marrë parasysh standardet e cilësisë së mësimdhënies dhe dinamikën e zhvillimit të vendit. Lidhja e dinamikës së zhvillimit të tregut universitar të nivelit të dytë në aspektin e kërkesës është konsideruar si elementi bazë i ofertës, ndërsa tregu i punës për këto programe, është pothuajse i përcaktuar që në momentin e përzgjedhjes së fushës së studimit.

MUNDËSITË PUNËSIMIT

Duke qënë se programi i studimit Bachelor në Psikologji

është konceptuar dhe realizuar i tillë që kombinon formimin e njohurive në fushën e psikologjisë bazë të standarteve akademike me nevojat dhe aftësitë aplikative, në përfundim të studimeve studentët kanë përftuar të gjithë njohuritë e nevojshme në fushën e psikologjisë. Do të mundësohet punësimi në institucione publike, biznese private, qendra komunitare, qendra shëndetësore dhe shkolla. Pas diplomimit student aftësohet për zhvillimin e një karriere të suksesshme në fushën e këshillimit psikologjik.

LEKSIONET E HAPURA

Gjatë tre viteve të studimit të programit të studimit Bachelor në Studime Psikosociale, studentët marrin leksione të hapura edhe nga ekspertë psikologë më të mirë në treg, si profesionistë në fushën klinike, ligjore, të këshillimit, psikoanalizës,

VITI I DYTË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	PSIKOMETRI	6
2	PSIKOLOGJI DINAMIKE	6
3	METODA E KËRKIMIT SHKENCOR	6
4	LËNDË ME ZGJEDHJE	4
4/1	PSIKOLOGJI E EMOCIONEVE	
4/2	PSIKOLOGJI E MOTIVIMIT	
5	PSIKOLOGJI E FAMILJES	6
6	PSIKOLOGJI EDUKIMI	6
7	PSIKOLOGJI PERSONALITETI	6
8	PSIKOLOGJIA FIZIOLOGJIKE	4
9	PSIKOLOGJI KONJITIVE	6
10	PSIKOLOGJI SOCIALE	6
11	LËNDË ME ZGJEDHJE SHENDETI MENDOR I DIXHITALIZUAR PSIKOLOGJI KULTURORE	4

VITI I TRETË

Nr.	Lëndët	ECTS
1	TEORITË DHE TEKNIKAT E KËSHILLIMIT	5
2	PSIKOLOGJI KLINIKE	5
3	VLERESIMI NE PSIKOLOGJI	5
4	KOMUNIKIMI NE SHOQERI	6
5	PSIKOLOGJI EKSPERIMENTALE	5
6	LËNDË ME ZGJEDHJE	5
6/1	PSIKOLOGJI E EMOCIONEVE	
6/2	PSIKOLOGJI E MOTIVIMIT	
7	ETIKE	5
8	PSIKOLOGJI LIGJORE	5
9	PSIKOLOGJI ANORMALE	5
10	PRAKTIKA	6
11	PROVIM FORMIM/DIPLOMA	8

Totali i planit mësimor: 180 ECTS

terapisë sistemike konjitivo-bihevjorale, etj. Ndërmjet leksioneve të hapura studentet përftojnë njohuri praktike në fushat përkatëse.

FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE HUMANE



Programi i Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën “Psiko-Pedagogjike”

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Programi i Studimit të Formimit të Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogjike për Ushtrimin e Profesionit të Rregulluar të Mësuesit është një program akademik dhe profesional, i konceptuar për të përgatitur individë të diplomuar në fusha të ndryshme universitare për ushtrimin e profesionit të mësuesisë në arsimin parauniversitar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet bashkëkohore të formimit të mësuesve.

Programi synon pajisjen e pjesëmarrësve me njohuri të plota teorike dhe praktike në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë edukative, duke garantuar zhvillimin e kompetencave profesionale, didaktike dhe etike të nevojshme për mësimdhënie cilësore. Ai mbështetet në një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërdisiplinore, e cila nxit zhvillimin e mendimit kritik, reflektimin profesional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikës mësimore. Procesi mësimor realizohet përmes leksioneve,

seminareve, ushtrimeve praktike, projekteve individuale dhe në grup, si dhe praktikës mësimore në institucione arsimore të licencuara. Kjo strukturë u mundëson studentëve të lidhin teorinë me praktikën dhe të fitojnë përvojë reale në mjedisin shkollor.

Programi përfshin forma të ndryshme vlerësimi, si provime, punë kursi, projekte dhe vlerësime të vazhdueshme, të cilat sigurojnë monitorimin e progresit akademik dhe profesional të pjesëmarrësve. Nëpërmjet këtij programi, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë synon të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit parauniversitar, në forcimin e kapaciteteve profesionale të mësuesve të ardhshëm dhe në krijimin e një trupe pedagogjike të përgjegjshme, inovative dhe të përgatitur për sfidat e edukimit bashkëkohor.

QËLLIMI I PROGRAMIT

Formimi profesional i mësuesve të ardhshëm, duke u ofruar atyre: një bazë të qëndrueshme teorike në fushën e pedagogjisë dhe psikologjisë; aftësi praktike për menaxhimin e procesit mësimor;

kompetenca për ushtrimin e profesionit sipas standardeve ligjore; përgatitje për zhvillimin e karrierës në arsim.

OBJEKTIVAT FORMUESE

Në përfundim të programit, studentët do të jenë në gjendje të:

kuptojnë proceset e zhvillimit psikologjik dhe social të nxënësve; hartojnë plane dhe programe mësimore efektive; përdorin metoda interaktive dhe gjithëpërfshirëse të mësimdhënies; menaxhojnë klasën dhe sjelljen e nxënësve; realizojnë vlerësim të drejtë dhe objektiv të arritjeve; integrojnë teknologjinë në procesin mësimor; zbatojnë kodin etik dhe legjislacionin arsimor; zhvillojnë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi profesional.

NJOHURITË DHE KOMPETENCAT KRYESORE

Studentët përfitojnë njohuri në: Psikologji zhvillimi dhe edukative Teoritë e edukimit Metodologji mësimdhënieje Didaktikë dhe planifikim mësimor

Komunikim pedagogjik Edukim qytetar Teknologji në arsim Vlerësim dhe matje pedagogjike Menaxhim klase Edukim gjithëpërfshirës

STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Programi realizohet përmes: leksioneve teorike; seminareve; ushtrimeve praktike; projekteve individuale dhe në grup; praktikës mësimore; provimit përfundimtar. Kontrolli i njohurive bëhet nëpërmjet vlerësimeve të vazhdueshme, punëve të kursit dhe provimeve.

PRAKTIKA MËSIMORE

Praktika mësimore përbën një komponent thelbësor të programit. Studentët zhvillojnë praktikën e tyre në institucione arsimore publike dhe private, në bashkëpunim me Departamentin përkatës dhe mentorë të kualifikuar.

Praktika synon: njohjen me realitetin e klasës; aplikimin e teorisë në praktikë; zhvillimin e aftësive profesionale; përvetësimin e etikës së profesionit.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Të diplomuarit e këtij programi mund të punësohen në: shkolla publike dhe private; institucione arsimore dhe trajnuese; qendra edukimi dhe zhvillimi profesional; projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në arsim. Programi rrit ndjeshëm konkurrueshmërinë dhe punësueshmërinë e pjesëmarrësve në tregun e punës.

REZULTATET E DIPLOMIMIT

Në përfundim të programit, pjesëmarrësit: zotërojnë kompetenca të plota psiko-pedagogjike; janë të aftë të ushtrojnë profesionin e mësuesit; demonstrojnë aftësi për mësimdhënie cilësore; përmbushin kriteret ligjore për profesionin e rregulluar; janë të përgatitur për zhvillim të mëtejshëm profesional.



Erasmus+

STUDENTET TANË NË UNIVERSITETET EUROPIANE

Në botën e sotme të globalizuar, shkëmbimi i njohurive, kulturës dhe ideve përtej kufijve është thelbësor për avancimin e arsimit të lartë. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), duke e njohur këtë rëndësi, ka ndërmarrë hapa drejt ndërkombëtarizimit, duke u veçuar si një institucion i përsosmërisë akademike dhe integritit kulturor në Shqipëri. Në zemër të kësaj nisme qëndron angazhimi ynë ndaj programit Erasmus+, i financuar plotësisht nga Bashkimi European, një gur themeli për nxitjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare, zgjerimin e horizonteve dhe ngritjen e cilësisë së arsimit që ofrojmë.

"ERASMUS+ ENRICHING LIVES, OPENING MINDS"

Duhet theksuar që në fillim të herës, dhe krenohemi me faktin e të qenurit universiteti i parë në Shqipëri që ka marrë një aprovimin dhe çertifikimin nga Komisioni European "Erasmus+ Charter for Higher Education" duke qenë në listën e atyre universiteteve nga vendet e BE-së dhe aplikuar të njëjtat standarde si ato. UMSH është universiteti i cili në listën e universiteteve të cilat kanë marrë këtë charter mban kodin AL TIRANA01.

Kjo arritje është një dëshmi e vizionit dhe përkushtimit të UMSH për t'u siguruar studentëve dhe fakulteteve të tij mundësi që tejkalojnë kufijtë gjeografikë. Karta e Erasmus jo vetëm që nje angazhimin tonë për cilësinë në bashkëpunimin ndërkombëtar, por gjithashtu forcon pozicionin e Shqipërisë në hartën evropiane të arsimit të lartë. Kjo njohje na ka

mundësuar të lidhemi më thellësisht me partnerët evropianë, duke hapur kështu rrugët për lëvizjen e studentëve dhe stafit, projektet e përbashkëta kërkimore dhe zhvillimin e kurrikulave.

80 studentë të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, deri në vitin 2027, do të të kenë mundësinë të pajisen me diplomën e dyfishtë nga Universiteti Mesdhetar dhe Universiteti i Tuscia në Itali.

36 studentë kanë marrë pjesë në

programin Erasmus +, duke kryer, një ose disa simestre në një nga Universitetet Europiane me të cilat falë këtij programi Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka partneritet.

15 studentë të rinj të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, do të përfitojnë nga programi Erasmus+, deri në fund të vitit 2024 duke nisur programet e shkëmbimeve studentore.

72 pedagogë të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë kanë dhënë mësim në Universitetet Europiane në kuadër të programit Erasmus +

40 pedagogë të huaj nga Univesitetet Europiane me të cilat Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka partneritet kanë dhënë mësim në këtë Univrsitet falë programit Erasmus +

1. South-West University "Neofit Rilski" (Bullgari)
2. Tallinn University of Technology (Estoni)
3. Panteion University of Social and Political Sciences (Greqi)
4. University of Piraeus (Greqi)
5. University of L'Aquila (Itali)
6. Universita of Tuscia (Itali)
7. Salento University (Itali)
8. Lithuania Business College (Lituanë)
9. Mykolas Romeris University (Lituanë)
10. Kodolanyi Janos University (Hungari)
11. Bialystok University of Technology (Poloni)
12. Jagiellonian University (Poloni)
13. Kazimierz Źelki University (Poloni)
14. Rzeszoë University (Poloni)
15. Lomza State University of Applied Sciences (Poloni)
16. University of Torun (Poloni)
17. University College of Enterprise and Administration in Lublin ĘSPA (Poloni)
18. University of Ęroclaë (Poloni)
19. Mazovian Academy in Plock (Poloni)
20. Poëislanski University (Poloni)
21. Polytechnic Institute of Braganca (Portugali)
22. University of Autonomia de Barcelona (Spanjë)
23. University of Valladolid (Spanjë)
24. Stefan cel Mare din Suceava (Rumani)
25. Aurel Vlaicu Din Arad (Rumani)
26. National University of Political Studies and Public Administration (Rumani)
27. Cukurova University (Turqi)
28. Hacettepe University (Turqi)
29. Giresun University (Turqi)
30. Sivas University (Turqi)
31. Bolu Abbant Izzet Baysal University (Turqi)
32. Bandirma Onyedi Eylul University (Turqi)
33. Usak University (Turqi)
34. Bitlis Eren University (Turqi)
35. Mehmet Akif Ersoy University Turqi

KËSHILLI STUDENTOR UMSH

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka gjithnjë në vëmendje zërin e studentëve, duke e konsiderur si pjesë të rëndësishme të zhvillimit, prandaj është kujdesur që përfaqësia e tyre të jetë kudo e pranishme në institucion. Këshilli studentor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është një organ i pavarur, i cili përfaqëson interesat e studentëve. Këshilli studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të insitucionit tonë si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme, kulturore, artistike, sportive etj. Në përbërjen e tij ka senatorë përfaqësues të çdo grupi mësimor, nga të dy ciklet e studimit, nga të gjitha vitet dhe nga të gjitha grupet. Këta senatorë udhëhiqen nga Kryetari i Këshillit dhe në çdo takim përçojnë zërin e grupit që përfaqësojnë. Përgjatë vitit akademik, kjo përfaqësi studentësh ndjek një kalendar pune, të cilin e miraton

përpara çdo fillim të vitit. Filozofia e kësaj strukture është që krahas zhvillimit të procesit mësimor të zhvillohen edhe aktivitete ekstrakurrikulare që lidhen me programet e studimit të pesë fakulteteve si dhe aktivitete me kontribut në shoqëri. Projektet e studentëve të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë që udhëhiqen nga Këshilli studentor dhe mbështeten nga vetë insitucioni ynë kanë si qëllim sensibilizimin e shoqërisë për kapërcimin e vështirësive dhe shqetësimeve aktuale si dhe vijimin drejt zhvillimit për një të ardhme më të mirë. Aktivitetet sportive, kulturore dhe artistike të këshillit studentor UMSH, të zhvilluara brenda dhe jashtë universitetit, janë tregues se studenti në UMSH është gjithnjë pranë djes dhe zhvillimit por edhe pranë përvojës që mëson gjatë jetës studentore në forma të tilla praktike.

Prej vitesh, motoja e Këshillit studentor UMSH është:

NË UNIVERSITETIN MESDHETAR TË SHQIPËRISË

KA VETËM KAMPIONË!



KËSHILLI STUDENTOR UMSH

Klubet Studentore në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, janë formuar nga studentët e programeve dhe cikleve të ndryshme të studimit në UMSH, bazuar në interesa dhe kërkësi studimi të përbashkëta, programeve të studimit ose qëllimeve të tjera të përbashkëta dhe të përafërta. Studentët i bashkohen klubeve për t'u përfshirë në aktivitete në fusha ku ata janë të pasionuar, për t'u shoqëruar me studentë dhe individë me të cilët ndajnë të njëjtin mendim dhe për të kontribuar në krijimin e një ndjenje komuniteti dhe përkatësie brenda mjedisit akademik të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.

Klubet Studentore mbulojnë një gamë të gjerë interesash dhe aktiviteteve, duke përfshirë klubet e debatit, klubet shkencore ose klubet gjuhësore, organizatat kulturore dhe artistike, klubet sportive, grupet e shërbimit në komunitet dhe më tej. Anëtarësimi në një klub studentor ofron një mundësi për rritje personale, zhvillim të aftësive dhe përfshirjen në networks me individë me të cilët ndajnë interesa të ngjashme. Klubet Studentore në UMSH zhvillojnë takime 2-3 herë në muaj në formë debatesh, tryeza të rrumbullakëta, diskutime për tema të fushave si dhe të ftuar të fushave të ekspertizës që mbulohej nga departamenti.

KLUBI “JURISTËT E SË ARDHMES”

është një klub studentor në UMSH, i cili organizohet në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane. Ai synon të përgatisë dhe fuqizojë studentët e programeve të studimit në fushën e të drejtës për zhvillimet aktuale dhe perspektivën e profesioneve në jurisprudencë. Misioni i klubit “Juristët e së ardhmes” është të kultivojë një komunitet profesionistësh aspirues të jurisprudencës, të cilët jo vetëm janë të aftësuar në jurisprudencën tradicionale ligjore, por janë gjithashtu të përgatitur për të kontribuar në ndryshimet dinamike në fushën ligjore.

KLUBI “ENCRYPTION TEXTS”

është një klub studentor në UMSH, i cili inkurajon eksplorimin e botës magjepsëse të kriptografisë dhe enkriptimit duke promovuar ndërgjegjësimin dhe kuptimin e metodave të sigurta të komunikimit ndërmjet studentëve. Në këtë klub ata angazhohen edhe në aktivitete informuese për të edukuar komunitetin më të gjerë për rëndësinë e kriptimit për privatësinë, sigurinë në internet, etj., si dhe bashkëpunimin në projekte që aplikojnë konceptet e enkriptimit dhe komunikimit të sigurt në skenarët e botës reale, duke promovuar zbatimin praktik të njohurive të tyre.

KLUBI “JURISTËT E SË ARDHMES”

është një klub studentor në UMSH, i organizuar nga studentë që ndajnë interes në shkencat politike, teorinë politike, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe fusha të ngjashme. Ky klub synon të sigurojë një platformë për studentët që të përfshihen në diskutime, aktivitete dhe ngjarje që thellojnë kuptimin e tyre për sistemet politike, strukturat qeveritare dhe çështjet globale. Klubi i “Shkencave politike” është i përkushtuar për të nxitur një mjedis ku studentët e apasionuar pas shkencave politike bashkohen për të eksploruar, diskutuar dhe kontribuar në kuptimin e sistemeve politike, qeverisjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.





KLUBI "MENAXHERI NESËR"

është një klub studentor në UMSH, i organizuar nga studentë që ndajnë interes në fushën e drejtimit dhe menaxhimit. Qëllimi i klubit "Menaxheri i së nesërme" është të kultivojë gjeneratën e ardhshme të liderëve dhe menaxherëve efektivë dhe që ravijëzojnë të ardhmen, duke i pajisur studentët me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të kontribuar me sukses në botën komplekse të zhvillimit të biznesit, duke theksuar rolin e leadershipit, inovacioni, aftësisë së përshtatshmërisë dhe një kuptim gjithëpërfshirës të menaxhimit në kontekstin e tendencave dhe sfidave në zhvillim.

KLUBI "DIPLOMACISË DHE MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE"

është një klub studentor në UMSH, i fokusuar në Diplomaci dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare (IR) ku ofrohet një platformë shtesë për studentët e interesuar në diplomaci, gjeopolitikë dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Klubi i "Diplomacisë dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare" është i përkushtuar për të promovuar

një kuptim gjithëpërfshirës të çështjeve globale, diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare ndërmjet studentëve, duke krijuar një hapësirë ku anëtarët mund të përfshihen në diskutime, aktivitete dhe ngjarje që kontribuojnë në njohjen dhe vlerësimin e tyre të kompleksitetit të politikës ndërkombëtare dhe diplomacisë.

KLUBI "MENTAL WELL - BEING"

është një klub studentor në UMSH, i organizuar nga studentë që ndajnë interes në fushën e mirëqenies mendore, i cili promovon ndërgjegjësimin për shëndetin mendor, duke ofruar mbështetje dhe krijimin e një mjedisi pozitiv dhe gjithëpërfshirës për studentët. Klubi synon të adresojë sfidat e shëndetit mendor, të zvogëlojë stigmën dhe të nxisë një komunitet mbështetës duke ofruar një hapësirë të sigurt për dialog të hapur dhe organizimin e aktiviteteve që kontribuojnë në mirëqenien mendore të komunitetit.


KLUBI "FINANCIERI NESËR"

është një klub studentor në UMSH, i organizuar nga studentë që ndajnë

interes në fushën e financave. Qëllimi i këtij klubi është të përgatisë studentët për ambientin financiar të së ardhmes, duke përfshirë tendencat në zhvillim, zhvillimet teknologjike dhe praktikën e qëndrueshme financiare, për zhvilluar në këtë mënyrë të studentët njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të shkëlqyer në fushën dinamike të financave, duke theksuar inovacionin, qëndrueshmërinë dhe përshtatshmërinë ndaj tendencave të ardhshme.

KLUBI I ROBOTIKËS

Klubi i robotikës është një mbledhje e studentëve që janë të interesuar të mësojnë të ndërtojnë një projekt ku të mund të dizenojnë e ndërtojnë një robot. Ai zhvillohet jashtë orëve në auditor dhe moderohet nga një anëtar i stafit mësimdhënës në fushën e Inxhinierisë Informatike. Ekipet e studentëve do të mund dizenojnë dhe ndërtojnë një robot që mund të ketë të bëjë me: automatizimin e banesave, aplikacione software dhe hardware, etj. që do të thjeshtojnë jetën e përditshme duke ju ardhur në ndihmë njerëzve të kategorive të ndryshme, por edhe për fushën e biznesit.

A photograph of a group of graduates in blue gowns and caps sitting in a lecture hall. The graduates are seated in rows, and the background shows the dark interior of the hall with a large, light-colored structural beam. The text is overlaid on the bottom left of the image.

**ZGJIDH
MESDHETARIN
PËR NJË
EKSPERIËNCË
UNIKE NË DIJE**

CEREMONIA E DIPLOMIMIT

2025





Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Kampus 1: Blv. Gjergj Fishta, Nr.52,
Kodi Postar: 1023, Tiranë
Kampus 2: Rruga " Dritan Hoxha",
Tiranë

Rrjetet tona sociale:

Fb: Universiteti Mesdhetar i Shqiperise
Insta: @universitetimesdhetar
Email: info@umsh.edu.al

Telefon:

+355 69 622 8401 Sekretaria Bachelor
+355 69 88 75788 Sekretaria Master
+355 68 606 1004 Info